



FAQE 3



FAQE 3



FAQE 4



FAQE 7

# Koha

www.koha.mk



Fatet në ikje  
të Kushtrim  
Bekteshit

FAQE 18

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3223 • E enjte 16 nëntor 2017 15 DEN



## Nimici e ka gati propozimin për emrin

Shkup, 15 nëntor - Ndërmjetësuesi i KB-së në kontestin për emrin Methju Nimic në takimin me përfaqësuesit e Greqisë, Adamantios Vasilakis dhe të Maqedonisë, Vasko Naumovskin të caktuar fillimisht për më 20 dhe 21 nëntor në Nju-Jork, por tani të shtyrë për dhjetor, do të dalë

me propozim konkret për zgjidhjen e kontestit, njoftojnë mediat greke. Athina pret pas fitores së kryeministrit Zoran Zaev në zgjedhjet lokale dhe stabilizimit të Qeverisë nga Maqedonia të vazhdojë me aktivitetet e "vullnetit të mirë" me të cilat do të tregojë se e braktis irredentizmin, siç

është ndryshimi i emrit të aeroportit në Shkup dhe largimin e përmendoreve të vendosura në kohën e Nikolla Gruevskit, publikon Radio Athina 9,84 Real.gr dhe Lefimerdia. Mediat greke transmetojnë se zëvendëskryeministri Koço Angjushev dje gjatë fjalimit në debatin...  
Faqe 2

Koalicionet vazhdojnë edhe për kryesuesit e Këshillave komunal

## Kush e ka kryetarin, e ka edhe Këshillin



Si për zgjedhjet për kryetarë të komunave, koalicioni BDI-LSDM po vazhdon edhe në zgjedhjen e kryesuesve të Këshillave komunal, ndërsa këtyre iu është bashkangjitur edhe PDSH, siç ishte rasti në Komunën e Likovës, por që partia e Thaçit pritet të përkrah BDI-në dhe në komunat tjera. Nga ana tjetër, koalicioni ASH-BESA më shumë forcë ka gjetur në Zhelinë, Bogovinë dhe në Vrapçisht

FAQE 3

## Prokuroria do ta kontrollojë punën e MPB-së



Shkup, 15 nëntor - Ministria e Mbrojtës edhe zyrtarisht i ka filluar përgatitjet e një sërë ligjesh, të cilët kryesisht lidhen me sigurimin e kontrollit të jashtëm dhe të pavarur për aktivitetet dhe punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në njoftimin e publikuar në Regjistrin elektronik të shkresave gjyqësore, Mini-

stria e Drejtësisë ka paralajmëruar se plotësim-ndryshimeve do t'i nënshtrohen Ligji për prokurori publike, Ligji për shërbimin prokurorial, Ligji për Këshillin e prokurorëve, si dhe Ligji për procedurë penale. Përgatitja e propozim-versioneve, siç thonë nga kjo ministri, duhet të përfundojë deri më 24 nëntor.

Kontrollin e punës së policisë të rregullt të MPB-së, dhe policisë së burgjeve, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në bazë të ndryshimeve të paralajmëruara, në të ardhmen pritet ta realizojë Prokuroria Publike. "Implementimi i mekanizmit të pavarur për kontroll të jashtëm...  
FAQE 5

RAJON

### S'ka kush e fiton Kishën e Millosheviçit



Gjykata e Apelit në Prishtinë ka konfirmuar aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, me të cilin hapësira prej 4 hektarësh brenda kampusit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i takon Kishës Ortodokse Serbe, përkatësi-sht kishës "Shën Nikolla" në Prishtinë. Aktvendimin tashmë...  
FAQE 15

RAJON

### Dëbohet çetniku serb për spiunim

FAQE 15

RAJON

### Do t'i mbrojmë dëshmitarët, askush s'më frikëson mua

FAQE 14

GLOBI

### E pasura e varfër Gjermani



FAQE 16





Athina pret pas fitores së kryeministrit Zoran Zaev në zgjedhjet lokale dhe stabilizimit të Qeverisë nga Maqedonia të vazhdojë me aktivitetet e "vullnetit të mirë" me të cilat do të tregojë se e braktis irredentizmin, siç është ndryshimi i emrit të aeroportit në Shkup dhe largimin e përmendoreve të vendosura në kohën e Nikolla Gruevskit. Takimi i ndërmjetësimit Metju Nimici me Vasilakis dhe Naumovskin është shtyrë për në dhjetor, nga 20 nëntori që ishte planifikuar fillimisht

Shkup, 15 nëntor - Ndërmjetësuesi i KB-së në kontestin për emrin Methju Nimic në takimin me përfaqësuesit e Greqisë, Adamantios Vasilakis dhe të Maqedonisë, Vasko Naumovskin të caktuar fillimisht për më 20 dhe 21 nëntor në Nju-Jork, por tani të shtyrë për dhjetor, do të dalë me propozim konkret për zgjidhjen e kontestit, njoftojnë mediat greke. Athina pret pas fitores së kryeministrit Zoran Zaev në zgjedhjet lokale dhe stabilizimit të Qeverisë nga Maqedonia të vazhdojë me aktivitetet e "vullnetit të mirë" me të cilat do të tregojë se e braktis irredentizmin, siç është ndryshimi i emrit të aeroportit në Shkup dhe largimin e përmendoreve të vendosura në kohën e Nikolla Gruevskit, publikon Radio Athina 9,84 Real.gr dhe Lefimerdia. Mediat greke transmetojnë se zëvendëskryeministri Koço Angjushev dje gjatë fjalimit në debatin në

# Është e mundur zgjidhja e kontestit Athinë-Shkup

## Nimici e ka tashmë propozimin për emrin



institutin Xhon Hopkins në Uashington ka kërkuar nga SHBA-ja mbështetje për zgjidhjen e kontestit të emrit. "Katimerini" gjithashtu shkruan se ministri grek i Punëve të Jashtme, i cili në Bruksel u takua me shefin e diplomacisë të Maqedonisë Nikolla Dimitrov, para pak kohësh në pres konferencë tha se gjysma e parë e vitit 2018 do të ishte koha ideale për bisedime midis të dyja palëve. "Shpresat për zgjidhje u ringjallën me fitoren e LSDM-së të kryeministrit të IJRM-së në zgjedhjet lokale që u mbajtën

muajin e kaluar në vendin fqinj. Të hënën Zaev deklaroi se duhet që të fillojnë përpjekje të reja për zgjidhjen e kontestit për emrin", shkruan gazeta greke.

Në ndërkohë, Daniel Server, ekspert për Ballkan dhe profesor në universitetin amerikan Xhon Hopkins, në deklaratë për MIA-n vlerëson se është e mundur që në vitin 2018 të bëhet depërtim në zgjidhjen e kontestit për emrin dhe heqje të bllokimit për pranim të Maqedonisë në NATO dhe fillim të negociatave inkuadruese me BE-në. Duke i kome-

tuar pritjet optimiste nga Shkupi, Athina, por edhe nga Uashingtoni, të theksuara përmes zëvendësndihmës sekretarit shtetëror të SHBA-së Hojt Ji, Server thotë se zgjidhje mund të gjendet posaçërisht lidhur me pranimin e Maqedonisë në NATO.

"Po, zgjidhje, të paktën, për anëtarësim në NATO, është e mundur në vitin 2018. Të njëjtin gjë mund ta thosha çdo vit nga Marrëveshje e përkohshme e vitit 1995, kushtet (rastet) për këtë për momentin janë premtuese", thekson Server. Për reagimet eventuale nga Moska

### OSMANI JAVËN E ARDHSHE NË ATHINË

Zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani javën e ardhshme me siguri do ta vizitojë Athinën ku do të bisedojë me përfaqësues të lartë të autoriteteve greke, publikoi edicioni online i gazetës greke "Katimerini". Duke i referuar analistëve, gazeta informon se pret që takimet midis përfaqësuesve të të dy vendeve të intensifikohen në fillim të vitit të ardhshëm. Duke mos saktësuar nëse vizita e Osmanit është në kuadër të përpjekjeve për gjetjen e zgjidhjes për emrin, ose lidhur me aspekte të tjera të marrëdhënieve bilaterale midis Maqedonisë dhe Greqisë, gazeta në të njëjtin tekst fokusohet në takimin me ndërmjetësin Methju Nimic, takim të cilin për javën e ardhshme e paralajmëroi kryeministri Zoran Zaev.

kur do të vijë koha për pranim të Maqedonisë në NATO dhe deklarata që në këtë kontekst e dha kryeministri Zaev për radion malazeze "Antena 1", Server thekson se "rusët do të provojnë gjithçka që ta pengojnë Maqedoninë të hyjë në Aleancë". Presion ndaj Greqisë, financimi i politikave anti-NATO, demonstrues të huazuar, propagandë intensive nga RT dhe Sputnik, provokime të armatosura, madje atentat dhe grusht shtet, e gjithë kjo do të jetë në menynë e tyre. Më mirë është që të jeni të përgatitur për më të keqen", thotë Daniel Server në deklaratë për MIA-n. Zëvendësndihmës sekretari shtetë-

ror amerikan Hojt Ji javën e kaluar në debat në Uashington deklaroi se çështja për emrin deri tani është në nivelin më të lartë dhe më afër gjetjes së zgjidhjes. Shefi i diplomacisë greke Nikos Koxias, madje, deklaroi se pret që çështja të mbyllet në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm, ndërsa kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev, se duhet të bëhet hap dhe se tani ka shanse më të mëdha prej më parë që të gjendet zgjidhje me Greqinë. Raund i ri i bisedimeve të negociatorëve të së dy vendeve me ndërmjetësim të Methju Nimicit, pas një pauze më të gjatë, pritet të mbahen në dhjetor.

## Konferencë "Përforcim i mbikëqyrjes së parlamenteve nga Ballkani Perëndimor"

# Parlamentet dështuan në kontrollin e shpenzimeve

Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, në hapjen e konferencës tha se funksioni mbikëqyrës i Parlamentit, nuk e ka atë dimension të cilin e kanë parlamentet në shtetet demokratike me zhvillim të lartë

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 15 nëntor - Deputetë dhe përfaqësues nga parlamentet e vendeve nga Ballkani Perëndimor së bashku me përfaqësues nga Banka Botërore, ekspertë dhe përfaqësues rajonal nga Parlamenti Evropian, këtyre dy ditëve në Shkup diskutojnë për aspektet e ndryshme të bashkëpunimit rajonal dhe për atë se si të avancohet mbikëqyrja buxhetore dhe ligjdhënëse në Ballkanin Perëndimor. Analiza e krahasuar e vlerësimeve paraprake të shpenzimeve publike dhe logjistikës financiare në



rajonin e Ballkanit Perëndimor për periudhën 2006-2016, sipas Raportit të prezantuar në kuadër të konferencës "Përforcim i mbikëqyrjes së parlamenteve nga Ballkani Perëndimor" siç thuhet, sugjeron se rajoni parimisht dështoi kur bëhet fjalë për kontrollin ligjdhënës. Megjithatë, siç qëndron, suksesi nuk është konstant në të gjithë vendet. Kryetari i Parlamentit të

Maqedonisë, Talat Xhaferi, në hapjen e konferencës tha se funksioni mbikëqyrës i Parlamentit, nuk e ka atë dimension të cilin e kanë parlamentet në shtetet demokratike me zhvillim të lartë. "Ky rol mbikëqyrës është posaçërisht i rëndësishëm kur bëhet fjalë për Buxhetin, për shkak se ai mbushet para se gjithash nga qytetarët, ndërsa ne jemi deputetë të zgjedhur në parlament

pikërisht nga qytetarët. Për këtë arsye, obligimi ynë ligjor, por edhe demokratik është që të kryejmë mbikëqyrje transparente për atë se si shpenzohen të hollat e popullit, dhe se nëse përmes buxhetit plotësohen interesat dhe nevojat e qytetarëve, kuptuar me kuptim më të gjerë të fjalës, dhe se nëse me buxhetin sigurohet ardhmëri e tanishme stabile dhe zhvilli-

more", tha Xhaferi. Kjo konferencë, sipas deputetit dhe kryetar i Bordit të Rrjetit të komisioneve parlamentare për ekonomi, financë dhe euro-integrime i Ballkanit Perëndimor Artan Grubi, konferenca e simbolizon përkushtimin ndaj bashkëpunimit dhe euro-integrimit e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ai e theksoi domethënien e këtij projekti, qëllimi i të cilit është përforcimi i bashkëpunimit parlamentar të deputetëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim që të promovohet konkurrenca e tregut, rritja ekonomike dhe integrimi evropian. Duke u përqendruar në perspektivën evropiane të rajonit për anëtarësim në BE, theksoi se kjo paraqet motivacion bazë për zbatimin e përpjekjeve reformuese të proceseve të BE-së. "Rruga drejt BE-së na udhëzon në rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë, në drejtim të zgjidhjes së problemeve tona të përbashkëta siç janë lufta kundër kimit të organizuar, transporti, siguria

kufitare etj, dhe të cilat duhet së bashku t'i zgjidhim", tha Grubi. Ambasadorja zvicerane, Sibil Suter, në Maqedoni paralajmëroi vazhdim të mbështetjes së parlamenteve nga Ballkani Perëndimor, e cila tani ndihmon në Maqedoni, Shqipëri dhe Serbi. Në Maqedoni, Qeveria zvicerane e mbështet Institutin parlamentar, ndërsa në Serbi mbikëqyrjen parlamentare. "Mbështetja zvicerane e parlamenteve do të rritet gjatë viteve të ardhshme kështu që pritet që mbikëqyrja financiare të jetë një prej temave kryesore. Parlamentet nga Ballkani Perëndimor kanë zhvilluar praktika të ndryshme lidhur me organizimin e mbikëqyrjes financiare", tha Suter. Konferenca rajonale është në organizim të Uesminster Fondacionit për Demokraci, Bankës Botërore dhe Rrjetit të komisioneve parlamentare për ekonomi, financë dhe euro-integrime të Ballkanit Perëndimor të mbështetur nga Qeveria zvicerane.





Koalicionet vazhdojnë edhe për kryesuesit e Këshillave komunal

# Kush e ka kryetarin, e ka edhe Këshillin

Si për zgjedhjet për kryetarë të komunave, koalicioni BDI-LSDM po vazhdon edhe në zgjedhjen e kryesuesve të Këshillave komunal, ndërsa këtyre iu është bashkangjitur edhe PDSH, siç ishte rasti në Komunën e Likovës, por që partia e Thaçit pritet të përkrah BDI-në dhe në komunat tjera. Nga ana tjetër, koalicioni ASH-BESA më shumë forcë ka gjetur në Zhelinë, Bogovinë dhe në Vrapçisht

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 15 nëntor - Pas mbarimit të procesit zgjedhor së fundi me përsëritjen e votimit në Komunën e Çairit, sfidauese për partitë do të jetë edhe krijimi i shumicës së nevojshme 50 për qind plus një për të zgjedhur kryetarët e këshillave komunal. Si për zgjedhjet për kryetarë të komunave, koalicioni BDI-LSDM po vazhdon edhe në zgjedhjen e kryesuesve të Këshillave komunal, ndërsa këtyre iu ka bashkangjitur edhe PDSH siç ishte rasti në Komunën e Likovës, por që partia e Thaçit pritet të përkrah BDI dhe në komunat tjera. Nga ana tjetër, koalicioni ASH-BESA vlen edhe për zgjedhjen e kryesuesve të Këshillave komunal, ku sipas informatave që ka siguruar gazeta KOHA, Lëvizja BESA do të ketë kryesuesin në Zhelinë, ndërsa ASH në Bogovinë dhe në Vrapçisht. Deri më tani, në komunat shqiptare janë konstituuar vetëm tre këshilla komunal, edhe atë në Saraj - Reshat Ramadani, Likovë - Lejla Iseni dhe Strugë - Resul Kaba. Për dallim nga Saraji, ku BDI nuk ka pasur nevojë për koalicion apo për mbështetjen e partive tjera meqë ka fituar 10 këshilltarë nga 19 sa ka kjo komunë, në Komunën e Likovës BDI mori kryesimin e Këshillit komunal me dy votat e PDSH-së dhe një votë të PPD-së, e cila në fitoi një mandat këshilltari. Në zgjedhje lokale, në Likovë BDI fitoi 9 këshilltarë, BESA 4, ASH 3,



## KSHZ I SHPALLI TË PËRFUNDUARA ZGJEDHJET LOKALE

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i shpalli të përfundura Zgjedhjet Lokale 2017 në të gjithë territorin e Maqedonisë. KSHZ-ja konkludimin për përfundimin e zgjedhjeve e solli në seancën e djeshme, pasi paraprakisht u publikuan rezultatet përfundimtare nga rivotimi për zgjedhje të kryetarit të komunës së Çairit në një vendvotim. Raundi i parë i Zgjedhjeve lokale u mbajt më 15 tetor dhe i dyti më 29 tetor. Javën e kaluar u mbajt rivotim në një qendër votimi në komunën e Çairit pasi Gjykata Administrative miratoi një ankimim të Lëvizjes BESA. LSDM, sipas rezultateve pas dy raundeve të zgjedhjeve lokale, fitoi postin e kryebashkiakut në Shkup dhe kryetarë në 56 komuna, VMRO-DPMNE në pesë, BDI në 10, Aleanca për Shqiptarët në tre, BESA, PDSH dhe PDT nga një, ndërsa kandidatët e propozuar nga grupi i votuesve fituan në tri komuna.

PDSH 2 dhe PPD 1. Edhe në Strugë, BDI fitoi kryesuesin Resul Kaba me ndihmën e këshilltarëve të LSDM-së, ndërsa mbështetje mori edhe nga këshilltarët e VMRO-së. ASH në Strugë ka fituar 8 këshilltarë, BDI 6, LSDM 7, VMRO 4 dhe BESA 2. Por siç po shkojnë rrjedhat në zhvillimet lokale, edhe në komunat tjera do të ndiqet i njëjti ritëm, ku partia që ka kryetarin e komunës, ajo edhe do të marrë edhe kryesuesin e Këshillit komunal. Kjo u pa edhe në Strugë dhe sipas burimeve partiake, e njëjta do të ndodh edhe në Gostivar, kur me gjasë do të ketë koalicion të gjerë mes ASH-së, BESËS, LSDM-së dhe dy partitë e turqve, ndërsa pritet që përkrahje të japë edhe VMRO, kjo sipas burimeve të afërta me kryetarin e Komunës, Arbën Taravari. Në Gostivar, BDI mori më shumë këshilltarë edhe atë 9, ASH 7, VMRO 4, LSDM 4, BESA 2, Partia Demokratike e Turqve 2, koalicioni RDK-UNITETI 2 dhe Lidhja Nacionale e Turqve 1.

Edhe në Tetovë, kryesuesi pritet ti takojë BDI-së, por kjo parti ka nevojë për votat e këshilltarëve të LSDM-së, atyre të PDSH-së dhe të PDT-së. Në Tetovë BDI fitoi 9 këshilltarë, BESA 6, VMRO 5, ASH 4, PDSH 3, LSDM 3 dhe PDT 1. Në Kërçovë dhe Dibër - BDI do të ketë kryesuesin edhe atë vetëm me votat e LSDM-së. Në Kërçovë, BDI ka më shumë këshilltarë - 9 gjithsej, VMRO 6, LSDM 4, ASH 3 dhe BESA 1, ndërsa në Dibër - BDI ka 5, LSDM 3, ASH 3, VMRO 2, aq sa edhe BESA - 2 këshilltarë. Në Çair, BDI do të ketë kryesuesin po me ndihmën e votave të këshilltarëve të LSDM-së. Në këtë komunë, BDI fitoi 9 këshilltarë, BESA 8, VMRO 4, LSDM 4 dhe ASH 2. Në Tearcë, BDI pritet të marrë kryesuesin po njëjtë - me ndihmën e LSDM-së dhe të PDSH-së. Në zgjedhje - BDI fitoi 7 këshilltarë, BESA 4, ASH 3, PDSH 3, VMRO 1 dhe LSDM 1. Me interese është edhe zgjedhja e kryetarit të Këshillit në Dollnen dhe në Bërvenicë, ku

LSDM mori 3 këshilltarë, VMRO 2, ASH 2, BESA 1, Partia Demokratike e Turqve 1, PDSH 1, ndërsa nga grupi i qytetarëve 2 këshilltarë. Në Dollnen, BDI fitoi kryetarin e Komunës, ndërsa sa i përket asaj nëse do të marrë LSDM kryesuesin e Këshillit apo të kryesojë BDI, kjo mbetet në nivel të marrëveshjes mes degëve, thonë nga BDI. Por jo vetëm në këtë Komunë, por edhe në Çashkë, në Shuto Orizare dhe në Sopishtë mbetet të shihet nëse LSDM do ti jap BDI-së kryesuesin e Këshillit komunal ashtu siç e mori BDI kryesuesin në Komunën e Jegunovcës. Në Vrapçisht, kryesuesi pritet të jetë nga radhët e ASH-së dhe po njëjtë edhe në Bogovinë, kurse në Zhelinë - kryesuesi do të jetë nga Lëvizja BESA. Siç tha për gazetën KOHA kryetari i kësaj komune, Blerim Sejdiu, "konstituimi i Këshillit komunal do të bëhet më 21 nëntor edhe atë me ndihmën e këshilltarit të ASH-së". Në Vrapçisht, ASH ka 6, BDI 7, Partia Demokratike e Turqve 3, BESA 2 dhe LSDM 1 këshilltar. Në Zhelinë, BESA ka fituar 9 këshilltarë, BDI 8, PDSH 1 dhe ASH 1. Në Studenican, sipas informatave jozyrtare, Këshilli pritet të konstituohet të enjten - ndërkaq nuk dihet ende nëse kryesuesi do të jetë nga PDSH apo mund të marrë BDI. Në Studenican, PDSH doli e para me këshilltarë, BDI 3, BESA 3, ASH 1, Partia Demokratike e Turqve 1 dhe LSDM 3. Në Haračinë mbetet në nivel të degëve nëse LSDM do të kryesojë me Këshillin komunal apo atë post do ta marrë BDI. LSDM në Haračinë fitoi 9 këshilltarë - që të gjithë shqiptarë, BDI 3, ASH 3, ndërsa BESA 1. BDI nxori këshilltar edhe në Kumanovë edhe atë tre, ku në këtë komunë është në koalicion me LSDM, e cila doli e para me 16 këshilltarë, VMRO fitoi 11, BESA 2, kurse ASH. BDI me ASH dhe BESËN do të jenë vendimtare në Komunën e Ohrit, ku u fituan dy vende këshilltarësh, LSDM mori 10, ndërsa VMRO 10. BDI ka fituar nga një këshilltar edhe në Manastir, Krushevë, Petrovec, Resnjë, Çashkë, Shuto Orizare, ndërsa në Sopishtë nga një këshilltar fituan PDSH dhe ASH.

## Ministri i Shëndetësisë mund të mos jetë i ASH-së



Shkup, 15 nëntor - Bisedimet për zgjedhje të ministrit të ri të Shëndetësisë janë në vijim me partnerët e koalicionit nga koalicioni qeveritar. Në opsion janë disa emra. Rikonstrukcion të Qeverisë do të ketë nëse zgjidhet kandidat që nuk vjen nga Aleanca për Shqiptarët, deklaroi kryeministri Zoran Zaev, në pyetjen e gazetarëve nëse ministri i Shëndetësisë do të jetë apo jo nga partia e Ziadin Selës.

"Akoma nuk kemi vendosur. Kemi filluar bisedime me partnerët e koalicionit, shpresojmë se deri në fund të kësaj jave do të mund të marrim vendim. Të gjitha opsionet janë të hapura, momentalisht as unë nuk e di se kush do të jetë emri, nga cila parti, kush do të zgjidhet nga kandidatët", tha Zaevi, duke theksuar se "konsultimet vazhdojnë, të gjitha opsionet janë të hapura, ndërsa para nesh, është shumë me rëndësi edhe vendimi personal, gjegjësisht për çfarë persona bëhet fjalë".

"Shëndetësia është lartë në pritjet e qytetarëve. Nëse vjen nga Aleanca për Shqiptarët, atëherë nuk do të ketë rikonstrukcion të Qeverisë. Nëse vjen nga ndonjë parti tjetër politike, është logjike se Aleanca mbetet në koalicionin qeveritar dhe duhet të ketë vend ministror. Për këtë janë të hapura të gjitha mundësitë për debat. Vendimtare do të jenë emrat që na qëndrojnë në dispozicion dhe kush do ta ndërmerret këtë funksion përgjegjës", tha Zaev. Ai informoi se ka marrë emër si propozim nga Aleanca për Shqiptarët për vendin e zbratur ministror, por ka edhe emra tjerë që dëshirojnë t'i shqyrtojnë me qëllim që të merret vendimi më i mirë i mundshëm.

"Në vendimmarrje duhet të na prijë emri i kandidatit që të mundet qytetarët, pacientët, mjekët, stafi mjekësor t'i besojë. Ky është minimumi që e presim, e pastaj së bashku me të gjithë shpresoj në reforma të suksesshme në shëndetësi për shkak se janë të domosdoshme", tha Zaev.

(E.H)

## Votohet nevoja për Ligjin e shqipes, BESA me amendamente

Shkup, 15 nëntor - Parlamenti i Maqedonisë e votoi nevojën për sjelljen e Propozim-ligjit për përdorimin e gjuhëve me çka ai hyn në fazën e dytë kur deputetët kanë mundësi të shtrojnë amendamente. Për nevojën e sjelljes së ligjit votuan 66 deputetë, ndërsa 41 ishin kundër. Koordinator i

grupit të deputetëve të VMRO-DPMNE-së, Ilija Dimovski, para votimit theksoi se partia e tij do të votojë kundër pasi që vlerësojnë se ligji është kundërkushtetues dhe është diskriminues ndaj gjuhës maqedonase dhe gjuhëve të tjera të cilat i flasin qytetarët në Maqedoni. "Ne nuk do të voto-

jmë për nevojën e sjelljes të këtij ligji. Do t'i shqyrtojmë të gjitha procedurat demokratike në fazën e radhës të mënjanohen lëshimet në këtë ligj", tha Dimovski. Pas votimit, Dimovski kërkoi gjysmë ore pushim dhe t'i dorëzohet lista e votimit. Amendamentet për Propozim-ligjin do të shqyrtohen

nga Komisioni për çështje evropiane, pasi që ligji është me flamur evropian. Në ndërkohë, deputetët e Lëvizjes BESA, edhe pse e përkrahën nevojën për sjelljen e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, kanë shumë vërejte lidhur me atë se si ky propozim ligj do të rregullojë këtë çështje

dhe përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, deklaroi Fadil Zendeli, deputet nga kjo parti duke paralajmëruar amendamente për tekstin. "Me këtë propozim-ligj nuk zyrtarizohet gjuha shqipe si gjuhë e dytë zyrtare", tha Zendeli, por vetëm nënkupton avancimin e përdorimit të gjuhës

shqipe në institucionet shtetërore. BESA do të parashtrijë amendamente për ato nene në Propozim ligjin për përdorimin e gjuhëve që kanë të bëjnë me atë që, siç tha deputeti Zendeli, gjuha shqipe të bëhet gjuha e dytë zyrtare në Republikën e Maqedonisë.(F.R)





## Deri në fund të javës do të propozohen dy gjykatës kushtetues

Shkup, 15 nëntor - Presidenti Gjorge Ivanov në pajtim me kompetencat e tij kushtetuese, deri në fund të javës në Parlamentin e Maqedonisë do të parashtrijë propozime për zgjedhje të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, konfirmuan për MIA-n nga kabineti i shefit të shtetit. Propozimet, siç paralajmëroi paraprakisht kabineti i presidentit Ivanov, do të dorëzohen pas përfundimit të zgjedhjeve lokale. Tash për tash nuk ka kandidat të propozuar edhe për vendin e tretë të zbrazët, i cili duhet të plotësohet me propozim të Parlamentit të Maqedonisë. Nga Kabineti i kryetarit të Parlamentit thonë se janë në komunikim me kabinetin e presidentit Ivanov dhe i presin emrat e propozim kandidatëve për gjykatës në Gjykatën Kushtetuese. Presidenti Ivanov duhet të propozojë kandidatë të cilët do të vijnë në vendin e gjykatësve Natasha Gaber Damjanovska dhe Gzime Starova, të cilëve mandati u ka përfunduar në tetor të këtij viti. Ata janë zgjedhur për gjykatës në Gjykatën Kushtetuese me propozim të presidentit Branko Cërvenkovski në vitin 2008. Gjykata momentalisht punon pa tre gjykatës. Krahas Gaber Damjanovska dhe Starovës, mandati në gusht të këtij viti i ka përfunduar edhe Ismail Dardhishtës, i cili në vitin 2008 u zgjodh me propozim të Komisionit parlamentarë për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve.

# Për 10 vjet, transferet buxhetore rriten për 260 për qind! Gropë e madhe te pensionet, buxheti rritet për 350 milionë euro

**Injeksionet financiare nga arka shtetërore në arkën e Fondit Pensional, për pagesën e rregullt të pensioneve janë rritur prej 153 milionë euro në vitin 2006 në 500 milionë euro këtë vit**

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 nëntor - Në periudhën e kaluar dhjetëvjeçare janë rritur për afër 260 për qind mjetet që transferohen nga Buxheti i shtetit në arkën e Fondit Pensional për pagesën e pensioneve. Vetëm në vitin 2018, në propozim-buxhetin për vitin 2018 janë parashikuar 500 milionë euro për mbulimin e gropës së madhe të Fondit Pensional si mjete që nuk mund të gjenërojë vetë arka e fondit. Kjo nënkupton se injeksionet financiare nga arka shtetërore në arkën e Fondit Pensional, për pagesën e rregullt të pensioneve - janë rritur prej 153 milionë euro në vitin 2006 - në 500 milionë euro këtë vit. Ekonomistët thonë se plakja e popullatës, ulja e numrit të të punësuarve që mbajnë një pensionist prej raportit 3 me 1 para 25 vitesh në 1.9 në 1 aktualisht, si dhe rritja e pensioneve më e madhe se rritja ekonomike, ka kontribuar në



gropën kaq të madhe financiare të Fondit Pensional, që nuk mund të mbulojë pagesën e pensioneve nga të ardhurat e saja vetanake.

Njëherazi, në periudhën e kaluar dhjetëvjeçare janë rritur edhe harxhimet e pensioneve si rrjedhojë e rritjes së numrit të pensionistëve, si dhe harmonizimit të pensioneve me rritjen e harxhimeve jetësore. Numri i pensionistëve është rritur prej 269.681 në vitin 2006 në 307.498 në tetor të këtij viti. Gjithashtu, harxhimet për pagesën e pensioneve në vitin 2016 ishin afër 48 miliardë denarë dhe janë rritur në raport me vitin 2007 për afër 84 për qind. Ekspertët ekonomik ndërkaq alarmojnë se ekzistojnë më shumë shkaqe të rritjes kaq të madhe të hollave që nga arka e shteti transferohen në arkën e Fondit Pensional. "Ulja e kon-

tributeve ishte faktor kryesor që ndikoi në rritjen e kësaj shume, ndërsa ndikim të madh kishte edhe rritja më e madhe e pensioneve se sa rritja ekonomike. Andaj, në të ardhmen, për zgjidhjen e minusit në arkën e Fondit Pensional si opsion mund të shqyrtohet rritja e shkallës së kontributeve për sigurim pensional, revizion i të drejtave për stazh të beneficuar, rishqyrtim i moshës për pensionim... e kështu me radhë", thotë profesori universitar Marjan Petreski. Sipas tij, nevojitet një analizë më e kompletuar dhe më e thellë me qëllim që të shikohen se cilat masat do të japin rezultatet më të mira.

Në ndërkohë, plakje të popullatës dhe ulje të mëtesuarve që mbajnë një pensionist parashikojnë analizat e

Fondit Pensional. Analiza e raportit aktual të Fondit Pensional të Maqedonisë tregojnë se do të rritet numri i pensionistëve nga afër 300 mijë në 470.000 në vitin 2050. Harxhimet për pagesën e pensioneve parashikohen të rriten prej afër 700 milionë euro në 1.5 miliardë euro, ndërsa pensionet mesatare pritet të zvogëlohen nga 53 në 43 për qind të pagës mesatare neto. Raporti alarmon se në periudhën e ardhshme, çdo ditë e më pak të siguar do të paguajnë për një numër më të madh të pensionistëve dhe do të paraqiten vështirësi në mbulimin e harxhimeve të Fondit Pensional. Analiza bazohen në projeksionet afatgjate për ardhmërinë e sistemit pensional në vend, të bazuar në lëvizjet e ardhshme demografike dhe ekonomike të përgatitura nga institucionet përkatëse. Sipas ekonomistëve, një nga zgjidhjet më pak të dhimbshme për mungesën e të hollave në sistemin pensional, me qëllim që ai të mos ketë nevojë të marrë injeksione financiare nga Buxheti i shtetit, si dhe vetë-qëndrueshmërisë së tij - është rritja e numrit të të punësuarve që do të mbushin arkën e Fondit Pensional. Megjithatë, një gjë e tillë lë shumë për të dëshiruar në kushte të rritjes modeste ekonomike të Maqedonisë që nuk hap shumë vende të reja pune në sektorin privat.

Nis java e Alfabetit 14-22 nëntor

## Ditët shqiptare në Manastir

Një javë e plotë me aktivitete që do të ngjasin nga 14 deri më 22 nëntor, përgjatë ditëve kur është zhvilluar Kongresi që përcaktoi alfabetin që do të përdorej për gjuhën shqipe. Edhe pse simbolet kombëtare, pankartat dhe afishet për programin festiv ende nuk janë vendosur. Aktivitetet kanë filluar në bashkëpunim me Muzeun e Alfabetit, Sekretariatit për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, si edhe Ministrisë së Kulturës



Nueri shton se janë marrë masat që të mos ketë incidente. Kjo edhe për shkak të vizitës së presidentit Meta, më 21 nëntor, i cili do të vizitojë edhe komunën. Më 21 do të zhvillohet edhe një tribunë shkencore, në bashkëpunim me Institutin e Trashëgimisë në Shkup, si edhe Institutit Albanologjik dhe Historisë nga Prishtina e Tirana. Për 22 nëntor, manifestimi që nis në Shkup me mbledhimin e doajenëve të arsimit në SIMO do të vazhdojë për në Muzeun e Alfabetit, ku në darkë në hotel Epinal do të mbahet një koncert gala, me pjesëmarrjen e Filharmonisë "Ibrahim Madhi" së Akademisë së Arteve në Tiranë. Ndërkohë që vetë muzeu ndodhet në një situatë të ngjashme për gati dhjetë vjet me radhë, sa i takon kontestit pronësor. As nga SIMO dhe as nga Ministria e Kulturës nuk kanë arrihur që të gjejnë mundësitë që ambientet e shpronësuar të muzeut t'i rikthehen. I vetmi lajm i mirë për këtë vit është miratimin e projektit për rikonstruktimin e plotë të godinës nga fondet e IPA, projekt ky që është shtyrë për të filluar në fillimin të muajve të pranverës.

zhvilluar Kongresi që përcaktoi alfabetin që do të përdorej për gjuhën shqipe. Aktivitetet kanë filluar në bashkëpunim me Muzeun e Alfabetit, Sekretariatit për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, si edhe Ministrisë së Kulturës. Por, si ngjarjet më kryesore janë vizita e presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta, delegacioneve nga ministrive të kulturës nga Kosova e Shqipëria, si edhe koncerti gala me të

cilën do të mbyllet kjo javë. Kolonia artistike që nisi të martën shënoi hapjen zyrtare të siparit të manifestimeve që do të zhvillohen gjatë këtyre ditëve në bashkëpunim edhe me shoqatat dhe shoqëritë kulturore të qytetit. "Manastiri ka nevojë që kjo datë e shënuar për shqiptarët të mos jetë vetëm një apo dy ditë. Ideja që kjo festë të shënohej me aktivitete po aq ditë sa zgjatën edhe punimet ka

lindur dy vjet më parë, por që nuk është realizuar për shumë arsye, sidomos për të mos provokuar incidentet. Kjo festë këtë vit po vihet në një vëmendje më të madhe, por po ashtu mund të them se edhe vetë interesi për muzeun ka ndryshuar, është më i madh, i vetë njerëzve që e vizitojnë si nga vendi, ashtu edhe nga jashtë. Por, këto organizime shërbejnë edhe për popullsinë shqiptare që të festojë këtë ditë

ndryshe, me hapur dhe siç e meriton. Jo rastësisht insistuam që edhe të riaktivizojmë një prej shoqërive më të vjetra, Bashkimi, si pjesë të programit. Shqiptarët jetojnë të shpërndarë në Manastir, jo të gjithë fëmijët frekuentojnë mësimin në gjuhën shqipe, kështu do të kenë mundësi të shoqërohen, dhe ne përmes tyre të ruajmë dhe kultivojmë traditat tona", thotë drejtori Nuer Arslani. Sa i takon aktiviteteve,

Koha Evis HALILI

Shkup, 15 nëntor - Përvjetori i 109-të i Kongresit të Manastirit këtë vit për herë të parë do të festohet ndryshe. Edhe pse simbolet kombëtare, pankartat dhe afishet për programin festiv ende nuk janë vendosur. Një javë e plotë me aktivitete që do të ngjasin nga 14 deri më 22 nëntor, përgjatë ditëve kur është





Në një pako ndryshimet e ligjeve për siguri



Nevoja për kontroll të pavarur mbi punën e policisë së shtetit, siç thuhet në arsyetimin e Ministrisë së Drejtësisë, buron nga standardet e Konventës evropiane për mbrojtjetë të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nga aktgjykimet e miratuara nga Gjykata e Strasburgut

# Prokuroria do ta kontrollojë punën e MPB-së

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 15 nëntor - Ministria e Mbrojtës edhe zyrtarisht i ka filluar përgatitjet e një sërë ligjesh, të cilët kryesisht lidhen me sigurimin e kontrollit të jashtëm dhe të pavarur për aktivitetet dhe punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në njoftimin e publikuar në Regjistrin elektronik të shkresave gjyqësore, Ministria e Drejtësisë ka paralajmëruar se plotësim-ndryshimeve do t'i nënshtrohen Ligji për prokurori publike, Ligji për shërbimin prokurorial, Ligji për Këshillin e prokurorëve, si dhe Ligji për procedurë penale. Përgatitja e propozim-versioneve, siç thonë nga kjo ministri, duhet të përfundojë deri më 24 nëntor. Kontrollin e punës së policisë të rregullt të MPB-së, dhe policisë së burgjeve,

e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në bazë të ndryshimeve të paralajmëruara, në të ardhmen pritet ta realizojë Prokuroria Publike. "Implementimi i mekanizmit të pavarur për kontroll të jashtëm, në legjislacionin tonë për pjesëtarët e MPB-së dhe policisë së burgjeve, paraqet njërin prej segmenteve të vendosjes së kontrollit nga ana e Prokurorisë Publike. Në kuadër të këtij mekanizmi kontrollues, rol të rëndësishëm planifikohet të kenë hetuesit e Prokurorisë Publike", thuhet në arsyetimin ndryshimeve të paralajmëruara. Nevoja për kontroll të pavarur mbi punën e policisë së shtetit, siç thuhet në arsyetimin e Ministrisë së Drejtësisë, buron nga standardet e Konventës Evropiane për

mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nga aktgjykimet e miratuara nga Gjykata e Strasburgut. Korniza aktuale ligjore, sa i përket punës së policisë dhe veprimeve të tyre, parashihet që kontrollin dhe hetimet në MPB-së ta realizojë Sektori për kontroll të brendshëm në këtë resor. Opinioni më i gjerë, përfshi edhe institucionet shtetërore, në këtë rast zyra e Avokatit të Popullit, pothuajse në të gjitha raportet e punës, e ka cilësuar këtë Sektor si tejet problematik, gjegjësisht vendimet për punën e nëpunësve që janë të angazhuar në këtë departament të policisë janë cilësuar si vendime selektive dhe aspak profesionale. Ndryshe, pas ndërrimit të pushtetit në qershor të këtij viti, duke ju referuar njoftimeve të MPB-së, thuhet

se ndaj pjesëtarëve të policisë gjatë 3-4 muajve të fundit janë shqiptuar një varg masa disiplinore, përfshi edhe përjashtime nga puna. Ndryshe, kur jemi te kontrolli mbi strukturat e policisë, nga MPB kanë bërë të ditur se tre agjentë të policisë sekrete, tetë pjesëtarë të Byrosë për Siguri Publike dhe një anëtar i Drejtorisë së Gjashtë, i cili ka qenë i angazhuar për sigurinë e ish-kryeparlamentarit Trajko Veljanovski, e përbëjnë grupin e parë prej 12 policëve, të cilët kanë marrë vendime për përjashtim nga puna. Në arsyetimin e këtij vendimi nga Sektori për kontroll të brendshëm të policisë kanë theksuar se për personat e apostrofuat ekzistojnë dëshmi materiale se kanë marrë pjesë në sulmin brutal ndaj Parlamentit më 27 prill.

Kronikë

## Lëndohet rëndë punëtori nga Shqipëria

57 vjeçari XH.Sh nga fshati Sllatinë, të martën mbrëma rreth orës 20 e 30 minuta, ka denoncuar se gjatë ditës, duke kryer punë në pronën e tij në fshatin Jançisht, ka angazhuar dy shtetas të Shqipërisë R.S., 19 vjeçar dhe E.K., 23 vjeçar, të cilët kanë punuar me traktor dhe me makineri shtesë për përpunimin e misrit dhe me rimorkio. Njëri prej tyre, sipas denoncimit të XH.Sh., gjatë mënjanim të një defekti rreth orës 15 e ka lënduar dorën.

Me lëndime serioze në dorë janë dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës dhe si rast urgjent janë dërguar në Klinikat e Shkupit. Për shkak të kushteve jo të përshtatshme, hetim në vendin e ngjarjes është kryer gjatë ditës së mërkurë, me rast do të zbardhen edhe detajet tjera se si ka ndodhur lëndimi i shtetasit të Shqipërisë. Përndryshe, dy shtetasit e Shqipërisë kanë qëndruar të pa lajmëruar, ndërsa R.S rreth orës 23 është arrestuar dhe mbajtur në Stacionin Policor në Tetovë për procedurë të mëtejshme.

## Tetovarit i vjedhin 4 mijë franga

Të martën mbrëma, mes orës 19.45 minuta dhe orës 21.00, deri më tani persona të panjohur kanë kryer një vjedhje të rëndë në shtëpinë e 55-vjeçarit me iniciale M.K. nga Tetova në rrugën "Kiro Ristovski-Drnc", në Tetovë. Duke shfrytëzuar mungesën e familjarëve në shtëpi, vjedhësit me forcë kanë hapur derën hyrëse dhe në tërësi kanë kërkuar dhomat e gjumit në katin e parë, pas çka nga një komodinë kanë marrë rreth 4000 franga zvicerane, si dhe 850 euro të cilat kanë qenë të fshehura nën disa veshje, si dhe një tablet "Acer", dhe bizhuteri të ndryshme. Më gjësendet e vjedhura, në mënyrë të paligjshme vjedhësit kanë përfutur rreth 280 mijë denarë, dhe pa u vërtetur nga askush, përmes dritares nga dhoma e fëmijëve janë larguar nga shtëpia. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e plotë dhe zbulimin e autorëve të kësaj vjedhjeje.

## Dy aksidente, katër këmbësorë të lënduar

Të martën mbrëma, rreth orës 17.00, në rrugën "Ivo Lolla Ribar" në Tetovë ka ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin një veturë e tipit "Hundai Akcent", me targa të Tetovës, e drejtuar nga 60-vjeçari me iniciale SH.R. nga Tetova ka aksidentuar këmbësoren 18-vjeçare me iniciale SH.R., gjithashtu nga Tetova.

Në këtë aksident SH.R., për pasojë ka marrë një thyerje në hundë dhe lëndime të tjera, pas çka me të njëjtën veturë është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, ku është mbajtur për shërim të mëtejshëm. Sipas njohurive fillestare që dalin nga ekspertiza e kryer në vendin e ngjarjes, si shkak për këtë aksident është mos përshtatja e shpejtësisë.

Në rrugën "Zhivko Brajkovski", në Gostivar, të martën rreth orës 18.00 ka ndodhur një aksident komunikacioni ku një veturë e tipit "Opel Vectra", të cilën e ka drejtuar 74-vjeçari me iniciale XH.SH nga Gostivari ka aksidentuar tre këmbësore femra 18-vjeçaren M.S nga Kanatlarci i Prilepit, 18-vjeçaren A.F si dhe 17-vjeçaren N.F. nga Debreshi i Prilepit.

Nga goditja e veturës, lëndime trupore ka marrë M.S., përderisa A.F. dhe N.F. fatmirësisht kanë kaluar pa lëndime. Që tri vajzat, me anë të një veture tjetër janë dërguar në spitalin e Gostivarit dhe pas marrjes së ndihmës janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Po ndërmerren masa për zbardhjen e shkakut të këtij aksidenti, përderisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet të jetë rreth 20 mijë denarë. (U.H)

## Anulohet gjykimi për vrasjen e Almir

Kumanovë, 15 nëntor - Për shkak të mungesës me arsyetim të mbrojtjes së të tre të akuzuarve për dhunë, dje në gjykatën e Kumanovës është anuluar seanca kundër të akuzuarit Boban Iliq, i cili akuzohet se vjet e ka vrarë katërvjeçarin Almir Aliu, njoftuan avokatët e përfshirë në këtë rast. Avokatët informuan se seanca e radhës do të mbahet më 29 nëntor, ku pritet të thuhet fjalët përfundimtare dhe më pas të shpallet edhe aktgjykimi. Natën e 25 qershorit të vitit 2016, nga një veturë e tipit Mercedes "C200", drejtuesi i të cilit ishte Boban Iliq, u shtyp për vdekje vogëlushi 4 vjeçar Almir Aliu.

## Shtyhet seanca për rastin "Treqind"



Shkup, 15 nëntor - Nëse dikush ka kryer ndonjë vepër penale, do ta hetojë deri në fund, qoftë edhe në prag të vdekjes. Me këto fjala prokurorja speciale, Fatime Fetaj, të mërkurën i është drejtuar Trupit gjykues në rastin "Treqind", ku i akuzuari kryesor, ish-ndihmës ministri i Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski, nuk u paraqit në seancën me arsyetim të problemeve shëndetësore. Gjykimi për rastin "Treqind", lëndë kjo e iniciuar nga Prokuroria Speciale Publike, u dorëzua në fund të muajit qershor të këtij viti, ndërkohë seanca e radhës është caktuar të mbahet me datë 21 nëntor. Arsyetimi i palës mbrojtëse të të akuzuarit Popovski, ishte se klienti i tyre qëndron në pushim mjekësor me rekomandim të mjekut. Ndaj kësaj deklarate, prokurorja Fetaj shprehu dyshime dhe i propozoi gjykatës që të caktojë persona ekspert, të cilët do ta vërtetojnë faktin se vallë, ish funksionari Gjoko

Popovski, mund të paraqitet në seancë gjyqësore, ose jo. "Ai është i akuzuar dhe ndaj tij po zhvillohet një procedurë. Fakti se është i sëmurë nuk nënkupton se duhet të mungojnë në seanca gjyqësore. Askund nuk qëndron se ai është i penguar të paraqitet në seancë. Me situatën e njëjtë u përballëm edhe gjatë fazës së hetimeve, kur ai nuk u paraqit në prokurori për të dhënë deklaratë. Atëkohë, komisioni mjekësor më njoftoi se ai është i kufizuar në lëvizje dhe qëndrim, respektivisht nuk është i palëvizshëm dhe se mund të flet", tha prokurorja Fetaj në sallën e Gjykatës Penale të Shkupit. Me këtë rast, reagimi i menjëhershëm ishte i palës mbrojtëse të të akuzuarit. Avokatja e të akuzuarit Popovski, Sanja Vasiq, tha se në rast se prokurorja vazhdon të silltet në këtë mënyrë, ajo mund të dënohet. Seanca gjyqësore e caktuar për javën tjetër pritet të mbahet në një ditë me rastin "Trust".





Ligji për mbrojtjen e informatorëve nuk po gjen zbatim

# Shans i dytë për informatorët

I quajtur edhe Ligji për "mbrojtje të informatorëve", sipas shprehjes për informatorët që përdoret në Ligjin amerikan, hyri në fuqi në mars të vitit 2016, por deri tani, për fat të keq, para gjykatave në Maqedoni nuk ka asnjë lëndë që mbështetet në deklaratat e tyre

Shkup, 15 nëntor - Lufta kundër korrupsionit është një nga sferat ku Maqedonisë vazhdimisht i drejtohet vërejtje në një sërë raportesh të KE-së, ndërsa u theksua edhe në Raportet e Pribesë për atë se si vendi duhet të tregojë rezultate në kontekst të prioritetëve urgjente reformuese. Ligji për mbrojtje të informatorëve, i miratuar në nëntor të vitit 2015, si një prej obligimeve të dala nga Marrëveshja e Përzahos, e që duhej të kontribuojë në ballafaqimin me korrupsionin, nuk i dha rezultatet e pritura. I quajtur edhe Ligji për "mbrojtje të informatorëve", sipas shprehjes për informatorët që përdoret në Ligjin amerikan, hyri në fuqi në mars të vitit 2016, por deri tani, për fat të keq, para gjykatave në Maqedoni nuk ka asnjë lëndë që mbështetet në deklaratat e tyre.

Drejtori për punë juridike në projektin për përgjegjësi qeveritare nga Uashingtoni, Tom Devajn, i cili javën e kaluar me ftesë të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë mbajti ligjëratë me temë "Roli i mediave në zhvillimin e imazhit publik të informimit", vlerësoi se Maqedonia ka një prej ligjeve më të mira për mbrojtje të informatorëve në Evropë, por vetëm në letër, për shkak se nevojiten ndryshime të konsiderueshme plotësuese ligjore dhe vendosja të strukturës adekuate që ai të fillojë të japë rezultate. "Një prej hapave të parë që duhet të ndërmerren në drejtim të përmbyshjes së këtyre qëllimeve është që Ministria dhe institucionet e tjera shtetërore që kanë çfarëdo lloj kompetencash lidhur me implementimin e këtij Ligji ta vendosin strukturën e domosdoshme dhe sistemit për funksionim të Ligjit për praktikë. Pastaj duhet të sigurohet trajnim adekuat për të punësuarit, për udhëheqësit e tyre dhe për gjykatësit të cilët do të vepronin pas lëndëve të tilla. Dhe e treta dhe më e rëndësishme është që të sigurohet fushatë publike, gjegjësisht e gjithë popullata të njoftohet me Ligjin dhe mbrojtjen që ai e ofron", thotë Devajn. Ai theksoi se në SHBA një Ligj i këtillë ekziston një



## NË SHBA, LIGJI ËSHTË MIRATUAR NË VITIN 1979

Ligji i parë për mbrojtjen e "informatorëve" është miratuar në vitin 1979 në SHBA. Tom Devajn, i cili punon në përgjegjësinë dhe llogaridhënie të pushtetit nga vendosja e ligjit, nga vitit 1979 deri më tani ka punuar në mbrojtjen e mbi 7.000 informatorëve brenda dhe jashtë SHBA-së, vlerëson se miratimi i tij paraqet revolucion të vërtetë në sferën e legjislacionit. Sot 37-të shtete në botë kanë miratuar ligj për mbrojtjen e informatorëve, ndërsa edhe në 60-të shtete të tjera ekzistojnë ligje për mbrojtjen e tyre, por në sektorë të tjerë. Sipas tij, informatorët sot janë shumë të suksesshëm sepse përmes reagimeve të pushtetit në ankesat e tyre mbrohen njerëzit prej veprave të ndryshme kriminale, parregullsive në veprimin e institucioneve shtetërore, por edhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit jetësor në tërësi. "Përmes informatorëve dhe asaj që kanë ta thonë mund të mbrohet vendi prej katastrofave të mëdha, të parandalohet ndonjë Çernobil i ardhshëm. Në sferën e shëndetit në SHBA u zbulua se shumë prej qumështit që përdoret për të pirë përmban materiale të dëmshme për shëndetin, që ka qenë rezultat nga informatorët. Mbrojtje më e madhe në sferën e shëndetit dhe mjekësisë janë regjistruar të ilaçet, ku informatorët kanë zbuluar se më shumë se 50-të ilaçe përmbajnë substanca të dëmshme dhe në këtë mënyrë janë shpëtuar më shumë se 50.000 jetë të qytetarëve, që është e barabartë me numrin e viktimave nga lufta në Vietnam", thekson eksperti amerikan.

## SLLAGJANA TASEVA

Institucionet të cilat janë kompetente për denoncim të jashtëm si MPB, Prokuroria Publike, Avokati i Popullit dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) në të njëjtën kohë duhet të kenë edhe denoncim të brendshëm për vete edhe për të punësuarit e tyre, gjegjësisht të kenë rol të dyfishtë. Për ta kjo është më e komplikuar nga aspekti i sigurimit të kapaciteteve, të resurseve. Nëse i pyesni njerëzit nga KSHPK, të cilët janë të obliguar që të përgatisin raport vjetor për zbatimin e ligjit, do ta shihni se deri më tani nuk ka asnjë denoncim prej ndonjë informatori



kohë të gjatë, por u janë nevojitur 40 vite të plota që të realizohen disa rezultate pozitive. Në Maqedoni, sipas tij, ky do të jetë proces që kërkon punë të pandërprerë dhe kohë. Thotë se në qoftë se të gjithë e realizojnë detyrën e tyre rezultatet mund të vijnë shumë shpejt. Kryetari i SHGM-së, Naser Selmani, ndërkaq theksoi se Maqedonia e miratoi Ligjin për informa-

torë në vitin 2016, por ai nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe pothuajse nuk zbatohet pasi, siç thotë ai, sistemi frikësohet prej transparencës dhe llogaridhënie. Selmani thekson se lëshime thelbësore tek Ligji janë mënyra e denoncimit të kriminit dhe dënimi i personave të cilët do ta zbulojnë identitetin e informatorëve.

"Tek ne, informatorët pretendimet për krimin fillimisht duhet t'i denoncojnë në institucionin ku punojnë, në Prokurorinë Publike dhe polici, ndërsa nëse ata nuk ndërmarrin asgjë - atëherë kanë të drejtë ato t'i prezantojnë në opinion. Në botë është e kundërta, informatorët kanë të drejtë drejtpërdrejt t'i denoncojnë keqpërdorimet e institucioneve në opinion. Lëshimi i

## NASER SELMANI

Tek ne, informatorët pretendimet për krimin fillimisht duhet t'i denoncojnë në institucionin ku punojnë, në Prokurorinë Publike dhe polici, ndërsa nëse ata nuk ndërmarrin asgjë - atëherë kanë të drejtë ato t'i prezantojnë në opinion. Në botë është e kundërta, informatorët kanë të drejtë drejtpërdrejt t'i denoncojnë keqpërdorimet e institucioneve në opinion. Lëshimi i dytë është dënimit e personave të cilët do të zbulojnë identitetin e informatorit janë shumë të ulëta dhe praktikisht informatorët me dënime të tilla të ulëta janë të pambrojtur



dytë është dënimit e personave të cilët do të zbulojnë identitetin e informatorit janë shumë të ulëta dhe praktikisht informatorët me dënime të tilla të ulëta janë të pambrojtur", thotë Selmani. Sllagjana Taseva e "Transparensi Interneshënall Maqedoni", e cila mori pjesë në përgatitjen e Ligjit, theksoi se në mënyrë intensive po punohet në ndryshimin dhe plotësimin e ligjit ekzistues midis tjerash në bazë të rekomandimeve të Komisionit të Venecias, ndërsa po bisedohet edhe për përpunimin e strategjisë gjithëpërfshirëse për ngritjen e vetëdijes publike për përmbyshjen e saj dhe për zbatimin e saj. Si një prej shkaqeve për mosfunksionimin e ligjit e theksoi nevojën e resurseve edhe në institucionet edhe në sektorin privat. "Institu-

cionet të cilat janë kompetente për denoncim të jashtëm si MPB, Prokuroria Publike, Avokati i Popullit dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) në të njëjtën kohë duhet të kenë edhe denoncim të brendshëm për vete edhe për të punësuarit e tyre, gjegjësisht të kenë rol të dyfishtë. Për ta kjo është më e komplikuar nga aspekti i sigurimit të kapaciteteve, të resurseve. Nëse i pyesni njerëzit nga KSHPK, të cilët janë të obliguar që të përgatisin raport vjetor për zbatimin e ligjit, do ta shihni se deri më tani nuk ka asnjë denoncim prej ndonjë informatori", tha Taseva. Edhe statistika, shtoi ajo, tregoi se shumë pak institucione kanë vendosur sistem për denoncim të brendshëm dhe se është më i madh numri i kompanive private të cilat e kanë bërë një gjë të tillë. "Institucioni i vetëm i cili ka bërë diçka për denoncimin e jashtëm është KSHPK, i cili në ueb faqen e vet publikon se si mund të bëhet një gjë e tillë. Nga MPB kemi informacion se aktet janë sjellë dhe se personi është përcaktuar, presim se çfarë do të ndodh më tej", thekson Taseva. Sipas saj, në ligje duhet të vendosen mekanizma të cilat do t'i bëjnë të zbatueshme, gjegjësisht zbatimet do t'i bëjnë të obligueshme, pasi që në institucionet e sektorit publik askush nuk ka pësuar ndonjë pasojë pasi që në dy vitet e kaluara askush nuk ka bërë asgjë për mbrojtjen e informatorëve dhe se nuk ka kurrfarë përgjegjësie - as pasojë, as kontroll e as kundërvajtje.

Ndryshe, paraqitja e mbrojtur në kuptim të Ligjit për mbrojtje të informatorëve në Maqedoni definohet si paraqitje me të cilën, në pajtim me këtë ligj, transmetohet dyshimi i matur apo njohuria se është kryer, po kryhet apo se është e mundshme se po kryhet ndonjë veprim i dënueshëm apo ndonjë tjetër joligjor apo i palëjgjuar, me të cilin shkelet apo rrezikohet interesi publik.

Interesi publik me këtë rast definohet si mbrojtje e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit, të pranuar me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, parandalim i rreziqeve për shëndetin, mbrojtjen dhe sigurinë, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe të natyrës, mbrojtje të pronësisë dhe të lirisë së tregut dhe sipërmarrësisë, sundimi i së drejtës dhe parandalimi i kriminit dhe korrupsionit. (MIA.MK)

## PËRVOJAT NË RAJON DHE EVROPË

Eksperti amerikan Devajn si shembull të funksionimit të mirë të Ligjit për informatorë e përmend Serbinë, ku ligji është miratuar para një viti e gjysmë dhe ku është kryer trajnim për të gjitha palët e interesuara, si dhe fushatë e fuqishme për njohje të popullatës me Ligjin dhe mundësitë që i ofron ai, përkatësisht të sigurohet njohuri për ligjin dhe njerëzit të jenë të gatshëm të informojnë, përkatësisht të tregojnë për korrupsion dhe krim. "Faktet janë se Serbia vetëm në gjashtë muajt e parë nga zbatimi i Ligjit ka dhjetëra e dhjetëra raste të suksesshme për dallim nga SHBA-ja, ku në dhjetë vitet e para nga zbatimi i Ligjit, rastet e tilla janë mundur të numërohen në gishtat e një dore", thotë eksperti amerikan

për mbrojtje të informatorëve. Në Itali, sipas Lluka Trifone nga Agjencia e tyre për antikorrupsion (ANAK), Parlamenti ende diskuton për ligjin për informatorët. Atë që ata bënë është se u dhanë autorizime të mëdha personave të cilët janë përgjegjës për parandalim të korrupsionit dhe për transparencë të cilët emërohen në pajtim me ndryshimet në Ligjin e tyre për parandalim të korrupsionit. "Në secilën administratë duhet të ketë një person të tillë përgjegjës për parandalim të korrupsionit. Zgjedhja jonë ishte ky person të ketë kompetenca edhe për informatorët. Ai person duhet të kujdeset edhe për mbrojtjen e identitetit të informatorit dhe i pranon paraqitjet nga informatorët", thotë Trifone.





## Shkup, 10 aksidente për 24 orë

Shkup, 15 nëntor - Shtatë persona janë lënduar më lehtë në pesë prej gjithsej 10 aksidenteve të regjistruara gjatë ditës së kaluar në rajonin e SPB Shkup. Në pesë aksidente janë shkaktuar dëme materiale. Siç informon MPB, gjatë ditës së djeshme policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar numër më të madh të kundërvajtjeve. Dyzet e tre shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se sa e lejuara dhe tre shoferë të cilët kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe. Katëmbëdhjetë persona janë përjashtuar nga komunikacioni për shkak të drejtimit të automjetit nën ndikimin e alkoolit, 10 shoferë të cilët nuk e kanë fituar të drejtën e drejtimit të automjetit dhe dy shoferë fillestarë. Janë sanksionuar katër këmbësorë të cilët kanë kaluar jashtë kalimit të shënuar për këmbësorë, gjegjësisht kanë kaluar në dritë të kuqe të semaforit. Janë sanksionuar 41 automjete të parkuara në mënyrë jo të rregullt. Me ndihmën e automjetit special të karrotrecit, janë larguar 88 automjete.

## Një shqiptar gjendet i vdekur në Strugë

Shkup, 15 nëntor - Tridhjetë e nëntëvjeçari F.Sh. nga Peshkopia e Shqipërisë të martën është gjetur i vdekur në një furgon në atarin e fshatit Livadhi të Strugës, kumtoi policia. Ekspertizë në vendin e ngjarjes kanë kryer prokurori publik dhe një ekip i Stacionit policor Strugë. Më pas, është përcaktuar se F.Sh. ka qenë i angazhuar te D.R. nga fshati Livadhi si bari, ndërsa furgonin e ka shfrytëzuar si bujtinë. Në furgon është gjetur një ngrohës me gaz i cili është përdorur për ngrohje. Me urdhër të prokurorit publik, mbi trupin është bërë obduksion, me ç'rast është konstatuar se F.Sh. ka vdekur nga helmimi me monoksid karbon. Trupi i personit të ndjerë, pas sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm për transport në Shqipëri, do t'i dorëzohet familjes.

Shpërblehen kompanitë me praktika më të mira shoqërore

Me vendim të komisioneve të jurisë, me statutet në kategorinë "raporti ndaj të punësuarve" në solemnitet u shpërblye kompania "Alkaloid", në kategorinë "menaxhim etik" Rade Konçar TEP, ndërkaq për "Raporte në treg" Ramstor Maqedoni". Statuetë për kategorinë "raport ndaj mjedisit jetësor" morën "Legurat e Shkupit", "Adora inzhenering" dhe Instituti ndërtimor Maqedoni, ndërkaq në kategorinë "Investim në bashkësi", "EVN Maqedoni", "Farmahem" dhe OKTA

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 15 nëntor - Po rritet numri i kompanive në Maqedoni të cilat zbatojnë praktika me përgjegjësi shoqërore, por kjo duhet të bëhet standard i pranuar në përgjithësi. Ky koncept i ndërmarrjeve u sollti edhe fitim edhe ua rriti konkurrencën, u porosit sot gjatë edicionit të dhjetë të ndarjes së "Çmimit nacional për praktika më të mira me përgjegjësi shoqërore në vitin 2017".

"Gëzon fakti që gjithnjë e më tepër kompani në Maqedoni janë vetëdijësuar se me investimin në përgjegjësinë shoqërore, investojnë në konkurrencën e vet më së shumti për shkak se këto praktika u bënë praktikë dhe parakusht për punë dhe eksport në tregjet e huaja, posaçërisht në tregun e BE-së", tha në fjalimin e tij kryeministri Zoran Zaev. Sipas tij, nëse ndonjë kompani dëshiron të realizojë fitim, duhet të kujdeset edhe për ambientin, shoqërinë dhe për bashkësinë në të cilën e realizon biznesin e vet. Kompanitë të cilat zbatojnë përgjegjësi korporative dhe shoqërore, vërejt, kanë dy deri tre për qind fitim më të madh se konkurrentët e tyre. Në konkursin vjetor për çmimin u paraqitën gjithsej 34 projekte, 10 të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ndërsa 24 të ndërmarrjeve të mëdha. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve që aplikojë

# Alkaloidi sërish e para



janë nga sektori shërbyes, sektori financues dhe ai i TI-së, ndërkaq më të shumta ishin aplikimet me projekte në kategorinë "Investim në bashkësi".

Këtë vit për herë të parë aplikuan tetë ndërmarrje, apo 32 për qind e numrit të përgjithshëm, që sipas ministrit të Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, flet se interesi i ndërmarrjeve për pjesëmarrje në çmimin prej vitit në vit po rritet.

"Kjo tregon se koncepti i përgjegjësisë shoqërore bëhet pjesë përbërëse e punës së subjekteve përgjegjëse në Maqedoni sipas shembullit të atyre evropiane", tha Bekteshi. Siç potencoi ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carkovska, kompanitë i pranojnë thirrjet dhe kyçen në aktivitetet për mbrojtje sociale, por është shumë me rëndësi që nismat e deritanishme ad hok të shndërro-

hen në zgjidhje sistematike me përfitime në këtë fushë. "Shpresoj se praktikat për përgjegjësi shoqërore një ditë do të bëhen praktika standarde të pranuar në përgjithësi", tha Carovska.

Euroambasadori Samuel Zhbogar u bën thirrje autoriteteve të përkushtohen më shumë në realizimin e qëllimeve për përgjegjësi sociale të ndërmarrjeve dhe të zhvillojnë masa inovative në mënyrë që të mund ta dëshmojnë këtë qasje. Me vendim të komisioneve të jurisë, me statutet në kategorinë "raporti ndaj të punësuarve" në solemnitet u shpërblye kompania "Alkaloid", në kategorinë "menaxhim etik" Rade Konçar TEP, ndërkaq për "Raporte në treg" Ramstor Maqedoni". Statuetë për kategorinë "raport ndaj mjedisit jetësor" morën "Legurat e Shkupit", "Adora inzhenering" dhe Instituti ndërtimor Maqedoni, ndërkaq në kate-

gorinë "Investim në bashkësi", "EVN Maqedoni", "Farmahem" dhe OKTA. U ndanë edhe mirënjohje jubilarë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme më të shpërblyera. Sipas rekomandimeve të komisionit të jurisë, kompanitë në të ardhmen duhet t'i kushtojnë më tepër vëmendje qasjes inovative gjatë ideimit dhe zbatimit të praktikave, t'i sqarojnë më hollësisht përfitimet afariste dhe shoqërore të projekteve si dhe të tregojnë bashkëpunim më të madh me organizatat civile, institucionet dhe përfaqësuesit e tjerë të sektorit jofitimprurës. Çmimi nacional për praktika më të mira me përgjegjësi shoqërore në Maqedoni ndahet tashmë për të dhjetin vit jubilar. Në atë periudhë 173 ndërmarrje vendore aplikuan me 540 praktika me përgjegjësi shoqërore, prej të cilave janë shpërblyer 252.

## 600.000 EURO PËR TETË GRANTE

Grante për përfundim të kapaciteteve të organizatave qytetare për krijim dhe ndjekje të politikave dhe mbështetje të reformave në Kapitullin 20, si dhe promovimin e qasjeve të reja, mekanizma dhe instrumente nga sfera e sipërmarrjes dhe industrisë në nivel lokal dhe nacional, do të marrin tetë organizata në kuadër të projektit "Përfundimi i kapaciteteve dhe mekanizmeve për mbështetje të procesit reformues të Kapitullit 20 (YESNeteork +)", financuar nga BE-ja. Në Info ditën për thirrjen për ndarje të granteve, Sofia Cali Kuzmanova nga Fondacioni PSM tha se është paraparë fond prej 60.000 eurove për financim të tetë projekteve, prej të cilave katër nga 5.000 euro në nivel lokal dhe katër nga 10.000 euro në nivel nacional. "Ideja është të përfundohen kapacitetet e organizatave civile që të mundin bashkëpunim si një trup, përmes platformës për Kapitullin 20 dhe rrejtit i cili përfshin mbi 40 organizata qytetare, të mund të veprojnë në këtë fushë dhe së bashku me faktorët e tjerë të kësaj reforme strukturore, që janë kyçe për procesin e integritetit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian", tha Kuzmanova. Konkursi është i hapur deri më 4 dhjetor, ndërsa projektet do të realizohen në periudhë prej janarit deri në korrik të vitit 2018.

Angjushev për llogaridhënien

# Gruevski më shumë harxhoi për shëtitje sesa ndihmoi kompanitë

Shkup, 15 nëntor - Zëvendëskryeministri i angazhuar për Çështjet Ekonomike, Koço Angjushev për MIA-n deklaroi se Qeveria e braktis praktikën e jotransparencës dhe llogaridhënies në tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në vend dhe se do të vendosë atashe ekonomikë si pjesë përbërëse e ambasade në vendet të cilat janë partnerë tradicionalë të Maqedonisë. Në margjinat e Forumit transatlan-

tik për bashkëpunimin ekonomik që dje u mbajt në Uashington, ku Angjushev mbajti fjalimin në panel diskutimin e titulluar "Maqedonia: Kthimi i një faqe të re", ai tha se Qeveria zhvillon masa atraktive për të tërhequr investime të huaja në Maqedoni. "Është shumë me rëndësi këto masa të jenë transparente, që do të thotë se çdo investues vendas ose investues i huaj i posaçëm e di saktësisht se çfarë mund të

presë nga Qeveria në pajtim me kriteret e caktuara", tha zëvendëskryeministri. Ai theksoi se parakusht është që investimi të jetë fitimprurës dhe kompanitë të rriten, ndërsa Qeveria atëherë do t'i mbështetë këto kompani me mjete buxhetore në lidhje me pagat e paguara neto të punëtorëve. "Së pari, nëse një kompani paguan një pagë mujore më të madhe se 300 euro, Qeveria do ta mbështesë me

10 përqind në çdo pagë të paguar. Qeveria ndërmerr masa edhe për mbajtjen e kuadrove me arsim të lartë në Maqedoni, me ç'ka kompanitë të cilat paguajnë paga mujore prej 700 eurosh (dy paga mesatare) mjetet kthyes do të jenë 20 për qind nga paga e paguar", tha Angjushev. Më tej, për secilën kompani që investon në Maqedoni dhe tregon rritje, informon Angjushev, Qeveria është e gatshme të pa-

guajë 10 për qind nga mjetet të investuara në vitin e parë. Por nëse kompania është e orientuar drejt eksportit, do të marrë 20 për qind të mjeteve të investuara në vitin e parë. Ai tha se Qeveria ka masa të posaçme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat do të mbështeten me implementim të standardeve, menaxhim të projekteve, me zgjidhjen e IT çështjeve me promovim të panairit. Sipas tij, qeveria e më-

parshme ka shpenzuar më shumë në vetëpromovim dhe në roud shout sesa në ndihmën për investime të huaja dhe vendase në ekonomi. Angjushev deklaroi se me simulimet e bëra, Qeveria është e bindur se kompanitë ekzistuese të suksesshme dhe investuesit do të jenë shumë më të mirë dhe në mënyrë më transparente të mbështetura me atë që paratë në mënyrë më efektive do të shpenzohen.





Zanafilla e vërshimeve në Lumin e Poroj është në bjeshkët mbi fshatin Gjermë të Tetovës. Banorët e fshatit Gjermë shprehën se problemi i vërshimeve në fshatin e tyre dhe më pas edhe në Poroj, është në lumin që kalon në këtë fshat. Burimi i tërë këtij rreziku është në lumin e quajtur "Uji i shpejtë", prej nga uji bart me vete gjithçka që i del përpara dhe i sjell poshtë në fshatin Poroj

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 15 nëntor - Fshati Poroj i Komunës së Tetovës, vazhdon të jetë i rrezikuar edhe në këtë periudhë nga vërshimet. Reshjet e shiut që kanë filluar ditë më parë kanë bërë që të rritet niveli i Lumit të këtij fshati dhe të rrezikojë banorët për përmbytje të tjera si ato që ndodhen në qershor dhe korrik të këtij viti. Banorët shprehën se premtimet e dhëna kanë ngelur vetëm në letër dhe ata presin që ato të fillojnë të realizohen që nga fillimi i vitit të ardhshëm.

Kryetari i Bashkësisë Lokale të këtij fshati, Sulejman Ramadani, shprehet se ekziston rrezik për vërshime, sepse pas herës së dytë së vërshimeve, shtrati i lumit nuk është pastruar. "Rreziku për vërshime tani në muajt e vjeshtës është i mundshëm, pasi që tash ka më shumë reshje të shiut, si lartë po ashtu edhe në pjesën e poshtme të lumit, ku duket se edhe niveli i ujit në lum është rritur. Rreziku i parë është mbyllja e rrugës dhe nënkuptohet se mund të ketë edhe përmbytje në tokat pjellore në pjesën poshtë të fushës. Kur kishim të bëjmë me vërshimet e herës së dytë më 20 korrik, lumi fshatit doli nga shtrati, sepse nuk është pastruar në tërësi dhe për shkak të kësaj tash rrezikohet bllokimi i rrugës", deklaroi Sulejman Ramadani, kryetar i bashkësisë Lokale të fshatit Poroj.

Në këtë fshat thonë se janë në pritje që Qeveria dhe komuna

## Banorët në pritje të premtimeve

# Reshjet rrezikojnë përmbytje të reja në Poroj



të mbajnë premtimet që i kanë dhënë dhe të njëjtat të fillojnë t'i realizojnë. "Sa u përket premtimeve të tjera, punëve më të mëdha, ato çka i premtoi edhe vet kryeministri, së bashku me kryetaren e komunës se në vitin 2018 do të punohet në këtë drejtim, neve na ngelet që të presim dhe të shohim se çfarë do të bëhet, domethënë duhet që të presim vitin 2018 për realizimin e punëve më të mëdha. Atëherë neve na premtuan se do të rregullojnë në tërësi shtratin e lumit në fshat, ndërsa në pjesën sipër fshatit, në shtratin e lumit, premtuan se do të ndërtojnë diga për parandalimin e ndonjë katastrofe edhe më të madhe që mund të ndodh. Ne si Bashkësi Lokale ndaluan banorët e fshatit që të mos protestojnë, me arsyen se kemi marrë premtime se në vitin 2018 do të fillohet me punë. Tash neve na ngelet që

të presim dhe të shohim se çfarë do të bëhet në vitin 2018, çfarë do të realizohet nga ato premtime", thotë Ramadani.

Përndryshe, deri më tani janë dëmtuar edhe shumë prona bujqësore dhe dëmet e shkaktuara nuk janë kompensuar. "Bazuar në të dhënat me të cilat disponojmë ne deri më tani nuk është kompensuar asnjë banorë, toka e të cilit u dëmtuar nga vërshimet e këtij viti. Andaj ne apelojmë deri tek institucionet përkatëse, sidomos i bëjmë apel Ministrisë së Bujqësisë që ato dëme të dëmshpërblehen, t'ju kompensohen dëmet banorëve, sepse ajo tokë që është vërshuar, rrezikon që të mos jetë tokë pjellore edhe për disa vite të tjera, ku banorët nuk do të mund të kultivojnë kulturat e tyre bujqësore, për shkak se një pjesë e madhe e tokës bujqësore është komplet e shkatërruar",

apelon Sulejman Ramdani.

Zanafilla e vërshimeve në Lumin e Poroj është në bjeshkët mbi fshatin Gjermë të Tetovës. Banorët e fshatit Gjermë shprehën se problemi i vërshimeve në fshatin e tyre dhe më pas edhe në Poroj, është në lumin që kalon në këtë fshat. Burimi i tërë këtij rreziku është në lumin e quajtur "Uji i shpejtë", prej nga uji bart me vete gjithçka që i del përpara dhe i sjell poshtë në fshatin Poroj.

Në kohën e ish Jugosllavisë janë ndërtuar diga dhe kaskada. Mirëpo të njëjtat pas vërshimeve të vitit 2015 dhe vërshimeve të mëhershëm janë dëmtuar tërësisht dhe pikërisht kaskadat e fundit që parandaluan më të keqen, para një jave janë dëmtuar. Tash edhe banorët e fshatit Gjermë, por edhe të fshatit Poroj, janë lënë në mëshirë të fatit.



## Zjarr në një shtëpi të braktisur

Shkup, 15 nëntor - Në një shtëpi të braktisur në afërsi të kishës e cila është duke u ndërtuar në afërsi të Stationit të ri hekurudhor dje pasdite shpërtheu zjarr, i cili pas disa orësh, u shua nga Njësitë territoriale i zjarrfikësve të Qytetit të Shkupit. Komandanti i NJTZ, Zvonko Tomevski për MIA-n deklaroi se në terren është duke u intervenuar me dy automjete dhe shtatë zjarrfikës.

## Gjendet trupi i pajetë i një mashkulli në Shkup

Një burrë është gjetur i vdekur rreth mesnatës në rrugën "Ibe Palikuqa" në Shkup. Rasti në polici është paraqitur nga ana e një personi medicinal të ndihmës së shpejtë. Nga ana e nëpunësve policor kanë dalë në vend të ngjarjes dhe është konstatuar se i vdekuri është Z.P. (56) nga Shkupi tek i cili nga ana e mjekëve nuk janë konstatuar gjurmë të dhunës, informojnë nga policia. Në konsultim me prokurorin publik trupi i të vdekurit i është dorëzuar familjes.

## Protestë e emigrantëve në kufi me Maqedoninë

Selanik, 15 nëntor - Dhjetëra azilkerkues u tubuan në qytetin verior grek Selanik, pas thirrjes së publikuar përmes rrjeteve sociale për mbajtjen e një marshi në kufirin verior të Greqisë me Maqedoninë, ndërsa në shenjë proteste për shkak të pamundësisë së tyre të transferohen në vende të tjera evropiane. Rreth 80 persona, kryesisht nga Iraku dhe Siria, përfshirë edhe shumë familje me fëmijë, u mbledhën sot në sheshin qendror

në Selanik para marshit të caktuar pranë kufirit. Disa, gjatë natës, arritën prej kampeve të refugjatëve në Athinë dhe prej vendeve të tjera, njoftojnë mediat greke. Dhjetëra mijëra refugjatë dhe emigrantë për momentin janë ngujuar në Greqi, në pamundësi të shkojnë drejt destinacioneve të tyre të dëshiruara në Evropë, pasi vendet i mbyllën kufijtë tokësorë në fillim të vitit të kaluar, duke e mbyllur rutën ballkanike.



Shkup, 15 nëntor - Prej të mërkurës fillon paraqitja për kompensim të një pjese të shpenzimeve të qytetarëve në rajonin e Qytetit të Shkupit për blerje të stufave me pelet për vitin 2017. Qyteti i Shkupit, me qëllim që t'i stimulojë shkupjanët për shfrytëzim të burimeve ripërtëritëse të energjisë për ngrohje të shtëpive të veta, të cilat minimalisht ndotin ajrin dhe tokën dhe nuk ndikojnë ndaj ndryshimeve klimatike, banorëve të cilët do të blejnë stufa me pelet nga dita e shpalljes së Konkursit publik, ndërkaq përfundimisht me datën 22 të këtij muaji, do t'u sigurojë kthim të mjeteve në

Stufat me pelet

## Filloi paraqitja për subvencione



vlerë prej 70 për qind, por jo më shumë se 30 mijë denarë me kyçe të tatimit personal të të ardhurave.

Konkursi publik zgjat shtatë ditë kalendarike prej ditës së publikimit, përfundimisht me 22 nëntorin e vitit 2017 dhe do të realizohet sipas parimit, "ai që vjen i pari shërbehet i pari".

Të drejtë pjesëmarrjeje në këtë Konkurs publik kanë banorët e Shkupit në komunat, Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Vodë, Karposh, Çair, Shuto Orizarë, Qendër, Gjoçe Petrov, Butel dhe Saraj, të cilët do të blejnë stufë me peleta

për ngrohje të hapësirës së tyre banesore prej ditës së shpalljes së Konkursit publik deri në ditën e përfundimit të konkursit dhe do të parashtrajnë kërkesë për shfrytëzim të së drejtës së kompensimit. Në Konkurs publik nuk kanë të drejtë të marrin pjesë amvisëritë të cilat kanë kyçe në ngrohjen qendrore të qytetit, pa marrë parasysh nëse e shfrytëzojnë atë, si dhe pronarët e objekteve banesore të cilët ende janë në

fazën e ndërtimit dhe nuk jetojnë në objektet.

Blerësi i stufës me pelet kërkesën e vet për shfrytëzim të së drejtës për kompensim të një pjese të shpenzimeve, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, duhet ta parashtrorë në zarf të mbyllur në Qytetin e Shkupit, bulevardi "Ilin-den" numër 82, në arkivin e Qytetit, çdo ditë pune prej orës 8:00 deri në orën 16:00. Qyteti i Shkupit, varësisht nga dinamika e arritjes së paraqitjeve, periodikisht do ta njoftojë opinionin për mjetet e mbetura të parapara për këtë dedikim, deri në shfrytëzimin e tyre të plotë.





## Takim i pensionistëve në Ditën e Çlirimit të Strugës



Me rastin e Ditës së Çlirimit të qytetit, më 8 nëntor SHP Strugë ka organizuar takimin tradicional për shoqatat e pensionistëve të rajonit jugperëndimor. Në takim përveç të vëllazëruarve nga Krusheva, morën pjesë edhe SHP nga Ohri dhe Debërca, Resnja, Kërçova, Manastiri, Dibra, Gostivari, Makedonski Brodi dhe Prilepi. Në festën e përbashkët, e cila u mbajt në hotelin "Biser", kryetari i SHP Strugë Millorad Trposki ka mbajtur fjalën e rastit për rëndësinë e festës së 8 nëntorit pas çka theksoi se këtë vit qyteti i Strugës feston 73 vjetorin e çlirimit. Duke ju dëshiruar mirëseardhje mysafirëve dhe pjesëmarrësve ai hapi takimin dhe të gjithëve u dëshiroi shëndet të mirë, argëtim dhe shoqërim të këndshëm. Festa ishte e pasuruar me prezencën e përfaqësuesve të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë të udhëhequr nga nënkryetari i KE të LSHPM Salltir Karovski. Në fjalimin përshëndetës ai u uroi festën të pranishmëve duke shprehur nderin dhe kënaqësinë që është prezent në këtë shoqërim, ku dërgoi përshëndetjet e ngrohata deri tek të gjithë të pranishmit nga ana e kryetarit të LSHPM, Dragi Argirovski. Në takim fjalim mbajtën edhe kryetarët e shoqatave prezent të pensionistëve, si dhe kryetarja e aktivitetit të pensionistëve të SHP Gostivar Vadija Zendeli, e cila u shpreh edhe në gjuhën shqipe. Si nikoqire të mira u treguan edhe pensionistet e Aktivitetit të SHP Strugë në emër të të cilave kryetareve prezent të aktivëve të shoqatave pjesëmarrëse në takim iu dhuruan dhurata modeste.

(Stojna Kukuneshoski)

Hulumtimet gjithashtu tregojnë se kohën e fundit gratë janë çdo ditë e më shumë cak i dhunuesve, menjëherë pas fëmijëve. Në rastet martesore, ato si shkaqet më të shpeshta për vazhdimin e jetës me dhunuesin i paraqesin frikën nga shkatërrimi i familjes me ndikim jashtëzakonisht negativ ndaj fëmijëve dhe varësinë ekonomike me shpresë se situata do të përmirësohet

Dhuna familjare ishte tema kryesore e Konferencës nacionale e cila u mbajt më 25 tetor të vitit 2017 në hotelin "Porta" në Shkup, në organizim të Rrjetit nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare me mbështetje të UNDP. Në këtë forum për herë të parë është diskutuar për fenomenin e femicidit (vrasja e femrës vetëm se është femër). U potencua se femicidi është forma më e rëndë e dhunës ndaj gruas dhe mund të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e dhunës familjare ose dhunës intime të partnerit. Sipas Entit shtetëror të statistikës prej vitit 2008 deri në vitin 2016 janë vrarë 70 gra nga dhunuesit, por ende nuk është vërtetuar sa prej atyre vrasjeve janë femicide. Të dhënat të cilat i posedon Rrjeti nacional janë shqetësuese sepse bëjnë të ditur që ka lëshime në reagimet e policisë dhe Qendrës për kujdes social, kështu që edhe prej atje është përqindja e madhe e vrasjeve (mbi 90%) që ndodhin

në shtëpinë e viktimës.

Përcaktimi terminologjik i dhunës familjare përfshinë çfardo lloji të lëndimeve trupore ose psikologjike nga ana e anëtarëve të familjes, që u merr të drejtën dhe lirinë e anëtarëve të tjerë, ose pengon zhvillimin e tyre optimal dhe lirinë e zgjedhjes. Kur të drejtat e njeriut në kuadër të familjes janë shkelur - neglizhuar apo rrezikuar, atëherë bëhet fjalë për dhunë ndaj të drejtave dhe lirive të zgjedhjes së atyre personave, pavarësisht nëse bëhet fjalë për fëmijë apo të rritur.

Tek ne ende nuk flitet hapas për dhunën familjare, edhe pse hulumtimet tregojnë se është mjaft prezente dhe ka tendencë të rritjes. Ajo shprehet përmes llojeve dhe formave të ndryshme si maltretim, fyerje e vrazhdë, rrezikim të sigurisë, ngacim seksual, trupor dhe psikologjik, shkaktim të frikës dhe pasigurisë tek

## Lufta e përbashkët kundër dhunës



bashkëshortja, fëmijët, prindërit ose personat e tjerë, të cilët jetojnë në bashkësi dhe të tjera. Në fakt, dhuna familjare manifestohet si problem personal, familjar dhe social, i cili në mënyrë të konsiderueshme dëmton cilësinë e jetës dhe shëndetin mental të atyre që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ballafaqohen me atë. Viktimat e dhunës së këtille më së shpeshti i heshtin këtë për shkaqe të ndryshme të njohura dhe të panjohura. Me siguri ata ndjehen të turpëruar të pranojnë se ngacmohen ose mundohen nga të afërmit e tyre, sepse frikësohen nga hakmarrja dhe se shqetësohen për të ardhmen e tyre. Për ndryshe, dhunuesi mund të jetë partneri, anëtar i familjes, farefisi, shoku, fqinji, profesionisti në kujdesin social ose shëndetësor, të punësuarit në institucionet për akomodim të personave të

moshuar ose ndonjë i huaj. Në disa raste bëhet fjalë për njerëz të paskrupullt, të cilët në çfardo mënyrë mundohen t'i përdorin të moshuarit dhe personat e prekshëm. Kemi edhe dhunë që ndodhin në objektet për për akomodim sepse mungojnë kuadro të trajnuara adekuate, ose në familjet kur anëtarët nuk janë të përgatitur përkatësisht për të përkujdesur për të moshuarit me nevoja të rëndësishme fizike dhe mendore, por edhe kur në të njëjtën ekziston histori për sjellje të dhunshme. Në çfardo rasti, dhuna ndaj personave të moshuar llogaritet krim dhe në afatin sa më të shkurtër të mundshëm duhet të paraqitet.

Hulumtimet gjithashtu tregojnë se kohën e fundit gratë janë çdo ditë e më shumë cak i dhunuesve, menjëherë pas fëmijëve. Në rastet martesore, ato si shkaqet më të shpeshta për vazhdimin e jetës me dhunuesin i paraqesin frikën nga shkatërrimi i familjes me ndikim jashtëzakonisht negativ ndaj fëmijëve dhe varësinë ekonomike me shpresë se situata do të përmirësohet. Prandaj dhuna familjare po bëhet problem më i gjerë shoqëror dhe në mënyrë negative po pasqyrohet tek pasardhësit ndaj të cilëve duhet të ndërtohet e ardhmja dhe përparimi i shtetit.

(S.C. Sotirovska)

## Turneu në shah në atmosferë të bukur

Në Klubin e pensionistëve, në shtëpinë e pensionistëve "Lika Çopova" në Fushë të Topanës, më datën 24 tetor 2017, për herë të tretë u mbajt turneu tradicional në shah, mes pensionistëve të SHP Gazi Babë, SHP Solidarnost, - Aerodrom, SHP Butel, SHP Kisella Vodë, SHP Ilinden, SHP Pensionistët e luftës dhe Shoqatës së pensionistëve nga Çairi, e cila njëkohësisht ishte nikoqire dhe organizator i shkëlqyeshëm i takimit. Mirëseardhje pjesëmarrësve dhe mysafirëve u dëshiroi kryetari i komisionit për sport dhe rekreacion pranë SHP Çair, Todor Iliev, i cili theksoi se këto takime janë shumë të mira, sepse aty ripërtërihen miqësitë e vjetra dhe pasurohet shoqëria dhe bashkëjetesa. "Në emër të kryetarit të shoqatës sonë, i cili



mungon me arsye, ju përshëndes dhe ju dëshiroj çdo të mirë dhe le të fitojnë më të mirët. Besoj se gara do të rrjedhë në mënyrë normale, nuk është me rëndësi kush do të fitojë, me rëndësi është të shoqërohemi dhe marrim përshtypje të mira. Qëllimi ynë është të shoqërohemi dhe njëkohësisht edhe përgatitja për

turneun e 13 nëntorit në shah, i cili është tradicional", tha Todor Iliev. Në fund pas përfundimit të garave, u shpallën edhe fituesit. Rezultat më të mirë arritën shahistët nga SHP Solidarnost - Aerodrom, vendin e dytë e fotuan shahistët nga SHP Butel, vendin e tretë e morën shahistët nga SHP Çair, në vendin e katërt ishin shahistët nga SHP Ilinden, në vendin e pestë ishin SHP Gazi Babë, vendi i gjashtë u takoi shahistëve nga SHP Kisella Vodë dhe në vendin e shtatë ishin SHP Pensionistët e luftës. Përveç pjesëmarrësve, vlen të theksohet edhe prezenca e një numri të madh të pensionistëve monitorues, të cilët pas përfundimit të secilit xhiro kanë komentuar ndeshjet dhe tregonin gabimet e gariesve. (Vasil Paçemski)

## Ekskursionet dhe shëtitjet më të dëshirueshme

Pensionistët e Tetovës interesim më të madh kanë shprehur për ekskursionet dhe shëtitje, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vendet fqinje. Sipas të dhënave që janë paraqitur në Shoqatën e pensionistëve Tetovë, vetëm gjatë këtij viti rreth 700 pensionistë kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me vizitat e përmendoreve kulturo-historike dhe vendeve turistike.

Në të gjitha rastet, Shoqata kompenson shpenzimet për transport,

ndërsa të tjerat i paguajnë pjesëmarrësit. Në pesë raste, pensionistët e Tetovës kanë marrë pjesë me nga 20 anëtarë në manifestime dhe pikniqe të ndryshme. Të tilla janë rastet me pjesëmarrjen në manifestimin tradicional "Ëmbëlsirat e gjyshes" në Veles, takim në fushë të gjelbër në Kratovë, pastaj në Gazi Babë të Shkupit dhe Prilep. Në hepingun në Dojran, SHP nga Tetova u përfaqësua me 50 pensionistë. Gjithashtu, ata ishin edhe në manifestimin masovik në Man-

astirin e Lesnovës në afërsi të Probishtipit. Mjaft interesant është ekskursioni dyditor në Sandanski të Bullgarisë fqinje. Pjesëmarrësve ju mundësua edhe qëndrimin disa orësh në Strumicë.

Grupe edhe me nga 50 pensionistë këtë vit ishin pjesëmarrës në ekskursionet në Kosovë, në vizitë të Prishtinës dhe Prizrenit, si dhe në Shqipëri në qytetet Pogradec dhe Korçë. Në një ekskursion njëditor në vendet fqinje, kësaj radhe në Vranjë dhe rrethinë, kishte vendpër

njëqind pensionistë në dy autobusë. Megjithatë, pjesëmarrja më masovike ishte në margaritarët e Maqedonisë Ohër dhe Strugë.

Pesë autobusë të mbushur me gjithsej 250 pensionistë kanë udhëtuar në drejtim të këtyre qyteteve duke vizituar vendet kulturo-historike dhe ato turistike. Praktikisht për të gjithë pensionistët e interesuar pa përjashtim u mundësua të vizitoheshin Strugën dhe Ohrin. Gjatë rrugës, pensionistët vizituan Dibrën,



Vevčanin, Demir Hisarin, Manastirin dhe Resnjen. Aktivitete të këtilla do të

organizohen edhe gjatë periudhës së ardhshme.

(Gjoko Eftoski)



# Hije amerikane dhe gjermane në takimin e Kretës



Mentor NAZARKO

Pasi kanë përfunduar me njëfarë suksesi të pjesëshëm takimet në Kretë, është i detyrueshëm një lexim më i thelluar i bisedimeve më të përqendruara në historikun e marrëdhënieve shqiptaro-greke. Sprova për t'i bërë një zhbirim takimeve në Kretë cytet edhe më nga fakti se deklaratat zyrtare që u lëshuan nga diplomacia shqiptare dhe ajo greke nuk është se dritësuan gjithçka palët ranë në ujdi. Kjo është e kuptueshme deri diku, ngase të dyja palët nuk vunë pikën mbi 'i' apo nuk negociuan marrëveshje të krehura më parë. Më shumë sesa përfundim, takimet e Kretës ravijëzuan piketat e bisedimeve të ardhshme, që figurshëm mund të shihen si diktim i parimeve të epërme për punën metikulozë të komisioneve përkatëse. Në këtë frymë ishin ujdite për marrëveshjen e detit, traktatin e ri të miqësisë

**Në Greqi mund të ketë një momentum që favorizon afrimin me shqiptarët, e shkaktuar kjo nga tromaksja greke prej afrimit të Serbisë me Turqinë, që në prapaktim sjell rikonfigurime të fuqisë në rajon**

(bashkë me ligjin e luftës), të drejtat e pakicës greke dhe çështje të tjera që vijnë si 'pajë' nga historia apo aktualiteti. Në takimin e radhës, që me gjasë do të mbahet në Tiranë, të dyja vendet kanë vendosur me sajdi të përimtojnë të gjitha problemet që mundojnë frymëmarrjen normale të marrëdhënieve shqiptaro-greke.

Në këtë qasje duket se ka mbizotëruar propozimi i Institutit Grek për Politikë të Jashtme, ELIAMEP, që pati sugjeruar qysh në vitin 1999 që Greqia të shqitej nga rreshtimi i saj tradicional ortodoks me Serbinë dhe të konceptualizonte një marrëdhënie të re me shqiptarët. Së këndejmi, ish-ambasadori grek në Tiranë, Aleksandros Mallias, pati propozuar zgjuarsisht një prospekt më tërësor të bisedimeve shqiptaro-

greke, ku faktori shqiptar pranohej si i njësisëm në Ballkan, dhe kjo kishte logjikën e vet mu për faktin që rritej hapësira negociuese dhe gjasat për paqësim largvajtës të të dy popujve. Kjo linjë mendimi fitoi truall edhe në kohën e pararendësit të ministrit të Jashtëm, Nikos Kocias, por tevona kriza drobitëse në Greqi pamundësoi sendëzimin e saj. Një rrethanë që mund të shihet si momenti më i mirë për arritjen e këtij realiteti është edhe fakti që qeveria e sotme greke (me pinjoll të ish-partizanëve militantë grekë), me një traditë simpatizuese ndaj popullit shqiptar, është një situatë sipranie ndaj Greqisë që është ronitur në kontekstin rajonal.

Udhëheqësi i të majtës greke Cipras, përpos si një individ i formësuar mes literaturës marksiste, ka pasur një miqësi personale me Shqipërinë. Tek ai nuk mund të ndeshen qëndrime negative kundër Shqipërisë, pavarësisht se gjatë mandatit të parë, por edhe tani, Qeveria e Ramës nuk ngurroi të shigjetonte kritika e deklarata të forta kundrejt Greqisë. Më fjalë të tjera, merret me mend që prej Greqisë do të përbrendësohej një qasje konstruktive.

Greqia zgjodhi edhe një moment të shënueshëm në rrugëtimin evropian të Shqipërisë, veçmas tani kur po pritet ethshëm drita e gjelbër për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE, dhe deklaratat e Kocias se do të bisedojë në BE edhe për të ardhmen evropiane të vendit tonë lënë vend për shqetësim. Sado që ka zëra që alarmojnë se vetoja greke mund të vërtitet si shpatë Damokleu në këtë proces, ka arsye të mendohet që Gjermania vigjilente të mos i lejojë Greqisë këto ojna diplomatike. Dhe më shumë sesa një mejtim konspirativ, Gjermania si shteti që kollitet në BE është një situatë sipranie ndaj Greqisë që është ronitur në kontekstin rajonal.

Paçka se forca negociuese e Greqisë ende është e madhe, ajo nuk i ikën dot imperativit që të përvijojë një politikë prudente të ndërtimit të marrëdhënieve të shëndosha me fqinjët e saj: shqiptarë, maqedonas e turq. E parë nga ky kënd, Greqia do të jetë e detyruar që edhe për hir të investimeve të saj në tregjet rajonale, pas mpirjes që solli kriza rrokakrejtëse, të shkarkojë barrën e problemeve me fqinjët dhe të hapërojë me një frymë të

re konstruktive. Dhe në shërbim të kësaj do të jetë sfida e muajve në vijim për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së emrit të Maqedonisë si dhe vizita e parajlmëruar e presidentit turk në Greqi. Por edhe Shqipëria duhet të njohë pikat e saj të forta dhe të mos lërë vend për komplekse: është fakt i pamohueshëm që tani shteti shqiptar është anëtar i NATO-s, gjeostrategjikisht e gjeopolitikisht me lidhje të nduarnduarta me Perëndimin, afër një milion shqiptarë, legalisht ose ilegalisht, punojnë e jetojnë në Greqi me depozita prej afro 4 miliardë eurosh në bankat greke, si dhe ata janë një nga kolonadat më të forta që mbajnë në këmbë sistemin shëndetësor grek. Duke marrë shkas nga një bisedë telefonike të bërë muaj më parë mes zotit Rama dhe sekretarit amerikan të Shtetit, Tileron, është e lejuar të besohet që edhe amerikanët janë përfshirë në relaksim dhe marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Greqisë.

Nuk duhet harruar që Tileron është një ish-menaxher i një kompanie globale naftë, dhe me gjasë ai ka shprehur interesim për burimet e naftës që besohet të jenë në thellësitë e Jonit. Pyetja aq e shpe-

është në opinion nëse fituam apo humbën në Kretë, duhet të marrë përgjigjen se një fillim i mbarë është gjysma e punës. Takimet filluan dhe mbaruan me një sereinitet të përzemërt diplomatik: prej shoqërimit të Bushatit në Tiranë me avionin e Kociasit e deri te heqja e valles me muzikë tradicionale greke. Sado që nuk duket se ka pasur një marrëveshje të natyrës së prerë për detin, palët janë marrë vesh që të ketë vijim të bisedimeve për caktimin e sinorëve detarë nëpërmjet grupeve negociatore (që do të kenë në përbërjen e tyre ekspertë, hartografë, ushtarakë e diplomatë të ndryshëm).

Është e evidente se nga ato që u biseduan në Kretë del që Shqipëria ka pasur humbje në marrëveshjen e vjetër, që konfirmohet edhe nga gazeta ndërkombëtare dhe supozimet për një vendburim gazi në afërsi të ishujve Othoni dhe Erikuza. Ndërsa duhet të presim edhe zhvillimet gjatë muajit dhjetor, përcaktimi i parimeve e lehtëson punën e negociatorëve të specializuar. Në lidhje me Ligjin e Luftës, sikundër bëjnë me dije burime të mirinformuara, ai do të jetë i përfshirë brenda Traktatit të ri të miqësisë mes dy vende-



Marcel FATZSCHER

Bashkimi Demokratik Kristian (CDU) i kancelares gjermane Angela Merkel, mund të ketë fituar shumicën në zgjedhjet federale të shtatorit, por kjo nuk do të thotë që e ardhmja e vendit është e qartë. Ajo që del ndërsa Merkel kërkoi të formojë një koalicion të ri me të Gjellbrit dhe Demokratët e Lirë nuk do të formësojë vetëm trajektoren ekonomike të Gjermanisë gjatë katër viteve të ardhshme. Ajo do të përcaktojë gjithashtu fatin e transformimit të vendit në një shoqëri vërtet të hapur. Në më pak se një brez, Gjermania, dikur burri i sëmurë i Europës, është shfaqur si një central elektrik ekonomik botëror. Por e vërteta është se suksesi i tanishëm ekonomik i Gjermanisë është më pak rezultat i politikave të mira sesa i kushteve të favorshme të jashtme, sidomos në Europë, gjë që siguroi një kërkesë të fortë për eksportet gjermane. Për të qenë të sigurt, reformat e rëndësishme ekonomike në vend bënë të mundur që Gjermania të përfitonte nga kërkesa e jashtme. Por ato ishin ndërmarrë shumë kohë para se Merkel të vinte në pushtet dhe pak reforma ekonomike kuptimplotë u vunë në zbatim gjatë mandatit të saj 12-vjeçar. Për shembull, investimi privat vendas mbetet i dobët,

**Nga mikpritja e refugjatëve e deri te përmirësimi i barazisë gjinore, talenti i kancelares gjermane Angela Merkel në kapërcimin e ndarjeve sociale dhe politike ka bërë të mundur transformimin e Gjermanisë në një shoqëri të hapur. Kjo ka qenë arritja më e madhe e qeverisjes së saj**

mos në Europë, gjë që siguroi një kërkesë të fortë për eksportet gjermane. Për të qenë të sigurt, reformat e rëndësishme ekonomike në vend bënë të mundur që Gjermania të përfitonte nga kërkesa e jashtme. Por ato ishin ndërmarrë shumë kohë para se Merkel të vinte në pushtet dhe pak reforma ekonomike kuptimplotë u vunë në zbatim gjatë mandatit të saj 12-vjeçar. Për shembull, investimi privat vendas mbetet i dobët,

## Gjermania e re e Angela Merkel

pjesërisht për shkak të shërbimeve të mbingarkuara dhe barrëve të rënda burokratike.

Për më tepër, meqenëse qeveria gjermane ka predikuar masat shtrënguese ndaj fqinjëve të saj, ajo ka rritur shpenzimet sociale për pensionet dhe transfertat, gjithçka duke lejuar që investimet publike neto të kthehen negative. Shqyrtimi shumë i nevojshëm i sistemit të taksave, i cili dikur u hoq nga CDU, nuk ka arritur të materializohet. Dhe, edhe pse punësimi është rritur gjatë mandatit të Merkelit, krijimi i vendeve të punës nuk ka arritur të ulë segmentin e të ardhurave të ulëta të tregut të punës. Partitë që ka më shumë gjasa të formojnë qeverinë e ardhshme – CDU (dhe partia e saj simotër bavareze, Bashkimi Social Kristian), të Gjellbërit dhe Demokratët e Lirë – tani po luftojnë për mënyrën më të mirë për të përdorur sifucitet e mëdha fiskale të Gjermanisë për t'i shërbyer zgjedhësve të tyre përkatës. Çfarëdo vendi-

mi që ara marrin, performanca ekonomike e Gjermanisë ka gjasë të mbetet e fortë, të paktën në aspektin e tregtisë dhe një buxheti të ekuilibruar.

Prova e vërtetë e të ashtuquajturit koalicioni i Xhamajkës (i quajtur kështu për shkak të ngjyrave të partive) qëndron diku tjetër. Atë që Merkelit i ka munguar në arritjet e politikës ekonomike, ajo e ka shlyer duke sjellë ndryshime sociale. Nën udhëheqjen e saj, Gjermania është bërë shoqëria e hapur që është sot. Por kjo është gjithashtu një shoqëri shumë e ndarë. Siç është, rreth 20% e popullsisë së Gjermanisë prej 82 milionë banorësh ka një sfond migruer dhe rreth pesë milionë janë myslimanë. Ky multikulturalizëm reflektohet në ndryshimin e perspektivave nga ana e të gjithë gjermanëve. Katër në pesë gjermanë tani mendojnë se Islami dhe homoseksualiteti janë pjesë e shoqërisë gjermane. Tre nga katër thonë të njëjtën gjë për emigrantët dhe refugjatët.

Dhe Gjermania ka një nga popullsitë më pro-europiane në kontinent. Tre qeveritë e fundit, të gjitha të udhëhequr nga Merkeli, kanë kontribuar fuqishëm në këtë transformim. Kritikët e quajnë Merkelin kancelaren e parë social demokrate nga një parti konservatore, sepse ajo ka përqafuar shumë politika progresiste, ndërkohë që predikon stabilitet dhe vlera tradicionale. Ndosh-ta vendimi i saj më i rëndësishëm – i cili pothuajse i kushtoi asaj postin, por mund të formësojë trashëgiminë e saj – ishte vendimi i saj i vitit 2015 për të pranuar pavarësisht kundërshtimit të ashpër nga shumë anëtarë të partisë së saj, të pothuajse 1.5 milion azilkërkues dhe për të nxjerrur integrimin e tyre në shoqërinë gjermane.

Qeveritë e Gjermanisë të udhëhequra nga Merkeli kanë mbështetur gjithashtu arsimimin e hershëm të fëmijëve dhe të drejtat e tyre, duke mbikëqyruar progresin substancial në barazinë

gjinore. Qarja e gjerë dhe më fleksible në tregun e punës, zgjerimi i hapësirës së fëmijërisë së hershme dhe stimujt financiarë kanë nxitur një rritje në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore të femrave në më shumë se 70%, një nga më të lartat në botën e industrializuar. Qeveria aktuale gjermane gjithashtu zbatoi një kuotë prej 30% pjesëmarrje të grave në bordet mbikëqyrëse të kompanive të mëdha, si dhe një ligj mbi transparencën e pagave që synon zvogëlimin e hendekut të pagave me bazë gjinore, që është ende në 21%. Ndërkohë që Merkel nuk i drejtoi këto reforma – sepse ajo duhet të shmangte alienimin me ata në partinë e saj që i shikonin ato negativisht – ajo ofroi mbështetje të heshtur. Në mënyrë të ngjashme, edhe pse vetë Merkel votoi këtë vit kundër legalizimit të martesës së homoseksualëve, gjë të cilën shumë nga partia e saj nuk e mbështesin, ajo pranoi me dashamirësi vendimin e Bundestagut, duke



ve. Në këtë kuptim, duket paksa e vështirë zgjidhja e çështjes së pronave shqiptare në Greqi, pavarësisht se ato janë lehtësisht të kuantifikueshme në terma financiarë. Në ndërkohë palët duket se kanë hedhur hapa më të suksesshëm për çështje më pak të rëndësishme, si tekstet mësimore të historisë që eventualisht përbajnë dromca animoziteti, vulat apostile, pakica greke e të tjera si këto.

Sado që çështja çame nuk është mbarështruar në tryezë, pasi Athina ngulmon në mosqenësinë e saj si problem, është e mundshme që të ketë njëfarë zgjidhje që i shërben rastit të maqedonasve të veriut të Greqisë, të cilëve u lejohet lëvizja në Maqedoninë e Egjeut. Sidoqoftë, qeveria greke dhe mediat e afërta me të janë treguar të përbajtura që të mos bëjnë triumfalist, veçmas në kohën kur partia 'Neo Demokratia' po del mjaft mirë në sondazhe. Duke ikur çfarëdo leximi rozë të bisedimeve në Kretë, duhen thënë edhe disa konsiderata shtesë. Në Greqi mund të ketë një momentum që favorizon afrimin me shqiptarët, e shkaktuar kjo nga tromaksja greke prej afrimit të Serbisë me Turqinë, që në prapaktim sjell rikonfigurime të fuqisë në rajon. Dhe mbetet për t'u parë nëse Greqia do të përfillojë propozimin e bërë edhe nga kreu i Bashkimit Demokratik në Maqedoni, Ali Ahmeti, që të njihet pavarësia e Kosovës. Të gjithë këta variabla mbetën të hapur... (konika.al)

deklaruar se ajo shpresonte se votimi do të promovonte jo vetëm "respektin midis opinionioneve të ndryshme", por "do të sillte edhe më shumë kohezion social dhe paqe".

Së fundmi, është talenti i Merkelit në tejkalimin e ndarjeve sociale dhe politike që e ka bërë t mundur transformimin e Gjermanisë në një shoqëri të hapur. Dhe kjo, jo politika ekonomike, në fund të fundit mund të bëhet arritja më e madhe e kancelarisë së saj. Në disa mënyra, Gjermania ka arritur tashmë në një pikë që s'ka më kthim pas në rrugën e saj drejt të qenit e hapur, për shkak të politikës së refugjatëve të Merkelit të vitit 2015. E megjithatë para ka sfida shumë të mëdha. Përtej sfidave teknike dhe sociale të lidhura me integrimin e suksesshëm të refugjatëve, ekziston një nevojë për tolerancë më të madhe ndaj Islamit dhe diversitetit në përgjithësi nga ana e të gjithë gjermanëve. Gjithashtu do të nevojiten ndryshime të mëtejshme në politikat familjare dhe gjinore, si edhe një rishikim i sistemit arsimor. Ndërsa Gjermania vazhdon të debatojë se ç'do të thotë të jesh gjerman, rezultati i negociatave aktuale të koalicionit do të përcaktojë nëse qeveria e ardhshme e Merkelit përballet me efikasitet me këto sfida. Nëse është kështu, Merkel do të mbahet mend si arkitektja e një shoqërie të re gjermane.

(reporter.al)



Ilir KALEMAJ

Bota arabe dhe Lindja e Mesme po përjetojnë një revolucion sa politik, aq edhe kulturor. Është vështirë të vësh theksin se cila po influencon tjetrën, apo nëse ka detyrimisht një lidhje shkakësore mes të dyjave, por fakti është që shoqëri të ndryshura nga ana sociale, me një popullsi eksplozive të re në moshë dhe me polaritete të frikshme ekonomike si dhe hendek gjinor, social dhe në nivel edukimi, ndryshimet janë të domosdoshme, qoftë edhe për të ruajtur status quo-në. Natyrisht nuk është qëllimi këtu për t'i futur në një thes apo për të krahasuar të pakrahasueshmet për shkak të dallimeve të shumta mes këtyre vendeve si në drejtim të traditave, ashtu edhe të rentës ekonomike apo projeksioneve të fuqisë rajonale. Por, ka edhe pika përbashkuese dhe që në vetvete vlen të merren në analizë. Arabia Saudite dhe Irani janë dy fuqitë rajonale me më shumë ndikim në rrafshin rajonal dhe të krahasueshme në shumë nivele, që me anë të fuqisë së tyre dhe aleancave strategjike dhe taktike po mundohen të ravijëzojnë edhe kufijtë gjeopolitikë të një rajoni përherë të trazuar, si Lindja e Mesme. Për shkak të prodhimit të naftës dhe muskujve ekonomikë, natyrisht që projekcioni i fuqisë së tyre shkon mjaft përtej këtij rajoni dhe pasojat shpesh ndjehen globalisht, duke

## Nga pranvera arabe e dështuar, në vjeshtën e trazuar politike

**Bin Salman gëzon mbështetje të fortë nga administrata "Trump" dhe ka në planet e tij krijimin e një mega-qtetëti të quajtur Neom, sipas strategjisë Vizion 2030**

përfshirë edhe shtete të fuqishme në proces si SHBA, Rusia apo Kina.

Arabia Saudite pas sulmeve të pandërprera për të ruajtur pozicionin e saj strategjik në Jemen përkundrejt Iranit, që mbështet pakicën Houthi dhe më pas bllokadës ekonomike që vendosi ndaj fqinjëve të Katarit, së fundmi nën liderhipin e princit të ri energjik 31-vjeçar, Muhamet bin Salman, po prodhon lajme thuajse çdo ditë. Ai arriti të prishte një konsensus omnium mëse 100-vjeçar për mënyrën e transferimit të pushtetit brenda radhëve të klanit 'Sudairi', sipas mbiemrit të ish-gruas së preferuar të themeluesit të këtij vendi, Abdulaziz Al-Saudi, ku brenda harkut të pak muajve princi i ri mori kontrollin e Ministrisë së Brendshme dhe Gardës Nacionale, krahas asaj të ministrit të Mbrojtjes, që e gëzonte qysh më parë dhe hoqi nga skena politike apo burgosi rivalë të drejtpërdrejtë si Princin Mutaib apo Muhamet bin Nayef. Më pas, Bin

Salman-i kreu një lëvizje blic javën që shkoi, ku shumë "peshq të mëdhenj" të botës së politikës dhe biznesit ranë brenda, ndërkohë që kryeministri i Libanit, Saad Hariri, një nënshitetas libanez, që ka edhe pasaportën saudite si nënshitetesi të dyfishtë deklaroi live nëpërmjet një televizioni saudit dorëheqjen e tij si rrufe në qiell të pastër. Ndonëse arsyeja që ai deklaroi ishte ndërhyrja e pandërprerë e Iranit nëpërmjet sponsorizimit të Hezbollahit që dyshohet të ketë vrarë dhe babain e tij, ish-kryeministrin e Libanit në 2005-ën, shumë skeptikë në Liban shprehen se ai po mbahet peng në Riadh dhe ndoshta kjo ishte një nga arsyet e vizitës blic të presidentit francez, Macron, javën që shkoi në kryeqytetin saudit.

Ndërkohë Bin Salman gëzon mbështetje të fortë nga administrata "Trump" dhe ka në planet e tij krijimin e një mega-qtetëti të quajtur Neom, sipas strategjisë Vizion 2030 dhe ndërkohë ka marrë hapa të rëndësishëm për liberalizimin gradual të një prej vendeve me islam politik më konservator sot në botë. Ai mbështetet taktikisht edhe nga Izraeli dhe ka një marrëdhënie strategjike me Egjiptin në një kundërvënje ndaj influencës rajonale të Iranit, që shkon nga boshti Liban-Siri-Irak deri në Jemen. Ndërkohë që SHBA-të janë pozicionuar qartazi në njërin

kamp, Rusia dhe Kina po i luajnë me kujdes të dyja palët, për shkak të interesave të shumfishta. Ndonëse Arabia Saudite është një nga blerësit më të mëdhenj të armëve dhe arsenalit luftarak rus dhe furnizon me naftë Kinën, të dyja, por veçanërisht rusët janë shumë më afër Teheranit sesa Riadhit. Kjo, si për shkak të interesave më të ndjeshme afatgjatë ekonomike, ashtu dhe për arsye të shahut gjeopolitik. A po përjeton Lindja e Mesme një erë të re të ngjashme me Glasnostin sovjetik në vitet e Gorbacovit sikundër shprehet së fundmi Sam Blateis, apo në fakt kemi rikthim të autoritarizmit të maskuar në vende, ku mbi 70 për qind e popullsisë është nën 30-të si rasti i Arabisë Saudite, kjo ha debat. Por, pas pranverës së parakohshme arabe, që shpejt u kthye në dimër të acartë, kjo do të jetë një vjeshtë e fortë dhe e rrëmbyer, ku ose do të kemi shkundje revolucionare, që do tronditin në harkun e pak muajve realitete të pandryshueshme për dekada dhe shekuj (si aleanca strategjike e vehabistëve ekstremistë me familjen e "shtëpisë së Saudit"), ose një cikël evolutiv, që do të diversifikojë ekonomi të mbështetura ekskluzivisht te nafta dhe gazi natyror, siç demonstroi suksesshëm rasti i Emirateve të Bashkuara Arabe. (foltash.com)



Jagoda MARINIĆ

Ditën e zgjedhjeve të Bundestagut, politikani i AfD-së, parti e ekstremit të djathtë, Alexander Gauland, përdori daljen e tij 30 sekondëshe në televizion për të thirrur para mikrofonit: "Ne do të rimarrim vendin tonë." Për të ashtuquajturit „qytetarë të zemëruar“, gjermanët të zemëruar është folur shumë në dy vitet e fundit. Ajo që në botën e jashtme njihet si „German Angst“ (frika gjermane), ka arritur të prodhojë „zemërimin gjerman“. Frika duket si një emocion që për gjermanët justifikon çdo lloj deformimi të sjelljes qytetare. Ndërkohë që për krerë të AfD-së që duan të rimarrin vendin e tyre është folur shumë pak. Në Gjermani diskursi publik për migrimin ka qenë gjithmonë në prapambetje me realitetin gjerman. Por ky vend është bërë tani shumë më i larmishëm seç duan të besojnë disa politikanë. Në grupin parlamentar të CDU/CSU-së, parti tradicionale konservatore, 2,6% e deputetëve kanë sfond migracioni. Madje edhe tek vetë AfD-ja ky numër është tre herë më i lartë. Këto shifra të mësojnë, se emigrantët si grup - për ta thënë më butë - nga ana politike mbeten shumë të marginalizuar. Por qytetet gjermane janë shumë më multikulturore. Gati çdo i

## Europa ime: Edhe ne jemi populli

**Kriza e refugjatëve e ngritja e AfD-së kanë ndryshuar klimën shoqërore në Gjermani. Njerëzit me sfond migracioni ndjehen sërisht si qytetarë të klasit të dytë**

katërti qytetar në qytete ka sfond migrimi. Para gjashtë dekadash kur erdhën edhe punëtorët e ftuar (gastarbeiter) u krijuan rregullore për të siguruar, që këta njerëz të mos kishin akses tek pasaporta gjermane. Përkundër kësaj, sot gati gjysma e 20 milionë vetëve me sfond migrimi ka pasaportë gjermane. Megjithatë fuqia politike e tyre mbetet e kufizuar. Si politika ashtu edhe opinioni i gjerë publik janë futur në një qorrsokak, ku më shumë preferojnë të flasin mbi ta e për atë se çfarë duan t'u ofrojnë, se sa të flasin drejtpërdrejt me përfaqësues të këtyre pakicave për të kuptuar kërkesat e tyre. Këta të fundit mbeten relativisht të paorganizuar, kështu që strukturat demokratike në dispozicion që do të shërbenin për të nxitur interesat e tyre nuk shfrytëzohen si duhet. Ndërkohë është bërë zakon në median gjermane që burra të thinjur gjermanë të flasin për imigrantët në talk-showt gjermanë. Alexander Gauland është njëri prej tyre. Në vend që t'i bëhet e qartë, se ai në natën zgjedhore ka kaluar vijën e kuqe, ai ftohet në 27-vjetorin e bashkimit të Gjermanisë në emisionin më

të njohur gjerman për çështje politike për të folur për identitetin kombëtar. Edhe njëherë nuk u ftua asnjë nga pakicat për të prezantuar në shoun e Gaulandit perspektivën e tij. As mediat gjermane nuk kanë ndërmarrë një përpjekje të përqendruar për të nxjerrë bllof ekstremistët. Përkundrazi: Një parti djathtiste ia del që në pjesë të pezazhit mediatic gjerman të zërë vend disproporcionalisht. Me këtë mediat dhanë kontribut për normalizimin e pozicioneve ekstremiste, që para dy vjetësh do të ishin të papranueshme. Në të njëjtën kohë nuk u dëgjua zëri i imigrantëve dhe pasardhësve të tyre.

Por realiteti gjerman ka kohë që ka ndryshuar. Tek nxënësit e klasës së parë në Hamburg çdo i dyti fëmijë ka sfond migrimi. Në vend që të hapë rrugën e koherencës, Gjermania përqendrohet tek çështjet e identitetit kombëtar, se si të qetësojë 13% të zemëruarit, votues të AfD-së. Para jo shumë kohësh, para ngritjes së AfD-së, Merkel u përpoq të vlerësonte migrantët për kontributin e tyre në suksesin e Gjermanisë. Ajo e di, se politika e saj ndaj refugjatëve, kaq shumë e kritikuar, mund të jetë e suksesshme, vetëm nëse narrativi për Gjermaninë si një vend i suksesshëm migracioni bëhet pjesë e ndërgjegjes kombëtare. Kështu ajo ftoi në vitin 2015, ish-gastarbeiterët dhe fëmijët e tyre për të festuar 60-vjetorin e marrëveshjeve të punësimit mes Gjerman-

isë, Italisë, Turqisë, Greqisë dhe vendeve të ish-Jugosllavisë. Ajo zgjoi shpresa, kur tha: „Ju i përkisni Gjermanisë, si gjithë të tjerët që jetojnë këtu.“ Pa këta punëtorë, Gjermania nuk do të ishte një vend me kaq mirëqenie si sot.

E megjithatë ngjitja politike e AfD-së para dy vitesh ka sjellë një kundërreagim në diskursin gjerman. Merkel, e cila i trembet humbjes së votuesve konservatorë, nuk ishte në gjendje të ndryshonte situatën. Kështu ne duhet të mësonim diçka: zërat tanë kanë më pak vlerë. Gjenerata ime, kështu duket, duhet të pranojë, se demokracia nuk është diçka që vlen edhe për ne. U desh të kalonte shumë kohë deri sa Gjermania ta tejkalojë parimin e prejardhjes, ius sanguinis, e na lejoj neve, megjithë gjakun jogjerman të bëheshim gjermanë. Sot ne quhem gjermanë e rinj. AfD ka gjetur një rrugë të sulmojë edhe këtë. Në një poster zgjedhor shkruhet – „Gjermanët e rinj? I bëjmë vetë ne!“ dhe përkrah parullës një grua shtatzënë“. Fillimisht ata pretendonin, se politika gjermane nuk tregon më kujdes për popullin gjerman. Ka ardhur koha që „gjermanët e rinj“ t'u thonë se prindërit tanë ishin vetëm gastarbeiter-punëtorë të ftuar, jo qytetarë të ftuar. Ata nuk kishin të drejtë të votonin. Por fëmijët e tyre nuk janë „të huaj me pasaporta gjermane“, siç duan ta paraqesin ekstremistët e djathtë. Edhe ne jemi populli. (dv)



## Tezgjahu, tradita shekullore shqiptare që bën për vete të huajt

Ambasada amerikane ka postuar disa foto ku ambasadori Lu shikon Taze Lazrin duke punuar në tezgjah. Taze dhe bashkëshorti i saj, Nikolla, ndihmojnë një sipërmarrje lokale duke thurur peceta dhe pëlhura të tjera, si dhe shporta të cilat përdoren për gjëra të ndryshme”, shkruhet në postimin e ambasadës amerikane në Tiranë

Megjithëse nuk mund të dihet saktësisht një datë kur zë fill mjeshtëria e endjes në tezgjah në Shqipëri, padyshim që është një traditë e ruajtur dhe e trashëguar brez pas brezi. Tezgjahu, një pajisje artizanale prej druri gjendej pothuajse në çdo shtëpi të të gjitha zonave të vendit, si Vlora, Gjirokastra, Fieri, Berati, Kruja, Lezha, Tropoja, Kukësi, etj. Një traditë e lashtë e vajzave dhe grave që endnin prodhime për nevojat e familjes dhe të të afërmeve të tyre.

Një vend të rëndësishëm në punimet me tezgjah zënë qilimat, sixhadetë, por edhe veshjet popullore, të punuara me një larmi ngjyrash dhe modelesh.

Me anë të disa pajisjeve të thjeshta, kallama, shkopinj, dërrasa, tuba e litarë mund të realizohen prodhime të veçanta, të bukura dhe të larmishme që konkurrojnë edhe markat më të famshme.

Vitet e fundit punimet e tezgjahut përveç artikujve me motive popullore, po përdoren edhe si një gërshetim i tradicionales me modernen. Kjo traditë që breza më parë filloi për mbijetesë, vazhdoi si zeytari, tashmë është kthyer në një art të mirëfilltë.

Përveç kërkesave brenda vitit, punimet në tezgjah kanë sjellë edhe interesimin e të huajve, të cilët nuk largohen nga vendi pa marrë me vete si kujtim një punim me tezgjah. Për të parë sesi gratë shqiptare punojnë në tezgjah, ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu, dhe personeli i Ambasadës kanë vizituar një familje në një fshat të Lezhës, ku kanë parë nga afër mjeshtërinë e endjes në tezgjah.

Ambasada amerikane ka postuar disa foto ku ambasadori Lu shikon Taze Lazrin duke punuar në tezgjah. Taze dhe bashkëshorti i saj, Nikolla, ndihmojnë një sipërmarrje lokale duke thurur peceta dhe pëlhura të tjera, si dhe shporta të cilat përdoren për gjëra të ndryshme”, shkruhet në postimin e ambasadës amerikane në Tiranë.

(atsh)







## Amishët, populli që nuk e njih kancerin!



Njerëzit që shikoni në foto njihet si populli i Amishëve që jetojnë në Ohajo të SHBA-ve. Sipas studimeve të "Cancer Causes and Control", është zbuluar se në mesin e amishëve, gati nuk është evidentuar ndonjë rast i kancerit. Ndjaj ata konsiderohen si njerëzit më të shëndetshëm në Amerikë. Amishët janë një grup



njerëzish që jetojnë pa teknologjinë moderne. Ekspertët vendosën që të hulumtojnë edhe më thellë mënyrën e tyre të jetesës, ushqimin e tyre, në mënyrë që të gjejnë arsyen për këtë gjetje. Amishët nuk pinë, nuk konsumojnë duhan dhe kjo mënyrë e



tyre e jetës ndikon në masë të madhe në zvogëlimin e rasteve të kancerit. Një tjetër faktor është dhe volumni i madh i punës fizike. Shumica e amishëve merren me bujqësi, ndërtimtari dhe punë tjera, të cilat kërkojnë angazhim të madh fizik, që i bën ata të jenë të shëndetshëm. Amishët vetë mbjellin dhe kultivojnë



ushqimin të cilin e hanë. Shfrytëzojnë metodat organike, përmes të cilave fitohen pemët dhe perimet e shëndetshme, qumështi dhe mishi i shëndetshëm, ushqimi i papërpunuar të cilin shumica e amerikanëve, edhe popujve tjerë kurrë nuk do të kenë mundësi ta shijojnë.







# Do t'i mbrojmë me gjithçka dëshmitarët, askush s'më frikëson mua

"Askush s'do të më tregojë se çfarë duhet të bëjë. Askush nuk do të ndikojë në mua. Askush s'do të më frikësoj". Dhe Schwendiman theksoi se derisa e kupton "detin politik në të cilin notoj", ai nuk do të lëkundet nga asnjë ndikim që mund të kenë vendimet e tij "në kushte politike apo në stabilitetin në rajon"



Prokurori i Gjykatës Speciale është zotuar të martën se do të bëjë gjithçka që është e mundur për të mbrojtë dëshmitarët të cilët mund "të jenë në rrezik nga gjithçka, nga vdekja e deri tek frikësimi". Dhomat e specializuara të Kosovës, e financuar nga BE dhe e vendosur në Hagë vitin e kaluar, u krijua për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet që supozohet të jenë kryer nga pjesëtarë të lartë të UÇK-së derisa po luftonin me forcat serbe në luftën e viteve 1998-1999.

Akuzat u përfshinë në një raport të vitit 2010 të prezantuar në Këshillin e Sigurimit, dhe flet në detaje për pretendimet për vrasje, ndalime të paligjshme dhe trafikim me organe, gjatë dhe pas luftës për pavarësinë e Kosovës, raporton AFP. Ka pasur shumë spekulime se kush mund të jetë cak i padive, përfshi edhe atë se a mund të jetë edhe presidenti aktual i Kosovës, Hashim Thaçi, në listë. David Schwendiman ka refuzuar të publikojë ndonjë detaj se kush mund të jetë cak apo se kur mund të nisnin paditë e pra. Por ai ka pranuar se, gjatë një takimi me gazetaret në Hagë, zyra

## PROJEKTI I KOSOVËS KA DËSHTUAR NË MËNYRË TË QARTË

Ambasadori rus në OKB, Vasily Nebenzja, ka thënë se Moskë nuk pajtohet me shfaqjet optimiste të paraqitura nga ambasadorja e Kosovës në Washington, Vlora Çitaku. Ai tha se dialogu mes Beogradit dhe Prishtinës "po stagnon" dhe se sipas tij, ngjarjet në Kosovë kërcënojnë të rrezikojnë gjithë rajonin. "Projekti i Republikës së Kosovës në mënyrë të qartë ka dështuar. Nuk është e qartë as kur Gjykata Speciale për krimet e UÇK-së do të fillojë të funksionojë. Këto janë çështje shumë serioze dhe një numër i madh i aktorëve po tenton t'i shtyjë nën tepih", tha ambasadori rus. Sipas tij, formimi i ushtrisë së Kosovës është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Rezolutën 1244, sipas së cilës forca ndërkombëtare është forca e vetme e armatosur në Kosovë. Diplomati rus akuzoi Prishtinën për "sabotimin" e zbatimit të marrëveshjes për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe.



e tij është e "vetëdijshme" për rrezikun me të cilin përballen dëshmitarët potencialë.

"Do të bëjmë gjithçka është e mundur që të provojmë dhe t'u japim atyre rehatinë dhe mbrojtjen që u nevojitet për të marrë pjesë", tha ai, duke thënë se po merren masa speciale, transmeton Koha.net. Dëshmitarët mund të jenë "në rrezik nga gjithçka, nga vdekja deri tek frikësimi apo detyrimi, ryshfeti apo forma tjera të ndikimit dhe përpjekjes për të korrptuar dëshmitarët e tyre".

Tribunali u financua nga Bashkimi Evropian me më shumë se 200 milionë euro për pesë vjet për të gjykuar krimet në Kosovë nga 1 janari i vitit 1998

deri më 31 dhjetor, 2000. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ishte përmendur direkt në raportin e vitit 2010, së bashku me disa të tjerë të rrethit të tij të ngushtë. Ai gjithmonë i ka mohuar këto pretendime, dhe i kishte thënë AFP-së vitin e kaluar se "s'kam asgjë për të fshehur". Schwendiman është zotuar po ashtu se "nuk do të ndikohet apo frikësohet nga atmosfera politike në Kosovë. Një sondazh i prezantuar nga Thaçi në muajin shtator gjeti se shumica e shqiptarëve të Kosovës besojnë se gjykata do të jetë e padrejtë dhe më shumë se gjysma do të protestonin nëse dënohen luftëtarët e UÇK-së. Në bazë të ligjeve

në të cilat është formuar gjykata - e cila drejtohet në bazë të ligjeve të Kosovës me pajtimin e Prishtinës - prokurori "nuk do të merr udhëzime nga askush", tha ai, transmeton Koha.net. "Askush s'do të më tregojë se çfarë duhet të bëjë. Askush nuk do të ndikojë në mua. Askush s'do të më frikësoj".

Dhe Schwendiman theksoi se derisa e kupton "detin politik në të cilin notoj", ai nuk do të lëkundet nga asnjë ndikim që mund të kenë vendimet e tij "në kushte politike apo në stabilitetin në rajon".

"Detyra ime është që të qeveriset nga ligji, nga faktet dhe t'i mbajë individët përgjegjës për sjelljet e tyre", shtoi ai.



## Dodik kundërshton Izetbegoviçin: Bosnja nuk do ta njohë Kosovën

Kryetari i Republikës Serbe, Millorad Dodik, deklaroi sot se Bosnja dhe Hercegovina nuk do të pranojnë Kosovën si shtet, pasi për këtë, sipas tij, nuk ka konsensus. "Kjo varet nga Republika Serbe dhe nuk ka politikan në Republikën Serbe dhe nga Republika Serbe që do të bënte këtë", tha Dodik për mediat serbe. Sipas tij, anëtarë i Presidencës së Bosnjës, Bakir Izetbegoviç "moti do të njihte Kosovën, por ai nuk është Bosnjë". Dodik theksoi se njohja e Kosovës nënkupton edhe njohjen e Republikës Serbe.

## Shqipëria vend prodhimi i kanabisit

Raporti i fundit i Qendrës Evropiane të Drogave dhe Varësisë prej tyre e konsideron Shqipërinë një vend prodhues të kanabisit. Në analizën e bërë për vitin 2017 që përmban të dhëna që prej vitit 2012, thuhet se fenomeni ka njohur rritje e pasqyruar edhe në rastet e identifikimit dhe të shkatërrimit të plantacioneve me kanabis. Raporti citon edhe planin e veprimtimit që ka ndërmarrë qeveria kundër kanabisit. Sipas shifrave që jep dokumenti, viti 2015 shënoi rekordin e plantacioneve të mbjella dhe rrënjëve të shkatërruara. Për shkak të pozicionit gjeografik, Shqipëria konsiderohet një vend tranzit i trafikut të heroinës. Rrugët kryesore që përdoren janë Turqi-Bullgari-Maqedoni-Shqipëri dhe Turqi-Bullgari-Maqedoni-Kosovë-Shqipëri. Heroina transportohet në Shqipëri me kamionë, autobusë, makina etj. Destinacionet kryesore të heroinës janë Italia dhe Greqia. Ndryshe nga kanabisi, shifrat e konfiskimit të heroinës kanë qenë disi të qëndrueshme, citon raporti. Sa i përket kokainës pluhur, thuhet se në Shqipëri ajo hyn në sasi të vogla nëpërmjet korrierëve apo dërgesave postare nga SHBA dhe Amerika e Jugut ndërsa po një rritje transporti me anë të konteinerëve. Citohet edhe laboratorit i zbuluar në Xibrakë në vitin 2015, droga e të cilit ishte e destinuar për në Gjermani. Drogat sintetike thuhet se nuk janë të shpeshta në tregun shqiptar.

## Rama: Tahiri nuk mund të shkonte në burg pa asnjë provë



Kryeministri Rama ka deklaruar se as ai personalisht dhe as Partia Socialiste nuk ka asnjë përgjegjësi për Sajmir Tahirin, i cili akuzohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda si bashkëpunëtor në trafik të lëndëve narkotike nga Shqipëria drejt Italisë. Rama tha se ish-ministri i Brendshëm duhet të mbrohet nga avokatët e tij, edhe pse vijon të jetë një deputet i

lirë. "Tahiri është një çështje që i takon Prokurorisë. Është drejtësia ajo që duhet të thotë të vërtetën. Nuk jam avokat i Sajmir Tahirit, qeveria nuk është avokate e Sajmir Tahirit, Partia Socialiste nuk është avokate e Sajmir Tahirit, që do të thotë se para drejtësisë duhet të sillmi të gjithë si të barabartë, - theksoi kryeministri në emisionin "Studio e Hapur". "Kur e

mësova lajmin se ishte nën akuzë, pata ndjesinë e një konfuzioni të madh, por nuk jam unë ai që them fjalën e fundit. Ta lëmë drejtësinë të bëjë punën e vet". Sipas Ramës, në lidhje me rastin e ish-ministrit të Brendshëm, "çdokush duhet të mbajë përgjegjësi para ligjit për atë që bën. Tahiri është jashtë grupit parlamentar, jashtë grupit të Partisë Socialiste, le të

shkojë të provojë që është i pafajshëm. Por ne nuk mund ta çonim Tahirin në burg pa asnjë provë. A kam folur me të pas çështjes "Sota"? Jo, nuk kam pasur arsye. Këto janë çështje të hetimit, nuk janë të miat". Ndërsa në lidhje me gjetjen e patentave të Saimir Tahirit me 860 mijë euro në makinën e të arrestuarit Sota, Edi Rama tha se nuk mund të flasë pa folur drejtësia.





Lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit, kanë reaguar drejtuesit e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Përmes një komunikatë ata e kanë thënë se "legjitimimi i veprimeve të paligjshme të periudhës së Millosheviçit, në rastin e pronës së Universitetit të Prishtinës, por edhe në raste të tjera të ngjashme, është turp për sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës"

Gjykata e Apelit në Prishtinë ka konfirmuar aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, me të cilin hapësira prej 4 hektarësh brenda kampusit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i takon Kishës Ortodokse Serbe, përkatesisht kishës "Shën Nikolla" në Prishtinë. Aktvendimin tashmë e ka marrë Universiteti i Prishtinës, konfirmojnë zyrtarët e Rektoratit të këtij universiteti. Pikërisht, në hapësirën e kontestuar nga Universiteti i Prishtinës, gjatë viteve 90 -të të shekullit të kaluar, në kohën e regjimit të Sllobodan Millosheviçit, kishte nisur ndërtimi i kishës "Krishti shpëtimtar", e cila nga shqiptarët e Kosovës shihet si objekt i ndërtuar me qëllime politike. Universiteti i Prishtinës konsideron që hapësira në të cilën është ndërtuar kisha, është në shfrytëzim nga universiteti, tash e 50 vjet me radhë. Në vitin 2012, Universiteti i Prishtinës, kishte nisur procesin gjyqësor për pronësinë e tokës, gjegjësisht kërkesën që toka e kontestuar t'i kthehet nën pronësi Universitetit. Më 26 dhjetor të vitit 2015, Universiteti i Prishtinës kishte marrë një aktvendim të parë të Gjykatës Themelore të Prishtinës, ku konsiderohej e tërhequr padia e Universitetit të Prishtinës kundër të paditurës Kishës ortodokse "Shën

## S'ka kush e fiton Kishën e Millosheviçit



Nikolla", për vërtetim të pronësisë. Për faktin se në seancën gjyqësore kishte munguar përfaqësuesi ligjor i Universitetit të Prishtinës, Gjykata Themelore kishte konfirmuar pronësinë e Kishës ortodokse serbe "Shën Nikolla". Sekretari i përgjithshëm i Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Esat Kelmendi, duke folur për Radion Evropa e Lirë, ka shpjeguar se në kohën kur ka arritur ftesa nga Gjykata Themelore, në Universitet ka pasur protesta të studentëve, të cilat kanë pamundësuar rrjedhjen normale të informimit për ftesën nga gjykata. Rrjedhimisht, Universitetit i ka ikur data për t'u paraqitur në gjykatë. "Ne menjëherë kemi dërguar reagimin tonë, sipas ligjit siç parashihet, për ta arsyetuar mungesën tonë në këtë seancë. Patqësisht kjo nuk është marrë në konsideratë dhe nxirret një vendim më 18 janar 2016, ku hidhet poshtë kërkesa e paditësit për të qenë në gjendjen e mëparshme. Njëkohësisht kemi dërguar edhe në Gjykatë të Apelit një kërkesë të tillë, e cila tani ka ardhur, me datën 31

nga Gjykata e Apelit, e cila po ashtu e hedhë poshtë, si të pabazuar, ankesën e përfaqësuesit, me arsyetim që nuk ka mundur të marrë pjesë. E vërtetoi vendimin e shkallës së parë, të Gjykatës Themelore", thotë Kelmendi. Megjithatë, Kelmendi thotë se ende nuk ka përfunduar e gjithë çështja dhe se Universiteti deri në fund të kësaj jave do të kërkojë që procesi gjyqësor të kthehet në pikën zero. "Menaxhmenti aktual, përsëri do ta iniciojë procedurën pranë Gjykatës Themelore. Do të ngritë padi të re, sepse fatmirësisht, hedhja poshtë e padisë nuk nënkupton humbjen e të drejtës për padi të re. Universiteti i Prishtinës është duke përgatitur dosjen dhe besoj që deri në fund të javës do ta kemi padinë e re pranë gjykatës kompetente, për të kërkuar të drejtën tonë, në mënyrë që kjo pronë e uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme, t'i kthehet në shfrytëzim UP-së dhe studentëve të saj".

Siç thotë Kelmendi, gjatë kohës sa ka zgjatur kontesti gjyqësorë, Universitetit të Prishtinës i është dashur të sh-

mangë një varg projektesh për ndërtimin e objekteve të ndryshme në kampusin e saj. Në anën tjetër, përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe nuk kanë dashur ta komentojnë vendimin e Gjykatës së Apelit, e as paralajmërimet e Universitetit të Prishtinës për iniciimin e një procesi të ri gjyqësor, por kanë theksuar se dëshirojnë që kjo çështje të rregullohet paqësisht. Lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit, kanë reaguar drejtuesit e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Përmes një komunikatë ata e kanë thënë se "legjitimimi i veprimeve të paligjshme të periudhës së Millosheviçit, në rastin e pronës së Universitetit të Prishtinës, por edhe në raste të tjera të ngjashme, është turp për sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës". Gjithashtu, drejtuesit e këtij Fakultetit Filozofik, e kanë kritikuar menaxhmentet e Universitetit të Prishtinës, të viteve 2015 deri 2017 për, siç thuhet, papërgjegjësi, e cila "është e patolerueshme, si dhe dëmton pronën dhe kredibilitetin" e Universitetit. (REL)

## E dënuara me dietë: Më lini në burg, dua të dobësohem!



41-vjeçarja, banore në Ljubjanë, ka dashur të qëndrojë edhe 30 ditë më shumë në burg, pavarësisht se iu dha mundësia t'i jepej liria

"Më lini në burg, dua të dobësohem". Kjo është kërkesa e pabesueshme që një qytetare sllovene, Branka Virant ka formuluar para gjykatës Mladenka Paro Rudiç në Kroaci. 41-vjeçarja, banore në Ljubjanë, ka dashur të qëndrojë edhe 30 ditë më shumë në burg, pavarësisht se iu dha mundësia t'i jepej liria. Gjykatësja nuk mundi t'ia plotësojë dëshirën dhe ka vendosur ta nxjerrë nga hekurat.

"Këtu janë shumë mirë, - ka shpjeguar Virant, e arrestuar në gusht pasi u filmua nga kamerat e sigurisë ndërsa vidhte parfume luksoze në një dyqan. - Jeta në burg më ka dhënë një fizik të tonifikuar. Jam dobësuar pesë kilogramë. Dua të qëndroj edhe 30 ditë në burg dhe pastaj do të mbërrij në peshën time ideale".

"Ju jeni arrestuar, sepse akuzoheni për vjedhje në dy raste, - ka shpjeguar ajo. - Sipas ligjit, nëse faji juaj provohet, mund të bëni deri në 3 vjet burg. Kjo do të thotë se lirimi me kusht mund të zgjasë jo më shumë se 3 muaj. Me që ju jeni burgosur në 19 gusht, duhet të dilni prej andej në datën 19 nëntor, të dielën, për t'u mbrojtur në liri gjatë procesit i cili do të vazhdojë". Asnjë tolerim pra: kura e dobësim-it do të ndërpritet para kohe...

## Rumania dëbon çetnikun serb për spiunim

Rumania ka përjashtuar një çetnik serb pro-rus dhe ia ka ndaluar hyrjen në shtetin e NATO-s për 15 vjet, pasi kishte shprehur interesim për marrjen e informatave lidhur me pajisjet ushtarake, ka njoftuar agjencia shtetërore e sigurisë. Bratislav Zhivkoviç, 42-vjeçar, është paramilitar serb dhe ishte në Krime gjatë periudhës 2014-15 për të përkrahur Rusinë atje. Ai



u kishte thënë gazetarëve në atë kohë se ishte e natyrisht që dëshironte t'i ndihmonte rusët në luftën ndaj Ukrainës. Një zyrtar i shërbimit sekret të Rumanisë ka

thënë se e kishin identifikuar Zhivkoviçin "pasi kishin parë se ai kishte shprehur interesim për marrjen e dokumenteve lidhur me infrastrukturën dhe objektivat e ushtrisë dhe aleatëve ushtarakë të vendosur në juglindje të Rumanisë, me qëllim që të ndikonte në strategjinë tonë dhe partnerëve". Ovidiu Marincea ka thënë për Reuters se Zhivkoviç ishte

zënë duke fotografuar radarët e ushtrisë në bregun e Detit të Zi dhe teksta përpjekje që të transmetonte koordinatat e tyre, transmeton Koha.net. "Dua të theksoj se ky shtetas serb nuk pati sukses në grumbullimin e dokumenteve apo informatave", ka thënë Marincea, që ka shtuar se Zhivkoviç u konsiderua si kërcënim për sigurinë kombëtare të Rumanisë.

## 10 për qind e serbëve të veriut mbështesin anëtarësimin e Kosovës në BE

Banorët e katër komunave në veri nuk shohin ardhmëri në shtetin e Kosovës. Derisa gjendja ekonomike ishte shqetësimi i tyre kryesor në vitin e kaluar, tani ata brengosen për sigurinë. Hulumentimi i tretë me radhë i publikuar nga organizata AKTIV tregon se 78 % e të anketuarve nuk i besojnë asnjë

politikani serb, e përqindja e mosbesimit rritet në 96.4 kur bëhet fjalë për politikanë shqiptarë. Përqindja e ulët në besim mbetet edhe rreth Brukselit dhe marrëveshjeve që derivuan, derisa në diskutimin që pasoi, u tha që pak po bëhet në përmirësimin e marrëdhënieve mes njerëzve. Ndër gjetjet e këtij hulumentimi,

është edhe pasiguria e gjysmës së banorëve të komunave në veri, që shprehin publikisht qëndrimet politike. Afër 80% e të anketuarve mendojnë se Bashkimi Evropian anon nga Prishtina në dialogun Kosovë - Serbi, ndërsa një prej të gjeturave është edhe se gati çdo i dyti i anketuar, nuk e sheh veten në

Kosovë në vjetët e ardhshëm. 65 % nga 800 të anketuarve, besojnë se Rusia duhet të jetë partneri kryesor për të lobuar për mbrojtjen e të drejtave të serbëve në Kosovë. Ky është hulumentimi i tretë nga kjo organizatë, që u referohet komunave Zubin Potok, Zvečan, Leposaviq dhe Mitrovicë e Veriut.







## Dy këlyshë luani në aeroport



Kur punonjësit e kontrollit në aeroportin e Kajros kanë parë në monitor, nuk i besonin syve: në brendësi të një valixheje ishin dy këlyshë luani të gjallë, por të narkotizuar. Për shkelje të ligjit mbi mbrojtjen e kafshëve, policia ka arrestuar personin që i zotëronte, një shtetas nga Kuvajti. Këlyshët janë dërguar në kopshtin zoologjik në Giza. Ajo që ka bërë kontrollorët të dyshojnë, kanë qenë dy format e pazakonta në brendësi të bagazhit. Kafshët e vogla ishin vendosur "kokë e këmbë" bashkë dhe duke i kufizuar thonjtë për të mos çarë valixhet.

## BE fillon aleancën e vet ushtarake

Nuk mjafton veç NATO-ja! BE fillon aleancën e vet ushtarake. BE është gati të formojë aleancën e vet ushtarake. PESCO është nënshkruar nga 23 anëtarët e Bashkimit Evropian. Shefja e BE-së për politikë të jashtme Federica Mogherini e ka mbështetur këtë hap duke thënë që është një moment historik. Fondi I rezervuar për këtë ushtri është 5 miliardë euro dhe pritet të rritet. Marrëveshja e nënshkruar nga 23 vende në Bruksel do të hyj në fuqi në dhjetor të këtij viti.

## Burg për kalin, ndodh në Brazil



Policia ka surprizuar kur ka mbajtur për 24 orë në qeli një kalë për vandalizëm. Ngjarja ka ndodhur këtë të diel në Nossa Senhora Aparecida, në verilindje të Brazilit. Pronari i tij tregoi se kujtoi se policia po bënte shaka kur i mori kalin pasi kishte dëmtuar një makinë. Por për habinë e çdo kujt kali ka qëndruar në qeli për 24 orë, kjo edhe pas këmbënguljes së pronares së makinës që kërkonte izolimin e kalit derisa t'i paguhej dëmi.

# E pasura e varfër Gjermani

**Koniunkturë e mirë, ekonomi në bum - në fakt shumica e gjermanëve duhej të ishin posaçërisht në mirëqenie. Por ata nuk janë. Rreziku për t'u varfëruar, madje është i lartë, sipas fondacionit Hans-Böckler**

Një supozim: Të ardhurat mujore i humbet, sepse sëmuresh keq, aq sa nuk mund të punosh më. Një sigurim për raste të paafetësisë për punë, nuk është kontraktuar, ose për arsye financiare, ose nga mosdëshira. Një pension për kufizimin e aftësive për punë as që shtrohet për diskutim. Një rast tjetër: moshë e pensionit është arritur, por pensioni shtetëror është aq i ulët, sa prej tij nuk mund të jetohet. Një sigurim privat për moshën e tretë nuk ekziston. Nëse dikujt i ndodh kështu, ai rrezikohet nga humnera e pashmangshme financiare. Sigurimi social hyn në veprim, vetëm nëse nuk ke asgjë, nëse ke një pasuri vetjake mund të marrësh asistencë sociale, vetëm pasi të jetë konsumuar kjo pasuri në tërësi. Nëse përfundon me asistencën e papunësisë (Arbeitslosengeld II) ose atë sociale, atëherë ndodhesh nën kufirin e varfërisë.

### PASURITË GJERMANE JANË TË PAMJAFTUESHME

Instituti i Studimeve Ekonomike e Sociale (WSI) i fondacionit të sindikatave Hans-Böckler ka bërë objekt të raportit të saj mbi shpërndarjen e pasurisë një situatë të supozuar. Sa kohë mund të mbahet një buxhet familjar gjerman me pasurinë që posedon, derisa të mos ketë më asgjë? Rezultati i studimit është, që një e treta e buxheteve familjare mund të mbahen me kursimet që kanë vetëm pak javë ose pak muaj. Ndërsa buxhete familjare në majën e shkallës së klasifikimit të pasurisë mund të mbahen



të paktën dy vjet deri në dy dekada. Se sa kohë mjaftojnë paratë, kjo varet nga shpenzimet. Por kjo prek fare pak. Pasuritë në Gjermani janë të shpërndara jo proporcionalisht. Dhjetë për qind e popullsisë posedon 60 për qind të vlerave të pasurisë. 50 për qind e popullsisë posedon vetëm 2,4 të vlerave të pasurisë. Kësaj i shtohen edhe dallimet Lindje-Perëndim: buxhetet familjare në lindje të Gjermanisë me pasurinë e tyre nuk mund të mbahen aq gjatë sa ato në perëndim të Gjermanisë. Qytetarët e moshuar ndonëse kanë më shumë rezerva financiare, në këtë grupmoshë një në pesë buxhete mbahet vetëm prej të ardhurave mujore. Prindër të divorcuar që rrisin fëmijët vetëm kanë më pak mundësi të kompensojnë të ardhurat e pakta prej rezervave.

### GJERMANËT, EUROPIANËT MË TË VARFËR

### JETË NË PASIGURI EKONOMIKE

Nëse analizohet në detaje 50 për qind e gjermanëve, që sipas fondacionit Hans-Böckler nuk janë në gjendje të krijojnë pasuri me rezerva, atëherë rezultojnë dy nëngrupe. Nga njëra anë nën 20 për qind e popullsisë, që jeton prej asistencës sociale, ose me pensionin minimal ligjor. Këta konsiderohen si "të varfër". Ndërsa 30 për qind, të ashtuquajturit "shtresa e ulët e mesme" punojnë me normë të plotë, e megjithatë kanë aq pak të ardhura, sa u duhet të jetojnë vazhdimisht në pasiguri materiale.

Gjermania është "e varfër në pasuri", pikërisht në grupet me të ardhura të pakta, thotë Anke Hassel, drejtore shkencore në WSI. Kjo ka të bëjë ndër të tjera me faktin, se Republika Federale e Gjermanisë është një "vend i qirave". Vetëm 40 për qind e njerëzve kanë një shtëpi të vetën. Ndërkohë që 70 deri në 80 për qind e italianëve dhe spanjollëve posedojnë imobilje. "Në vende të tjera edhe njerëzit me të ardhura të pakta mund të krijojnë vlera pasurie përmes imobilie", thotë Hassel. Kjo vlen në Evropë me sa duket në shumë vende. Ndërsa Gjermania është motori ekonomik i Evropës. Koniunktura dhe ekonomia janë në bum, papunësia po ulët gjithnjë e më shumë, megjithatë, sipas një studimi të Bankës Qendrore Evropiane gjysma e buxheteve familjare gjermane duke zbritur borxhet më së shumti posedon zero deri në maksimumi 60.000

Euro. Në Qipro dhe në Itali pasuria mesatare është nga 170.000 deri në 150.000 Euro. Francezët arrijnë gati tek dyfish më shumë se gjermanët. Madje edhe Portugalia e Greqia ka një vlerë më të lartë pasurie mesatare për buxhet familjar krahasuar me Gjermaninë.

### JETË NË PASIGURI EKONOMIKE

Nëse analizohet në detaje 50 për qind e gjermanëve, që sipas fondacionit Hans-Böckler nuk janë në gjendje të krijojnë pasuri me rezerva, atëherë rezultojnë dy nëngrupe. Nga njëra anë nën 20 për qind e popullsisë, që jeton prej asistencës sociale, ose me pensionin minimal ligjor. Këta konsiderohen si "të varfër". Ndërsa 30 për qind, të ashtuquajturit "shtresa e ulët e mesme" punojnë me normë të plotë, e megjithatë kanë aq pak të ardhura, sa u duhet të jetojnë vazhdimisht në pasiguri materiale.

# Gjenocidi, Suu Kyi vazhdon të heshtë

**Mos reagimi i Suu Kyi, për dëbimin e mijëra muslimanëve të Arakanit nga tokat e tyre dhe vrasjen e mijëra të tjerëve, po shkaktonte kritika të shumta në komunitetin ndërkombëtar**



Udhëheqësja e Mianmarit, fituese e "Çmimit Nobel", Aung San Suu Kyi, pavarësisht të gjithë reagimeve dhe thirrjeve nga komuniteti ndërkombëtar, vazhdon heshtjen e saj ndaj

persekutimit të muslimanëve të Arakanit. Mos reagimi i Suu Kyi, për dëbimin e mijëra muslimanëve të Arakanit nga tokat e tyre dhe vrasjen e mijëra të

tjerëve, e cila në vitin 1991 kishte fituar Çmimin Nobel për "demokraci, të drejtat e njeriut dhe luftën kundër dhunës", po shkaktonte kritika të shumta në komunitetin ndërkombëtar. Edhe deklaratat e saj për gjendjen në Arakan ku thotë se "Ka akuza të ndërsjella. Duhet t'i dëgjojmë të gjitha. Para se të veprojmë duhet të jemi të sigurt që akuzat bazohen në themele të sigurta. Jemi një shtet i ri dhe i brishtë, i cili përballet me probleme të shumta", shkaktuan reagime të shumta. Përveç politikanëve, edhe organizata dhe personalitete të shumta si

muzikantë, shkrimtarë, fitues të Çmimit Nobel dhe mbrojtës të të drejtave të njeriut po bëjnë thirrje që Suu Kyi t'i japë fund heshtjes dhe të veprojë sa me shpejt. Në këtë proces u tërhoqën ose filluan fushatat për tërheqjen e disa çmimeve të dhëna në të kaluarën për Suu Kyi. Mijëra muslimanë të Arakanit kanë humbur jetën që nga 25 gushti e deri tani si rezultat i sulmeve të ushtrisë së Mianmarit, e cila pretendon se është duke luftuar me militantë të armatosur. Numri i saktë i viktimave ende nuk mund të verifikohet, për arsye se qeveria e Mianmarit nuk lejon hyrjet dhe

daljet në rajon. Gjatë sulmeve të cilat janë shndërruar në një spastrim etnik janë djegur ose shkatërruar rreth 300 fshatra nga ushtria dhe budistët radikalë, si dhe mbi 600 mijë muslimanë të Arakanit janë larguar në Bangladesh nëpërmjet rrugëve malore, detare apo të lumeneve. Ndërkohë dhjetëra mijëra të tjerë janë në kërkim të rrugëve për t'u larguar në Bangladesh. Parashikohet se rreth 2 milionë muslimanë jetonin në Arakan në vitet 1970, por ky numër ka rënë nën 350 mijë për shkak të largimeve nga sulmet sistematike.





**Ataullah Efendiu, në Kongres e Kudusit nuk mori pjesë si i deleguar i Bashkësisë Islame të Mbretërisë së atëhershme jugosllave, por në cilësinë e një dijetari të shquar islam, dhe se të gjitha shpenzimet e udhëtimit si dhe të qëndrimit disaditorë në Jerusalem, ishin mbuluar nga disa donatorë shqiptar të Shkupit**

Qerim LITA

Ashtu siç u tha më parë, me t'u kthye në Shkup, Ataullah Hoxha në bashkëpunim me Shefki Beun e disa përkrahës tjerë të tij, inicioi dhe rihaqi Medresenë Medah. Kjo shkollë fetare për autoritetet e atëhershme serbomadhe brenda Mexhllisit të Ulemasë në Shkup, u vlerësua si pengesë për realizimin e politikës së tyre asimiluese, përkatësisht zhdukjen e traditës e të kulturës shqiptare te popullsia myslimane dhe mbjelljen te ta, të kulturës serbe, një politikë e cila siç u tha më lartë, zbatohet përmes Medresesë së Madhe Kral Aleksandri i I-ë.

### Nuk u parapanë mjete për Medresenë

Një politikë e tillë erdhi në shprehje, veçmas pas sjelljes së Kushtetutës së parë të BFI-së, kur në buxhetin e Mexhllisit të Ulemasë për vitin 1932, nuk u parapanë as çfarë mjete për Medresenë Medah, nën pretekst se të njëjtat ishin dedikuar për financimin e shoqatës "Gajret" si dhe për dhënie e bursave për studentët jashtë vendit. Menjëherë pas publikimit të buxhetit, reagoi Ataullah Hoxha, i cili më 5 dhjetor të vitit 1931, dërgoi një parashtrësë deri te bani i Shkupit. Në të, fillimisht përshkruhej roli i përgjithshëm fetar që kishin medreset, në të cilat siç vë në dukje, ligjërohej para së gjithash "gjuha arabe si gjuhë klasike, me të cilën gjuhë janë shkruar të gjitha librat për teologjinë, etikën dhe të drejtën islame". Medrese të tilla, thuhej në vazhdim të parashtrësës, ka pasur "në çdo rreth të ish Vilajetit të Kosovës", mirëpo, sot nga ata, "ka ngelur vetëm kjo në Shkup (Medah-Q.L.) me 40 nxënës nga të gjitha viset që i mbulon Mexhllisi i Ulemasë. Me sjelljen e Kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame, është menduar, se në radhë të parë, vëmendja "do t'i kushtohet kësaj dhe shkollave të ngjashme të tilla, me qëllim të krijimit sa më parë të njerëzve të ri të arsimuar për punë në shtresat e gjera të popullsisë si imamë, hatib, mujezin e vajiz", mirëpo, duke qëndruar pas çdo regjimi e duke i nëpërkëmbur interesat fetare të kësaj pjese,

## Medreseja Medah dhe Ataullah ef. Kurtishi (2)

# Qëndrimi në Jerusalem

ka ardhur deri te ajo, që "ne sot të mos kemi as numër të mjaftueshëm të personelit fetar, sepse nga ata që janë hasur shumë prej tyre kanë vdekur ose janë shpërngulur, me çka nuk ka se kush t'i edukoj u t'ua kryej shërbimet fetare, sepse Medreseja e Madhe nuk përgatit nëpunës të ngjashëm fetarë", theksonte ndër të tjerave, Ataullah ef. Kurtishi. Disa ditë pas kësaj parashtrëse, kabineti i banit, me shkresën nr. 42.593 të datës 8 dhjetor 1931, kërkoi nga Mexhllisi i Ulemasë të dhëna plotësuese për Medresenë Medah, për arsye se siç thuhej "administrata e banit nuk ka njohuri se ekziston ndonjë Medrese tjetër, në përjashtim të Medresesë Kral Aleksandri I". Rrjedhimisht, pasoi urdhëresë e Mexhllisit të Ulemasë, me të cilët ngarkohej Prokura e Vakëfit Mearif të Qarkut - Shkup, të kryej inspektimin e detajuar në medresenë në fjalë, dhe t'i raportoj për pikat si më poshtë: "1. Nga cili pushtet, kur dhe nën cilin numër është lejuar hapja e Medresesë Medah në Shkup; 2. Me vendimin e cilit pushtet, kur dhe nën cilin numër z. Kurtishi është emëruar për myderriz; 3. Çfarë programi ka Medreseja dhe a realizohet?"

4. Prokura si pushtet mbikëqyrës i drejtpërdrejtë, a e ka inspektuar medresenë dhe çfarë është konstatuar. Nëse kjo deri më tash nuk është kryer menjëherë le të kryhet e të dorëzohet raport i detajuar, i cili ndër të tjerave do të përfshij edhe propozimin e Prokurës për atë: se a thua Medreseja të ngel edhe më tej ashtu siç është ose të riorganizohet dhe në cilën mënyrë ose të mbyllet eventualisht".

### Donatorët shqiptarë të Shkupit

Masat e ndërmarra asaj kohe kundër Ataullah Efendi Kurtishit, lidheshin me pjesëmarrjen e tij në Kongresin Islam i cili u mbajt po atë vit në Kudus (Jerusalem). Nuk posedojmë me të dhëna se a pati ndonjë fjalim, mirëpo dihet mirëfilli se Ataullah Efendiu, në Kongres nuk mori pjesë si i deleguar i Bashkësisë Islame të Mbretërisë së atëhershme jugosllave, por në cilësinë e një dijetari të shquar islam, dhe se të gjitha shpenzimet e udhëtimit si dhe të qëndrimit disaditorë në Jerusalem, ishin mbuluar nga disa donatorë shqiptar të Shkupit. Nga ky moment, u shtuan përpjekjet për ta penguar zhvillimin normal të mësimin në Medresenë Medah. Më 31 dhjetor të vitit 1932, Mexhllisi i Ulemasë, me vendimin nr. 2.371/32, shkarkoi Ataullah ef. Kurtishit në cilësinë e myder-



rizit të medresesë, dhe në vend të tij emëroi myderrizin nga Mitrovica, Rexhep Remzi Abdullahun. Zbatimin e këtij vendimi duhej ta kryente Prokura e Vakëfit të Qarkut - Shkup. Për rrjedhojë, më 13 janar të vitit 1933, Rexhep Abdullahu, nën përcjelljen e dy nëpunësve të Prokurës, Ab. Çausheviq dhe Hamid Haxhiq, u paraqit para objektit të medresesë, me qëllim të marrjes së detyrës së re. Një vendim i tillë u hodh poshtë si nga myteveliu i vakëfit Medah, Shefki Beu, po ashtu edhe nga talebet, që këta të fundit në mënyrë të prerë refuzuan shkarkimin e profesorit të tyre Ataullah ef. Kurtishi. Prokura e Vakëfit, me shkresën nr. 121/933 të datës 13 janar 1933, njoftonte Mexhllisin e Ulemasë, se nga ana e saj nuk pati mundësi ta "largoj ish myderrizin e Medahut z. Ataullah Kurtishin" e as ta vendos "në detyrë myderrizin e ri z. Rexhem Remziun". Kjo ngjarje, thuhej më tej në shkresë "shkaktoi habi te popullsia e këtushme myslimane" dhe se flitet në mënyrë të hapur "për pafuqinë e Mexhllisit të Ulemasë" për ta zbatuar vendimin e tij në pikëpamjen e myderrizit të Medresesë Medah. Lidhur me këtë, udhëheqja e Mexhllisit të Ulemasë më 1 shkurt të vitit 1933, i raportonte Kryesisë Supreme të BFI-së në Beograd, se Shefki Beu, ka penguar zbatimin e vendimit të Mexhllisit të Ulemasë të datës 31 dhjetor 1932, sipas së cilit Rexhep Remzi duhej ta merrte detyrën myderriz në Medresenë Medah. Me këtë sjellje thuhej në vazhdim të raportit Shefki Beu "i cili përndryshe është myteveli i vakëfit Medah në Shkup", ka manifestuar

armiqësi ndaj institucioneve e organeve të Bashkësisë Fetare Islame, e në mënyrë të veçantë ndaj këtij Mexhllisi të Ulemasë.

Një ndërhyrje tjetër ndaj politikës fetaro-arsimore të Medresesë Medah, udhëheqja e BFI-së në Shkup e ndërmori në vitin 1935, e cila në atë kohë kishte arritur ta përfitojë përkrahësin më të fuqishëm të Ataullah Hoxhës, Shefki Beun, i cili siç do të shohim në vazhdim, nga një aleat u shndërrua në armik më i përbetuar i tij. Për rrjedhojë, në vitin shkollor me nismën e Shefki Beut, Mexhllisi i Ulemasë me asistencë të forcave policore, ndërhyri brutalisht në hapësirat e Medresesë Medah, me çrastë largoi me dhunë myderrizin e asaj shkolle Ataullah ef. Kurtishin e në vend të tij për myderriz emëroi Aziz Fetah. Kjo ndërhyrje represive shkaktoi revoltë e pakënaqësi të madhe nga ana e talebeve të medresesë, të cilët siç i shkruante Aziz Fetah myteveliu Shefki Beut: "...në thirrjen time, ata nxënës, listën e të cilëve po e bashkëngjesh refuzuan ta pranojnë emërimin tim si myderriz i përgjithshëm e të veprojnë sipas urdhrit tim, por se tashmë kanë deklaruar se mua nuk më pranojnë si myderriz, se ata përkundër emërimit tim si myderriz dhe se ata nuk do t'u nënshtrohen urdhërësave e as do t'i respektojnë udhëzimet, dhe më kanë kërcënuar se do ta pengojnë punën time si myderriz nëse ka nevojë edhe fizikisht". Në vazhdim të letrës Fetah, kërkonte që përmes organeve policore të ndërmerren mase represive, me qëllim, siç do të shprehet, "që të përmendurit ose të

detyrohen në respektimin e urdhërësave ekzistuese të pushtetit fetarë, ose me forcë të largohen nga medreseja". Në vazhdim po i japim emrat e nxënësve të Medresesë Medah, të cilët refuzuan t'i nënshtroheshin muderrisit të dhunshëm Azis Fetah: Hasan Beqiri (1916), Shkup, Mustafa Sulejmani (1914) Nerez, Shkup, Haki Taibi (1917), Hogosht, Gjilan, Abdylrahman Xheladini (1915) Shkup, Hfz. Hasan Aliu (1905), Idriz Sulejmani (1917), Kadri Jashari (1912), Studeniçan I Shkupit, Ferhat Hamidi (1915) Nakushtak I Kumanovës, Hysen Latifi (1914) Prilepnicë, Gjilan, Fadil Haxhiiljazi (1917), Obiliq, Prishtinë, Hamdi Jusufi (1911) Konjare e Poshtme, Shkup, Shukri Mehmedi (1917) Prelez, Ferizaj, Hfz. Beqir Mahmudi (1917) Shkup, Qemal H. Oruçi (19120), Vrapçishtë, Gostivar, Abdylhamid Shabani (1917) Rekë, Kaçanik, Xhemal Emini (1915) Nakushtak, Kumanovë, Abdylhamid Musliu (1910), Nebi Aliu (1915), Ali Ejupi (1918), Smirë, Ferizaj, Ajet Shaqiri (1917), Zarbincë, Gjilan, Imer Emini (1910), Pleshinë, Ferizaj, Salih Mynyri (1919), Studeniçan, Shkup, Sinan Osmani (1915), Grebën, Ferizaj, Osman Jakupi (1918) Sanoc I Poshtëm, Babin Most, Mujedin Shefkiu (1918) Gradac, Koçan, Ramadan Hyseni (1916) Studeniçan, Shkup, Rexhep Hasani (1915), Grebën, Ferizaj, Enver Abdylmehmedi (1922), Shkup, Ibrahim Islami (1922) dhe Xhavid Mehmedi (1922).

### Udhëheqja e përkohshme

Një situatë e tillë zgjati deri në korrik të vitit 1936, kur udhëheqja e përkohshme e Mexhllisit të Ulemasë në krye me Naibin Fejzi Haxhiamziq u detyrua që Ataullah Hoxhën ta riemëroj për myderriz të medresesë në fjalë. Kjo shihet nga shkresa me nr. 3983/36, përmes së cilës, njoftohet Ataullah ef. Kurtishi, se Naibi me këshillin e vet, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor të vitit 1936, solli vendin me të cilin "jeni emëruar për muderriz" dhe se për një kohë sa më të shkurtë "do u jepet në disponim medreseja dhe talebet". Është me rëndësi të vihet në dukje se udhëheqja e përkohshme e Mexhllisit të Ulemasë në Shkup, erdhi si rrjedhojë e Kushtetutës së re të BFI-së e cila u miratua më 25 mars të vitit 1936. Menjëherë, pas kësaj u shkarkuan anëtarët e dy Kuvendeve Mearif të Vakëfeve (Sarajevë dhe Shkup) dhe këshillat drejtues të tyre, si dhe Reis ul Ulemaja dhe anëtarët e dy Mexhlliseve të Ulemave,

dhe në vend të tyre u krijuan organet e përkohshme në krye me Naib-ët, dhe këshillat e tyre, të cilët do të udhëhiqnin me BFI-në, deri në mbajtjen e zgjedhjeve. Kështu në vend të Reis ul Ulemasë Maglajiçit, për Naib u emërua, Prof. Sali efendi Bashicë, ndërsa avokati Fejzi Haxhiamziq, për Naib të Mexhllisit të Ulemasë në Shkup.

Me Kushtetutën e re, në vend të komisarit politik, i cili emërohej nga ministri i Drejtësisë, u krijuan organi ekzekutiv, prej pesë anëtarëve dhe po aq zëvendës, i cili zgjidhej nga Kuvendi Mearif i Vakëfit, ndërsa Këshilli Ekzekutiv zgjidhte nga radhët e veta kryetarin dhe nënkryetarin e tij. Mënyra e zgjedhjeve të këtyre organeve sqarohet në nenin 115 ku thuhej: "Mexhlliset e xhematit, kuvendet mearife të vakëfeve të qarqeve dhe këshillat mearife të vakëfeve në Sarajevë e Shkup zgjidhen përmes zgjedhjeve të përgjithshme, të barabarta, të fshehta e të drejtpërdrejta. Mandati i këtyre organeve zgjat 4 vjet. Zgjedhjet detyrimisht duhet të mbahen brenda një dite".

Territori që mbulohej nga Mexhllisi i Ulemasë në Shkup, përfshinte tetë njësi zgjedhore: njësi zgjedhore e Qarkut të Shkupit me rrethet: Shkup, Nish, Kumanovë, Preshevë, Veles dhe Kaçanik; njësi zgjedhore e qarkut të Tetovës me rrethet: Tetovë, Gostivar dhe Dibër; njësi zgjedhore e Prishtinës me rrethet: Prishtinë, Ferizaj dhe Gjilan; njësi zgjedhore e Prizrenit me rrethet: Prizren, Rahovec, Gjakovë dhe Pejë; njësi zgjedhore e Mitrovicës me rrethet: Mitrovicë, Vushtri, Drenas, Podujevë, Novi Pazar dhe Beograd; njësi zgjedhore e Manastirit me rrethet: Manastir, Kërçovë, Prilep, Resen, Kavadar, Vallandovë, Ohër, Strugë, Koçan, Strumicë dhe Shtip; njësi zgjedhore e Plevës me rrethet: Plevë, Bihor, Bellopole, Priboj, Prijepole, Sjenicë dhe Plavë; njësi zgjedhore e Tivarit me rrethet: Tivar, Ulqin dhe Podgoricë. Është me interes të vihet në dukje fakti se në Kuvendin Mearif të Shkupit zgjidheshin gjithëse 27 anëtarë dhe po aq zëvendës, renditja e të cilëve bëhej në përputhje me numrin e popullsisë myslimane të njësisve zgjedhore, përveç njësisve zgjedhore Plavë dhe Tivar për të cilat ishte përcaktuar me Kushtetutë numri i anëtarëve pa marrë parasysh numrin e popullsisë myslimane.. Kështu njësi zgjedhore e Shkupit zgjidhte 4 anëtarë, e Tetovës 3 anëtarë, Prishtinës 3 anëtarë, Prizrenit 5 anëtarë, Mitrovicës 4 anëtarë, Manastirit 4 anëtarë, Plavës 3 anëtarë dhe Tivarit 1 anëtar. Sipas regjistrimit të fundit të kryer nga udhëheqja e Bashkësisë Islame, në hapësirën që shtrihet Mexhllisi i Ulemasë së Shkupit, deri më 31 dhjetor 1935 jetonin gjithsej 883.616 popullsi myslimane. (vijon)





ana më e mirë e këtij teksti është ndërtim i bukur i paradokseve, si në rastin e cigares dhe llullës, në kontekst të ndalimit të pirjes së duhanit apo edhe të renditjes para shtëpisë publike, ku më i vogli del fituesi më i madh

**Regjisori Kushtrim Bekteshi sprovohet me sukses. Ai ka arritur të ndërtojë një tekst drame, temat dhe motivet e të cilës shtrihen në disa plane. Është një dramë e tipit të absurdit që më shumë mbështetet në motivet psikologjike dhe sociale**

Bardh FRANGU

Të premten e kaluar në teatrin "Bekim Fehmiu", të Prizrenit, u dha premierë shfaqja "Ata që ikin", sipas tekstit dhe regjisë të Kushtrim Bekteshit. Ishin disa arsye që publikun e kishin bërë më kureshtarë për këtë premierë. E para për faktin se regjisori Kushtrim Bekteshi, momentalisht regjisori më i suksesshëm në hapësirat shqiptare, në këtë premierë paraqitej në rolin e një kantautori, përkatësisht paraqitej edhe si autor i tekstit, ndërsa fakti i dytë kishte të bënte me atë se a do të mund ta përsëriste suksesin e shënuar më parë në këtë teatër, me shfaqjen "Shërbëtori i dy zotërinjve" të Carlo Cordonit, shfaqje kjo e cila vitin e kaluar mori të gjitha çmimet e mundshme si shfaqja më e mirë.

Si autor i tekstit mund të themi se regjisori Kushtrim Bekteshi sprovohet me sukses. Ai ka arritur të ndërtojë një tekst drame, temat dhe motivet e të cilës shtrihen në disa plane. Është një dramë e tipit të absurdit që më shumë mbështetet në motivet psikologjike dhe sociale. Kundruar nga plani hapësinor dhe kohor është një dramë që ka të bëjë me fatet e njerëzve, brenda një shoqërie të mbërthyer para së gjithash në krizë morale, të cilët për të ikur, në këtë rast nga vetja dhe nga rrethi përdorin një ashen-

# Teatër

## Fatet në ikje të Kushtrim Bekteshit



sor si metaforë fluturimi dhe një tren që mund t'i dërgojë diku tjetër, në ndonjë adresë të panjohur.

Sigurisht që ana më e mirë e këtij teksti është ndërtim i bukur i paradokseve, si në rastin e cigares dhe llullës, në kontekst të ndalimit të pirjes së duhanit apo edhe të renditjes para shtëpisë publike, ku më i vogli del fituesi më i madh. Kjo mbase përkundër faktit se rrëfimi në të dyja rastet fillon në formë shumë triviale. Edhe analogjitë ndërtohen bukur, si në rastin e varrimit, përkatësisht prit-

jes së kufomës, ku Bekteshi shfrytëzon edhe një element politik shumë të rëndësishëm siç ishte kthimi i të rinjve tanë nëpër arkivolet e mbyllura të ish ushtrisë jugosllave. Kjo mbase në kuptimin hapësinor i jepte një dimension shumë të nevojshëm tekstit. Megjithatë teksti në tërësi, në kuptimin kompozicional, përkatësisht në planin e zhvillimit dhe shturjes së konfliktit, linte për të dëshiruar. Kjo edhe për faktin se përkundër një dramaticiteti të dukshëm nëpër shumë skena, të cilat kanë një unazë lid-

hëse të qëndrueshme dhe që tekstin e bëjnë më të pranueshëm për skenën, ka pjesë të cilat tekstin e largojnë nga kjo dhe i japin një dimension më shumë letrar sesa skenik. Kjo mbase vërehet më shumë në pjesët ku në plan të parë zhvillohet monologu, gjë kjo e cila është vërejtur edhe gjatë shtrirjes së tekstit në skenë.

Sikur ky tekst të kondensohej dhe të strukturtohej më mirë, do të mund ta ndihmonte edhe vetë shfaqjen që të realizohej me një dinamikë më të theksuar, si në skenat kur

teksti ka gjuhë më identifikuese skenike dhe ku ritmi i shfaqjes është i jashtëzakonshëm. Në aspektin gjuhësor teksti nuk duket të jetë i harmonizuar në tërësinë e tij, ndërsa nga një gjuhë e pasur konotative, herë-herë zbritet në një gjuhë të komunikimit të zakonshëm, gjë që këto nivele vërehen edhe në shfaqje. Duket sikur teksti i vetë, Kushtrim Bekteshin e ka vënë në pozitë të palakmueshme edhe në aspektin regjisorial, ndërsa nuk ka pasur kurajon që ta shkurtojë atë, përkatësisht ta shkarkojë nga gjuha thjesht letrare. Mbase në këtë rast bëhet e diskutueshme edhe çështja se përse ky regjisor kaq i suksesshëm insiston që shfaqjet e tij të zhvillohen në kohën brenda më shumë se dy orëve?! Ndryshe si regjisor, Kushtrimi është dëshmuar se mrekullueshëm shfrytëzon hapësirën skenike. Edhe në këtë shfaqje vërehet kjo, mbase do të thoshim më mirë se në shfaqjet e tjera të tij. Një disiplinë skenike e jashtëzakonshme nga aktorët veç e veç, por dhe si trupë, reflekton edhe në kuptimin estetik pamje të pastra dhe përplot shije. Skenografia që dominohet nga një ngjyrë metali dhe që është e mbushur me llambadarë i shërben shumë hapësirës skenike,

brenda të cilës zhvillohet shfaqja. Edhe kostumografia dhe muzika janë në funksion të shfaqjes.

Në këtë shfaqje regjisori ka zgjedhur për model të lojës të ashtuquajturën "gramatikë e shputave", ku e gjithë trupa shfaqet zbatuar në skenë. Por kjo megjithatë nuk është se ka prodhuar ndonjë vlerë të shtuar në lojën e aktorëve, të cilët në kuptimin e kreacionit kolektiv dalloheshin për të mirë, ndërsa në kreacionet individuale, ku trupi dhe shpirti duhej të njësoheshin për të bartur tekstin, mbetej për të dëshiruar. Dy aktorët kryesorë të kësaj trupe, Ernest Malazogu dhe Xhevdet Doda ishin në nivelin e tyre tashmë të dëshmuar, ndërsa përdorimi i Hajat Toçilles për skena tashmë uniforme, duket sikur ka kaluar në një skematizim tashmë monoton, kjo për faktin se shtrati i monotonisë është përsëritja. Në përgjithësi shfaqja u prit mirë nga publiku, sepse kriza morale e shpërfaqur nëpërmjet skenave të shumta, lehtësisht identifikonte ambientin tonë dhe njeriun tonë në të. Madje kishte raste edhe kur karikohej me ndonjë ves a mani të njeriut tonë, si në rastin e korrupsionit. Ndërsa regjisori Kushtrim Bekteshi dëshmoi edhe njëherë se është një regjisor përplot invenzion dhe shumë kërkues për të gjetur më të mirën nëpërmjet lojës në skenë, ndërsa teatri "Bekim Fehmiu" edhe njëherë dëshmoi se është nga teatrot shqiptare më përkushtuese për të krijuar vlera të njëmendta teatrore. Në anën tjetër është mirë që teatrot tona nisin dhe i kthehen dramës kombëtare, përkatësisht teksteve të autorëve tanë, sepse ndryshe nuk mund të pritë një zhvillim më i mirë i teatrit ndër ne.

## Ekspozitë kushtuar shkrimtarit Anton Pashku

**Ekspozita kushtuar Pashkut është një kontribut i specialistëve dhe bibliografëve të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, duke sjellë për herë të parë për publikun në Shqipëri rrugëtimin e veprës së tij përmes botimit të shkrimeve të para, botimeve të sistemuara, raporteve që vepra e tij ndërtoi me kritikën letrare në bashkëkohësinë e vet etj**

Me rastin e 80-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Anton Pashku, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani", zhvilluan sot në mjediset e Bibliotekës

Kombëtare në Tiranë edicionin e dytë të Konferencës Shkencore dhe Ekspozitës "Anton Pashku - shkrimtari". Në këtë konferencë ishin të pranishëm studiues dhe kritikë nga Shqipëria e Kosova. Edicioni i saj i parë u mbajt me sukses në Prishtinë më 17 maj të po këtij viti, duke rikthyer procesin e thelluar të leximit e rileximit që nevojitet për veprën unike të Pashkut.

Ekspozita kushtuar Pashkut është një kontribut i specialistëve dhe bibliografëve të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, duke sjellë për herë të parë për publikun në Shqipëri rrugëtimin e veprës së tij përmes botimit të shkrimeve të para, botimeve të sistemuara, raporteve që vepra e tij ndërtoi me kritikën letrare në bashkëkohësinë e vet etj. Ajo sjell gjithashtu një dokumentim shembullor



të faqeve të shtypit të kohës, lidhjeve të rëndësishme sa miqësore aq edhe letrare e intelektuale të autorit. Këto konferenca dhe ekspozita janë pjesë e aktiviteteve të bashkërenduara në kuadër të bashkëpunimeve mes dy institucioneve tashmë prej vitesh.

Realizimi i ekspozitave, konferencave shkencore, bibliografive dhe botimeve të përbashkëta për veprën

e De Radës, Kadaresë, Rugovës e Musine Kokalarit dhe së fundmi kushtuar veprës së çmuar të Anton Pashkut, na shtojnë jo vetëm në një kremtim dhe përlujtje me nderim përpara veprës dhe kontributit të tyre, por na kthejnë te vetëdija për një moment të ri dhe cilësor reflektimi, njohjeje të ndërsjellë të autorëve dhe të personaliteteve të jetës shpirtërore të kombit. Në

kuadër të fushatës së Ministrisë së Kulturës "Takohemi për një libër", gjatë ditëve që ekspozita do të qëndrojë e hapur, janë parashikuar edhe lexime të veprës së Anton Pashkut me nxënës të gjimnazëve të Tiranës.

Qysh prej botimeve të para më 1955 pena e Anton Pashkut vijoi deri në fund të mbetej nga më unikët dhe autentikët në letërsinë shqipe. Prozator e dramaturg, autor i disa përmbledhjeve me tregime, i romanit të mirënjohur "Oh" dhe dramave "Gof e Sinkopa", ai krijoi e botoi një letërsi me tipare të forta moderne, me vështrime të thella psikologjike, me pyetësime të përhershme të njerëzores në kushtet e vetmisë dhe dashurimit, në hetim të identitares dhe mbi-jetesës kulturore në kushtet e totalitarizmit e dhunës, si dhe me

kërkime formale që e shpinin gjithmonë drejt krijimit të përsosur.

Tregimet e tij antologjike si "Nën qarr po rrinte vasha", "Floçka", "Kulla", "Si e përshkroi ëndrrën e vet njeriu me kapelë", etj imponuan një prag të ri të shkrimit të prozës si për shkrimtarët më të rinj ashtu edhe për mendimin kritik letar në Kosovë.

Nga botimet më të rëndësishme përmendim: "Tregime", 1961; "Nji pjesë e lindjes", 1965; "Kulla", 1968; "Sinkopa", 1969; "Oh", 1971; "Kjasina", 1973; "Gof", 1976; "Lutjet e mbrëmjes", 1978; "Tragjedi moderne", 1982 si dhe botimin e veprës së tij të plotë nga shtëpia botuese e mirënjohur Rilindja me vëllimet "Tregime fantastike", "Oh"; "Tragjedi moderne" te "Vepra letrare" (1986).

(A.A)





Në mesjavë, respektivisht sot (e enjte) do të zhvillohet java e 15 në Ligën e parë futbolistike të Maqedonisë. Lideri aktual Shkëndija do të jetë mysafire e Sileksit në Kratovë, Shkupin e pret një përballje e vështirë në lagjen "Hekuran" përballë "Skopjes", derisa në Tetovë Renova do të pret kampionin aktual Vardarin

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 15 nëntor – Lideri aktual Shkëndija kërkon të marrë pikë në transfertën e sotme me Sileksin në Kratovë për të vazhduar rrugëtimin e saj drejt titullit të dytë. Jo vetëm kuqezinjtë, por edhe futbollistët e Sileksit po luajnë mirë këtë sezon, ndërsa këtë e dëshmon edhe pozita e tretë në tabelë dhe pikët e grumbulluara deri më tani, gjithsejtë 22, një më pak se Vardari. Kjo dëshmon se djemtë e trajnerit Qatip Osmani nuk do ta kenë lehtë dhe se i pret një "luftë" e madhe për të ardhur deri te tre pikët. Çdo hap fals, përfshi këtu edhe barazimin, do të vështirësonte gjërat duke marrë parasysh se Vardari, i cili ka 23 pikë, ka dy ndeshje më pak. Kështu të paktën mendon edhe Olsi Teqja, i cili në prag të kësaj përballje thotë se barazimi event-



al për ata do të ishte një- loj si humbje. Mirëpo, ai pranon se në Kratovë shkojnë për të fituar ndeshjen. "Atmosfera është shumë e mirë, ekipi është përgatitur me shumë seriozitet. Çdo transfertë është e vështirë e delikate, por ne kemi eksperiencën e duhur për të shkuar në çdo vend për të fituar dhe për të marr

tre pikët. Barazimi për ne dihet që është humbje, është dështim, kështu që ne shkojmë vetëm për fitore", deklaroi për gazetën KOHA, Olsi Teqja. FC Shkupi siç thamë e pret një përballje mjaftë e vështirë, ku në lagjen "Hekuran" do të jetë mysafir i "Skopjes". Ajo që brenos të dyja taborët është se fusha në stadiu-

Liga e parë, java e 15

# Shkëndija, Shkupi e Renova kërkojnë pikë të plota

Dyshet:
Pelisteri-A.Pandev
Renova-Vardari
Skopje-Shkupi
Sileksi-Shkëndija
Rabotnički-Pobeda

punojmë gjatë kësaj pauze, e që na ka dhënë hapësirë që të mundemi sa më lehtë të kalojmë ndeshjet e fundit të kësaj faze të kampionatit. Sigurisht se me "Skopjen" nuk do të jetë aspak lehtë, shkaku që do të luajmë në një terren shumë të papërshtatshëm, ndërkohe që edhe reshjet e shiut do ta vështirësojnë edhe më shumë këtë ndeshje. Do të mundohemi të marrim tre pikë, nga fakti se kemi humbur pikë në fushë tonë. Edhe pse në secilën ndeshje kemi luajtur mirë, na ka munguar konkretizimi i rasteve e vetmja pikë e dobët e jona deri më tani", deklaroi Asani. Ndërkohë, trajneri i skuadrës nga Çairi, Ardian Nuhiu po ballafaqo-


het me probleme në prag të kësaj përballje, pasi në dyshim për shkak të lëndimeve janë Bunjamin Shabani dhe Shqiprim Taipi dhe që fati i tyre do të mësohet vetëm ditën para ndeshjes. Renova do të tentojë të ndalë kampionin aktual, skuadër e cila këtë sezon nuk është në lëndimin e duhur, për shkak se ata po luajnë edhe në ndeshjet e Liga Evropës dhe lodhja në mesin e lojtarëve është e evidente. Kampionët aktual në Tetovë shkojnë për të fituar këtë përballje, pasi çdo kiks i radhës i tyre do ti largojë më shumë nga gara për titull. Në anën tjetër Renova me një rezultat pozitiv do të rruante hapin e saj në pozitën e mesme të tabelës. Ndërkohë, në dy përballjet tjera Pelisteri në Manastir do të pret "Akademija Pandevin", ndërsa Rabotnički në "Filipi i dytë" do të jetë nikoqir i Pobodës. Të gjitha ndeshjet e kësaj xhiroje do të fillojnë në ora 13.

## Me Panuçin ndihem mirë, sulmojmë më shumë

Bomberi i kombëtares, Armando Sadiku ka komentuar edhe një herë sfidën e fundit të Shqipërisë, të fituar 2-3 në Turqi. "Unë jetoj për të shënuar, sepse kjo është puna ime në fushë. më vjen mirë që edhe ndaj Turqisë shënuova 2 gola dhe ndihmova skuadrën. Mund të kisha shënuar edhe të tretin, në rastin e golit të Grezdës, por kundërshtari më ndali me faull dhe aty përfitoi Erosi dhe shënoi", tha Sadiku. Armando Sadiku theksoi se me Panuçin skuadra shikon shumë më tepër nga sulmi, ndryshe nga periudha e de Biazit, ku përparësi kishte mbrojtja. "Në kohën e De Biazit kujdeseshim shumë për fazën mbrojtëse, duke ia lënë rastësisë daljet në sulm, ndërsa me Panuçin ndodh krejt ndryshe. Ai është një trajner që kërkon një skuadër sulmuese dhe po na ndihmon shumë që të sulmojmë me vijimësi. Tani Grezda dhe Roshi luajnë më afër meje dhe kemi mundësi të sulmojmë më me efikasitet", deklaroi sulmuesi nga Elbasani. Armando Sadiku u shpreh se është mjaft i lumtur me zgjedhjen për të luajtur te Legia e Varshavës, të cilën e cilësoi si skuadrën më të madhe në Poloni dhe tha se shumë shpejt do të vijë edhe golat në kampionatin polak.



## Behrami, lojtari i parë i Zvicrës që luan në 4 Botërore



Kualifikimi i Zvicrës në Kupën e Botës do të jetë më i veçantë për mesfushorin e saj me prejardhje nga Kosova. Pas dy ndeshjeve në fazën "play-off" kundër Irlandës së Veriut, Zvicra e siguroi kualifikimin në botëror për herë të katërt me radhë, që do të thotë se Valon Behrami do të bëhet lojtari i parë i Zvicrës që

luan në katër botërore, transmeton Express. Behrami për herë të parë luajti në një botëror në vitin 2006 në Gjermani, pasi kishte debutuar për kombëtaren zvicerane në vitin 2005, si dhe luajti në botërorët tjerë në Afrikë e Jugut më 2010 dhe në Brazil më 2014. Rusia 2018 do të jetë botërori i tij i katërt.

## Kosova shpall listën për ndeshjet me Lituaninë dhe Hungarinë Fillon rrugëtimi për Kupën e Botës "Kina 2019"

Kosova do të grumbullohet që nga dita e hënë në Prishtinë në mënyrë që të përgatitet sa më mirë për dritaren e parë të kualifikimeve evropiane për Kupën e Botës "Kina 2019". Ndeshjen e parë, Kosova do ta luaj si nikoqir, kundër Lituanisë. Të gjitha basketbollistët e ftuar nga përzgjedhësi i Kosovës, Brad Greenberg i janë përgjigjur ftesës pozitivisht dhe ata tashmë pritet që të zbarkojnë në kryeqytet që nga 19 nëntori. Kombëtarja jonë prej 20 deri më 23 nëntor do të zhvillojë nga dy seanca stërvitore në ditë, derisa në ditën e ndeshjes, Kosova do ta mbaj një stërvitje në orët e paradites. Në anën tjetër Përfaqësuesja e Lituanisë do të arrijë në Prishtinë më 23 nëntor, ndërsa do ta zhvillojë vetëm një seancë stërvitore dhe atë në ditën e ndeshjes në orët e paradites. Bal-



lafaqimi ndërmjet Kosovës dhe Lituanisë do të zhvillohet më 24 nëntor me fillim nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë dhe i takon Grupit C të kualifikimeve evropiane për Kupën e Botës "Kina 2019". Një ditë pas kësaj ndeshje, Kosova do të udhëtoj për në Debrecen për

t'u përballur me Hungarinë në ndeshjen e dytë kualifikuese. Ky takim do të luhet më 26 nëntor. Duhet theksuar se punimet rreth vendosjes së ulëseve shtesë në palestrenë e vogël të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë janë duke shkuar mirë, dhe sipas kontraktuesit palestra me 2800 ulëse


do të jetë e gatshme për ndeshjen ndaj Lituanisë. Lista: Arti Hajdari, Erjon Kastrati, Alban Veseli, Granit Rugova, Dardan Berisha, Scott Bamforth, Urim Zenelaj, Samir Zekiqi, Ergin Grosha, Lis Shoshi, Gëzim Morina, Fisnik Rugova, Shawn Jones, Leonard Mekaj, Muhamet Hasani.





Për të fituar titullin duhen dy pilotë që duan të fitojnë garat dhe te Ferrari nuk ka dy pilotë të tillë. Arrivabene është i aftë, por me Kimin nuk e fiton dot titullin për konstruktorë

Tenis, "ATP Championship"



Rogier Federer është tenisti i parë gjysmëfinalist i turneut të "ATP Championship", pas fitores 2-1 ndaj gjermanit Aleksander Zverev, turne që po luhet në Londër e ku marrin pjesë 8 tenistët më të mirë në botë, derisa Rafael Nadal është mundur nga belgu David Goffin

# Federer në gjysmëfinale, Nadal mbyll para kohe sezonin

Rogier Federer është tenisti i parë gjysmëfinalist i turneut të "ATP Championship", pas fitores 2-1 ndaj gjermanit Aleksander Zverev, turne që po luhet në Londër e ku marrin pjesë 8 tenistët më të mirë në botë. Një përballje mes dy epokash, por 36-vjeçari zviceran tregoi edhe një herë se është një kampion, duke mundur talentin 20-vjeçar, në një ndeshje me rivalitet vetëm në dy setet e para. Federer fitoi 7-6 në "tie break" setin e parë, por Zverev rikuperon dhe fiton të dytin 7-5, duke barazuar shifrat. Seti i tretë nuk ka histori, me zviceranin që fitoi lehtë-

sisht 6-1 dhe krejt ndeshjen 2-1, duke dalë në gjysmëfinale. Në ndeshjen tjetër të grupit "Boris Becker" në këtë turne, amerikani Xhek Sok mposhti 2-1 (7-5, 2-6, 6-7) kroatin Marin Çiliç, duke hyrë në garë për një vend në fazën gjysmëfinale. Sot luhet ndeshjet e dyta në grupin tjetër, atë "Pete Sampras". Ndërkohë, Rafael Nadal është mundur 2-1 (6-7, 7-6, 4-6) nga belgu David Goffin në ndeshjen e parë në grupe në finalen e "ATP Championship", duke u tërhequr edhe nga turneu. Problemet fizike në gjurin e djathtë, që u shfaqën dy javë më parë, nuk janë

mbyllur për tenistin spanjoll, që vendos të mbyllë para kohe sezonin dhe të përgatitet për 2018-ën. Nadal nuk ishte në formën optimale dhe kjo u kuptua që në fillim, ashtu sikurse nuk ishte edhe Goffin, që nuk ishte në gjendje të fitonte kollaj një ndeshje ndaj një rivali të dëmtuar. "Sezoni im përfundon këtu. Do të tërhiqesha edhe po ta kisha fituar këtë ndeshje", tha Nadal, që vazhdon ta ketë tabu turneu londinez, ku nuk ka fituar asnjëherë. Në takimin tjetër të këtij grupi, bullgari Grigor Dimitrov mundi 2-1 austriakun Dominik Thiem (6-3, 5-7, 7-5).

Publicitet

# Fury nis stërvitjen për përballjen me Xhoshuan

Nga fjalët në vepra. Tajson Fury ka nisur nga puna për t'u rikthyer në formë, për të qenë gati për një përballje të mundshme me kampionin aktual të peshave të rënda Entoni Xhoshua.



Ky i fundit i kërkoi Fury që të rikthehet në formë për t'u përballur së bashku, ndaj Fury ka publikuar një video në rrjetet, ku duket duke u stërvitur. Lëvizjet e tij janë të shpejta, reflekset të mira dhe u shmanget "sulmeve" të rivalit edhe pse duket që është mbipeshë dhe ka shumë kilogramë ende për të hequr. "Seanca e parë stërvitore", ka qenë komenti i Fury, duke lënë të kuptosh se ka nisur seriozisht përgatitjet për t'u rikthyer kampioni i dikurshëm. Pak ditë më parë, Fury i pat thënë

Xhoshua se nuk ka nevojë për stërvitje, pasi mund ta mposhtë edhe kaq i shëndoshë sa është. Britaniku nuk duelon që prej nëntorit 2015, kur mundi Vladimir Klitçko dhe i mori tituj kampionë bote të peshave të rënda, ndërsa Xhoshua mposhti 3 javë më parë Karlos Takam. "Gjyqtari e ndali sfidën, pasi ti nuk ishte në gjend-

je ta fitojë atë. Ke nevojë të stërvitesh ende për të qenë më i shpejtë dhe më pak i rëndë", pat komentuar Fury, që thmbon patriotin e tij, me shpresën që të dy të përballen vitin tjetër. Kështu, Tajson Fury, i pamposhtur në ring, synon të rimarrë titujt kampionë bote që nxori vakant një vit më parë, pasi doli pozitiv.

Publicitet

**SHPALLJE PUBLIKE** I nr. 1787/2017  
(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 i Ligjit për përbarim (Gazeta Zyrtare nr. 72 të datës 12.04.2016))

Përbaruesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori TTK Banka SHA - Shkup nga Shkupi me seli në rr. Naroden Front nr. 19A Shkup, bazuar në dokumentin përbarues ODU nr. 802/16 të datës 21.06.2016 të Notoerit Zulfugar Sejfullai - Gostivar, kundër borxhitul Shoqëria për tregti, hoteleri, transport dhe shërbime RIGON KOM SHPKNJP eksport-import f. Çegran Gostivar dhe debitorit të pengut Ili Ejupi nga Gostivari me seli në f. Çegran rr. 300 pn, për realizim të përbarimit me vlerë prej 5.387.792,00 den. më datë 13.11.2017.

**FTON**

Debitorin e pengut Ili Ejupi nga Gostivari me seli në f. Çegran, për shkak të dorëzimit të:

- Urdhërësës për përbarim ndaj patundshmërisë në bazë të nenit 166 të LP të datës 27.10.2017 të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari,
- Konkluzion për përcaktim të vlerësimit i cili do të realizojë vlerësim të patundshmërisë në bazë të nenit 176 paragrafi 1 të LP nga data 31.10.2017 të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari,
- Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në gazetën ditore.

PARALAJMËROHET debitorit i pengut Ili Ejupi, se mënyra e këtillë e dorëzimit konsiderohet si e rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i barë vet pala.

PËRMBARUES  
Aleksandar Kuzmanovski

Në bazë të nenit 123, paragrafi 2 dhe nenit 131 paragrafi 1 e Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 i Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), dekani i Fakultetit juridik "Justinian Prvi" në Shkup pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

**KONKURS**

1. Për zgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën shkencore e drejta ndërkombëtare private për kohë prej 5 /pesë/ vjet \_\_\_\_\_/1/
2. Për zgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën shkencore e drejta financiare dhe financat për kohë prej 5 /pesë/ vjet \_\_\_\_\_/1/
3. Për zgjedhje të asistentit - doktorantit në sferën shkencore e drejta kushtetuese dhe sistemi politik për kohë prej 5 /pesë/ vjet \_\_\_\_\_/1/
4. Për zgjedhje të asistentit - doktorantit në sferën shkencore e drejta publike ndërkombëtare për kohë prej 5 /pesë/ vjet \_\_\_\_\_/1/

Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara në Ligjin për arsim sipëror, Statutin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e përgjithshme të Fakultetit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtojnë: dëshmi, gjegjësisht vendim dhe/ose diplomë për shkallën e arritur përkatëse të arsimit - doktor i shkencave me së paku 480 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë VIII (për pozitat 1 dhe 2), gjegjësisht vendim dhe/ose certifikatë dhe/ose diplomë për shkallën e arritur përkatëse të arsimit - magjistër me së paku 300 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/2 (për pozitat 3 dhe 4), deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës, certifikatë të shtetësisë, biografi të shkurtë /CV/, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje të punimeve.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është përcaktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Pagesa bazë e mësimdhënësve është rreth 32.000,00 denarë, ndërsa pagesa bazë e asistentëve - doktorantëve është rreth 25.000,00 denarë.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin juridik "Justinian Prvi" në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9b - Shkup, në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit.

Informatat plotësuese në tel. 02/3117-244

Fakulteti juridik "Justinian Prvi" në Shkup

**Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup**  
**Fakulteti ekonomik - Shkup**

Në bazë të nenit 131 dhe 135 të Ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 35/08,... 127/16), nenit 34 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Lajmëtarit universitar nr. 274/13) dhe Vendimit të Këshillit mësimor-shkencor nr. 02-2003/4 të datës 3.11.2017, Fakulteti ekonomik - Shkup publikon:

**KONKURS**

Për zgjedhjen e

- një realizuesi, asistent - doktorant në sferën shkencore: teoria ekonomike (50300);
- një realizuesi, asistent - doktorant në sferën shkencore: kontabilitet (50328);
- një realizuesi, asistent - doktorant në sferën shkencore: grup lëndësh nga sfera juridike (508).

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" (Fletorja universitare nr. 274/13).

Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të parashtojnë edhe: biografi të shkurtë, deklaratë se përmbushin kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, dokumentet me të cilat dëshmohet përmbushja e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme dhe certifikatë të shtetësisë. Dokumentet duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Zgjedhja bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" (Fletorja universitare nr. 274/13).

Pagesa bazë është rreth 22.500 denarë, ndërsa e njëjta do të varet nga angazhimi i kandidatit në pajtim me aktet e Fakultetit.

Orari i punës është i përshtatur me aktet e Fakultetit dhe orarin e orëve me semestër.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e kompletuar të dorëzohen në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit të Konkursit në Arkivin e Fakultetit ekonomik - Shkup ose përmes postës në adresën Bul. "Goce Dellçev" nr. 9V - Shkup.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh. Kandidati i zgjedhur lidh marrëdhënie pune në pajtim me Ligjin për arsim të lartë.

Informatat shtesë mund të merren në telefonin: 02 3 286 825

**Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup**  
**Fakulteti ekonomik - Shkup**





Trajneri i Bajnerit, Hejnkes flet për blerjet dhe klubin

# Bajerni duhet të jetë i përgatitur të blejë edhe blerje të shtrenjta

“Së pari, mendoj se Bajerni duhet të stërvitë e të blejë lojtarë, të cilët kanë një talent të jashtëzakonshëm, në mënyrë që të mbijetojnë në betejën me skuadrat e mëdha të futbollit evropian. Megjithatë, duhet durim për të arritur diçka të tillë. Ky është një proces, i cili zgjat me vite. Një klub si Bajerni duhet të jetë i përgatitur për të bërë edhe blerje të shtrenjta”, u shpreh Hejnkes



Trajneri i Bajernit, Jup Hejnkes, ka folur gjatë një interviste ditën e djeshme lidhur me blerjet e klubit bavarez dhe këshillat që ai ka për blerjen e talentëve. Në këtë intervistë Hejnkes ka thënë: “Së pari, mendoj se Bajerni duhet të stërvitë e të blejë lojtarë, të cilët kanë një talent të jashtëzakonshëm, në mënyrë që të mbijetojnë në betejën me skuadrat e mëdha të futbollit evropian. Megjithatë, duhet durim për të arritur diçka të tillë. Ky është një proces, i cili zgjat me vite. Një klub si Bajerni duhet të jetë i përgatitur për të bërë

edhe blerje të shtrenjta”, u shpreh Hejnkes. Por, trajneri i kampionëve gjermanë nuk ka bërë të ditur shumën që duhet të shpenzojë klubi për të bërë lojtarë të nivelit të lartë edhe pse disa kohë më parë vetë kreu ekzekutiv, Karl Hainz Rumenige, ka thënë: “Edhe nëse do kishim 100 milionë euro, nuk do i kishim shpenzuar për të bërë një lojtar. Diçka e tillë është jashtë çdo koncepti për klubin e Bajernit”, nënvizoi më tej ai. Por, trajneri bavarez, Jup Hejnkes, është shprehur optimist për punën e bërë nga presidenti Hënes dhe kreu

ekzekutiv, Rumenige, duke thënë: “Mendoj se Bajerni e ka një plan të qartë. Uli Henes, Rumenige dhe Salihamixhiç e dinë se çfarë kërkojnë. Në kërkimin e talentëve duhet të jesh mjaft i aftë për t'i gjykuar ata dhe kjo nuk është diçka e lehtë, sidomos për lojtarë të rinj në moshë”. Hejnkes ka folur edhe për një prej sulmuesve gjermanë, të cilët kanë shkëlqyer gjatë viteve të fundit duke thënë: “Sulmuesi i Lajpcigut, Timo Verner, duhet të ishte bërë pjesë e skuadrës bavareze përpara se të nënshkruante me skuadrën e Lajpcigut. Ai do

të ishte përmirësuar shumë në klubin bavarez dhe do ishte kthyer në një lojtar kyç për këtë skuadër. Mendoj se ky është një gabim që Bajerni e ka bërë shpesh. Në këtë skuadër, më të mirët duhet të luajnë, nuk ka rëndësi nëse janë të rinj ose të vjetër në moshë. Mos mendoni se Frank Riberi e ka gjithmonë vendin garantuar në 11-en e parë. Nëse ai është në një formë të mirë, pa dyshim që do luajë, por nëse ai nuk na bind me paraqitjen e tij, atëherë nuk do jetë momenti i duhur për ta aktivizuar”, përfundoi Hejnkes.

Sipas mediave franceze

## Griezmann ka arritur marrëveshje me Barcelonën

Portali francez “Le 10 Sport” avancoi në lajmin e vet, duke ngulmuar se Barcelona ka arritur në parim marrëveshje me Atletico Madridin për sulmuesin Antoine Griezmann, përpara inkorporimit të tij nga 30 qershori i ardhshëm. Sipas kësaj informacioni, Griezmann synon të largohet nga Atletico në fund të këtij sezoni dhe klubi Blaugrana tashmë ka filluar të lëvizë. Kontaktet kanë qenë shumë pozitive dhe madje kjo do të thotë se negociatat janë në rrugën e duhur, deri në atë pikë sa tashmë ekziston një parim i marrëveshjes mbi kushtet e një kontrate të ardhshme, megjithëse kjo mund të jetë subjekt i kushteve të caktuara. Edhe pse asgjë nuk mund të konsiderohet e mbyllur në këtë fazë të sezonit, Barcelona synon të ulet dhe të negociojë me Atletico Madridin në muajt e ardhshëm për të gjetur një marrëveshje. Klauzola e Griezmann, i cili ka një kontratë deri në qershor 2022, aktualisht kap shumën prej njëqind milionë eurosh. Klubi Blaugrana tashmë ka negociuar përfshirjen e mundshme të Griezmann verën e kaluar, që përkon me largimin e Nejmar tek Paris Sen Zhermeni.



## Ronaldo është simboli i Realit



Kristiano Ronaldo është dhe do të mbetet simboli i Real Madrid në vitet e ardhshme. Ky ka qenë thelbi i fjalimit të mbajtur nga Florentino Perez, presidenti i “Los Blancos”, në ditën e asamblesë vjetore të klubit 12 herë kampion i Evropës. “Ne jemi krenar që kemi në skuadër futbollistin më të mirë të planetit, Kristiano Ronaldo”, – tha Perez para anëtarëve dhe aksionarëve “merengues”. – Shumë shpejt do të fitojë “Topin e Artë” numër 5 në karrierën dhe do të konfirmohet si më i miri i kësaj epoke ku po jetojmë. Ai është jashtëzakonisht i talentuar dhe shumë ambicioz. Këto duhet të jenë në ADN e secilit prej nesh, secilit prej atyre që është i përfshirë në botën e Realit”, nënvizoi më tej Perez. “Po

vazhdojmë të punojmë që të rrisim mitin e Realit, – vazhdoi Perez. – Kemi përforcuar ekipin me futbollistë të rinj të talentuar si Teo, Kéballos dhe Vallejo, si dhe kemi rikthyer Llorente dhe MaJoral. LuKas dhe AÇraf vijnë nga ekipet e akademisë. Ne kemi respektuar të gjitha marrëveshjet me UEFA dhe klubet e tjera për “fair play” financiar. Gjithsej 146 futbollistë profesionist në të gjithë botën kanë kontratë me ne. 264 lojtarë stërviten në 13 ekipet elitare, për çdo moshë në “Valdebebas”. Shtatë nga këto ekipe moshash fituan kampionatet përkatëse, ndërsa katër dolën nën kampion. Të rinjtë e drejtuar nga Guti fiton kampionatin, Kupën e Mbretit dhe shkuan deri në finalen e UEFA Youth League.”

## Konte në pritje të telefonatës nga “paskanikët”!

Antonio Konte është në pritje të një telefonate nga gjigantët francezë të Paris SG, teksa vazhdojnë dyshimet për të ardhmen e tij të Çellsit. Ka qenë një sezon i vështirë për kampionët e Anglisë në fuqi, që pavarësisht nga fitorja 1-0 kundër Mançester Junajted në “Stamford Bridge”, presioni nuk është larguar. Sipas “Le10Sport”, Konte e pëlqen idenë e vazhdim-it të karrierës te PSZH. Gjithsesi, Parisi nuk



është klubi i vetëm i interesuar për italianin, që pëlqehet edhe nga AC Milan. Është thujtja e sig-

urt se Paris SZH do të largojë Unai Emery në fund të sezonit, me përjashtim të mundësisë që ky i fundit të fitojë Campions Ligë. Emri i Antonio Konte është ai që intrigon më shumë francezët, teksa pëlqehet edhe Maurizio POKETTINO i Totenhem, por mundësitë që POKETTINO të vazhdojë karrierën në Londër, janë më të mëdha se ato të italianit Konte, që duket në vitin e fundit në “Stamford Bridge”.

## Juvja ëndërron dyshen gjermane



Goretzka dhe Emre Khan, këta janë dy objektivat kryesorë të Juventusit në merkaton e janarit. Dy emrat në fjalë janë në skandencë kontrate me skuadrat respektive, Schalke dhe Liverpool, por konkurrenca për të siguruar shërbimet e tyre është e madhe. Për Juventusin paraqitet një mundësi që nuk duhet humbur. “Janë dy lojtarë luksi me parametër zero, nuk mund ta fsheh që po e studiojmë me shumë kujdes situatën, si shumë skuadra të tjera”, kështu u shpreh Beppe Marota, një ditë më parë. Të vëzhgosh nuk të pengon njeriu, por në këtë rast duhet të dish të hidhesh në sulm në momentin e duhur. Juventusit, gjithsesi, ka treguar se di të tregohet një skuadër oportuniste. Për dy mesfushorët e Kombëtares Gjermane interesimi është i madh nga klubet më në zë në Evropë. Në janar apo në verë me parametër zero, kjo mundet për t'u parë. Precedentët te Juvja janë të shumtë, që nga Pirlo, Pogba, Llorente, Evra, Khedira e Dani Alves.





Mendoj se vitin tjetër do të jetë sezoni im i fundit. Vjen një kohë kur duhet të ndalesh. Më duhet t'i kushtojë kohë projekteve të tjera. Të luash është bukur, por më duhet të merrem edhe me gjëra të tjera

# Njëmbëdhjetë mungesat që mund ta fitonin Botërorin

Në Rusi nuk do të jenë disa nga lojtarët më të mirë. Do të ketë shumë yje të munguara. Mjaftueshëm për të formuar njëmbëdhjetëshin, që mund të konkurrojë në mënyrë të përkryer për titullin e kampionit të botës. Spanjollja "Marca" e propozon një top-formacion të tillë

Fakti është se në Kupën e Botës shkojnë ekipet më të mira dhe lojtarët më të mirë në botë. Ky është një vlerësim i dyfishtë, sepse jo të gjithë lojtarët e mëdhenj kanë pasur mundësinë për të qenë në një kombëtare të nivelit të parë. Jo të gjitha skuadrat e mëdha janë gjithmonë të kualifikuara, shiko Italinë, as lojtarët më të talentuar nuk shkojnë dot në këtë ngjarje të madhe të verës, çdo katër vjet. Edhe në Rusi nuk do të jenë disa nga lojtarët më të mirë. Do të ketë shumë yje të munguara. Mjaftueshëm për të formuar njëmbëdhjetëshin, që mund të konkurrojë në mënyrë të përkryer për titullin e kampionit të botës. Spanjollja "Marca" e propozon një top-formacion të tillë, por, vlen të përmendet, nuk përfshihet dot në të të gjithë. Mund të mendojmë për një numër të vogël emrash, si Aurieri, Pulisici, Mahrez, Xheko, Hamshik, Pjaniç, Insigne dhe kështu mund të vazhdojmë.

**PORTA: Buffon / Oblak**  
Vështirë, nëse jo e pamundur, të zgjedhësh për një. E kaluara dhe e tashmja e bukur kundër të ardhmes dhe kontrastit të realitetit "mes shtyllash". Udhëheqja e Buffon dhe soliditeti i Oblak nuk do të jenë në Rusi.



Sloveni befason më pak nga entiteti i kombëtares së tij. Italiani dhe lotët e tij, lamtumira e trishtuar, tashmë është pjesë e historisë së Kupës Botërore, që ende nuk është kontestuar.

**MBROJTJA: Alaba-Bonuçi-Kielini**  
Lojtari i Bayern Munihi është një mungesë klasike e një eventimenti të tillë të madh. Austria nuk tregon shumë për garat e mëdha dhe Alaba është ende në nivelin më të mirë. Futbollisti i Ba-

jern Munihi ende nuk e di se çfarë do të thotë të luash një Kupë Bote. Bonuçi dhe Kielini, dy nga mbrojtësit më të mirë në botë, janë viktimat e katastrofës italiane.

**MESFUSHA: Mkhitarian-Verratti-Vidal-Bejll**  
Këtu opsionet ishin të shumfishta. Ne zgjedhëm për Mkhitarian në të djathtë, për rolin e tij të rëndësishëm në një Manchester Junajted në rritje dhe nevojën për të mbuluar atë krah të djathtë. Verratti, një nga lojtarët më me

tru në këtë repart, nuk do të jetë në Rusi, pranë zembrës dhe grintës së Arturo Vidal, një tjetër mungesë e befasishme e Kupës së Botës së ardhshme. Në anën e majtë, një Geret Bejll, që edhe lëndimet nuk e kanë lejuar të luajë e ndihmojë Uellsin.

**SULMI: Robben-Aubamejang-Sançez**

Ky "trident" mund të jetë plotësisht një prej sulmeve kryesore të Evropës. Holandezi me siguri po përballet me thirrjen e fundit për një Kupë Bote, por kriza e futbollit e portokalli e ka lënë atë pa një biletë në Rusi, ku me siguri do të kishte lënë "gjurmë" për t'u kujtuar. Aubamejang ishte më pak i prituri për t'u kualifikuar, që kur Gaboni si kombëtare nuk është një nga ekipet kryesore të kontinentit të vet. Aleksis, ndërkohë, bashkohet me Vidalin dhe dështimin e Kilit, një tjetër nga zhgënjimet kryesore përpara turneut, së bashku me Holandën dhe Italinë.

## Mungesa e Italisë, më e madhja në historinë e Botërorëve!

Legjenda e Argjentinës, Diego Armando Maradona, e ka cilësuar dështimin e Italisë në eliminatoret e Kupës së Botës si "një nga mungesat më të mëdha" në historinë e futbollit ndërkombëtar. Katër herë kampionët e botës nuk arritën të marrin një vend në fazën finale, që do të zhvillohet vitin e ardhshëm në Rusi, pasi u eliminuan nga Suedia në "play off", me rezultatin e përgjithshëm 1-0. Kanë kaluar 60 vjet nga hera e fundit që Italia nuk ka luajtur në një kampionat botëror. "Më vjen shumë keq që Italia nuk do të jetë në Kupën e Botës. Italianët e bëjnë shumë tërheqëse këtë veprimtari dhe mendoj se kjo është një nga mungesat më të mëdha në historinë e kampionateve botërore, - deklaroi Maradona. - E pashë ndeshjen. Italia luajti ashtu si donte Suedia, me krosime. Suedezët kishin qendërmbrojtës gjigantë. Është shumë e trishtë që nuk do e shohim Italinë në Rusi. Kjo tregon se eliminatoret po bëhen gjithnjë e më të vështira", deklaroi Maradona.



## Nejmar, gjithmonë i mirëpritur te Real Madridi



Mesfushori i Real Madridit, Kasemiro, shpreson që Nejmar do të bashkohet me kampionët e La Ligas. Ai tha se shoku i tij në kombëtaren e Brazilit do të ishte gjithmonë i mirëpritur në klubin madrilen. Nejmar, 25 vjeç, ka qenë i lidhur me Real Madridin, pavarësisht se është bashkuar me PSZH-në nga Barcelona për një marrëveshje rekord botëror në gusht. Kasemiro tha se donte ta kishte

Nejmarin në "Santiago Bernabeu", por këmbënguli se shoku i tij i ekipit ndërkombëtar ishte i lumtur në Paris. "Ai është një yll, e di se çfarë po bën, është një lojtar i madh dhe do të jetë gjithmonë i mirëpritur te Real Madridi", - tha ai për "COPE", pas barazimit miqësor të Brazilit me Anglinë, të martën. - Unë shpresoj që ai të vijë, por është i lumtur në klubin e tij", përfundoi Kasemiro.

## I kërkojmë falje Italisë

Lorenzo Insigne, futbollisti i Napolit dhe përfaqësueses së Italisë, i shndërruar në protagonist ndonëse nuk u aktivizua për asnjë minutë ndaj Suedisë, në ndeshjen e dytë plej-of, madje i konsideruar edhe si një prej motiveve të dështimit të azzurrëve në tentativën për tu kualifikuar në Botërorin e "Rusi 2018", foli sot për "Sky Sport". Në rikthimin e tij në Napoli, pas barazimit të së hënës në "San Siro" ndaj Suedisë, që shënoi edhe eliminimin e Italisë nga finalët e Botërorit, Insigne deklaroi. "Më vjen keq që nuk do të shkojmë në Botëror sepse është një kompeticion shumë i bukur. Dhamë shpirtin deri në fund. I kërkojmë falje popullit të Italisë, do të rimëkëmbemi herën tjetër", u shpreh Insigne. "Kam thënë gjithmonë se do t'i pranoja zgjedhjet e trajnerit, kështu është në rregull. Nuk pendohej, dje ishte një ndeshje për tu fituar. Trajneri besoi se ata ishin burrat e duhur. Pranoj zgjedhjet, sepse me fanelën e përfaqësueses kështu duhet



bërë gjithmonë. Unë do të jem gjithmonë në dispozicion të kombëtares. Ta udhëheq? Nëse do ta kem këtë detyrë, shpresoj të jem në lartësinë e duhur. Objektivi im tani është titulli kampion me Napolin. Do të japim gjithçka për të arritur të parët në maj", përfundoi ylli i Napolit, Insigne.

## Mekses i jep lamtumirën futbollit

Filipe Mekses, ish-futbollisti i Romës dhe Milanit ka vendosur t'i japë lamtumirën futbollit të luajtur. Francezi sqaron vendimin e tij në një intervistë të dhënë për "France Football": "Jam kthyer në një jetë reale, pa njoftuar askënd. Nuk jam Zidane, Toti apo Turam. Ajo që dua është të jem si të gjithë. Bëj rolin e babait, çoj fëmijët e mi në shkollë, në futboll, bëj de-

tyrat me ata. Desha të dal dhe t'i nxjerr nga një dimension i çuditshëm: më parë nuk i shihja kurrë dhe ajo gjë nuk shkonte. Desha të rivendos rregullin. Nuk ndihesha më në lartësinë e duhur, kisha dhembje në gju dhe vendosa ta mbyll", shprehet Mekses. "Nuk do të mund të kisha gënjyer, edhe pse mbase mund të kisha luajtur edhe dy vite të tjera në nivele të

mira. Por nuk më shkon përshat të tallem me njerëzit, kështu që vendosa shigjetën dhe hapa krahun. Do të kisha dashur ta mbyll te Okser, por nuk ishte e mundur. Futbolli? Është një pasion, por jo një fiksim. Futbollin e ndjek nga divani, ose me ndeshjet e fëmijëve të mi. Mbase një ditë do të tentoja tu jap të rinjve atë që futbollit ma dha mua. Pa nxitim", vijoi Mekses.



## DASHI (20/III-20/IV)



Çdo gjë që prisni nga sfera profesionale do të keni mundësi ta realizoni sot. Në qoftë se do ju duhet të përballoni një provë të vështirë, keni të gjitha energjitë e duhura për t'i bërë ballë. Në qoftë se jeni çift, do të gjeni mënyrën për të çuditur partnerin.

## DEMI (21/IV-20/V)



Mbani lart moralin! Duhet të mësoheni të respektoni ritmin natyral të punëve në jetën e përditshme. Nuk mund të pretendoni të veproni sipas nevojave tuaja personale. Mos i sforconi situatat, sepse nuk do të arrini rezultatet e kërkuara. Mbrëmje mjaft argëtuese, e mbushur me surpriza për shumë nga ju.

## BINJAKËT (21/V-20/VI)



Fizikisht nuk do të ndiheni në formën e duhur, kështu që ju nevojitet pushim dhe kura e duhur që do t'ju ndihmojë të ndiheni më mirë. Mbajini sytë hapur në ambientin e punës, sepse dikush mund t'ju vërë kastile në siklet para superiorëve tuaj.

## GAFORRIA (21/VI-22/VII)



Ditë e mirë. Do të dini të veproni me zgjuarsi, intuitë dhe imagjinatë dhe në këtë mënyrë do të dini të gjeni zgjidhjet e duhura në çdo situatë. Hëna do ju ndihmojë të rrisni të ardhurat tuaja dhe të plotësoni çdo dëshirë në dashuri, duke ju dhuruar lumturi me njeriun e zemrës.

## LUANI (23/VII-22/VIII)



Ditë mjaft nervoze kjo e sotnja. Evitoni ndërhyrjet në një çështje që do kohë për t'u zgjidhur, sidomos në qoftë se janë në lojë para dhe persona të tjerë. Hëna kundërshtuese të shenja e Ujorit sjell malinkoni e të papritura në ndjenja dhe dikush nga ju mund të përfitojë për t'u arratisur në vetmi, ose për të kërkuar mbështetje e një personi të afërm.

## VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Mundohuni të zgjidhni ndonjë çështje të rëndësishme gjatë orëve të para të mëngjesit, sepse më vonë Hëna do të kalojë në kundërshtim me shenjën tuaj, duke ju krijuar ndonjë keqkuptim me të tjerët. Ka ardhur momenti të ekuilibroni disa marrëdhënie si sentimentale, ashtu edhe profesionale.

## PESHORJA (23/IX-22/X)



Sot do të keni mundësi të zgjidhni një problem pune në mënyrë të papritur, gjithashtu do të zhduken të gjitha pengesat që ju pengonin për të arritur objektivat tuaja. Një marrëdhënie sentimentale do të jetë motiv reflektimi. Do të jetë i pashmangshëm një sqarim ose një zgjedhje vendimtare.

## AKREPI (22/X-21/XII)



Do të jeni në harmoni me personat më të moshuar të familjes suaj. Ju pëlqen të shikoni se jeta e tyre është e shëndetshme dhe ka shumë gjëra mbi të cilat keni një mendim. Ndjeshmëria dhe sakrificat tuaja karshi tyre do të do të shpërblehen me dashurinë që do ju dhurojnë.

## SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Edhe pse do të arrini ndonjë objektiv ambicioz, mos u tregoni të pakujdesshëm, sepse gjendet gjithmonë ndonjë gjë e papritur. Në qoftë se jeni vetëm, do të ndiheni mjaft mirë afër personave që do ta vlerësojnë shumë interesin tuaj. Në qoftë se jeni çift, ju pret një mbrëmje eksplozive.

## BRICJAPI (22/XII-20/I)



Sot jeni të mbushur me energji dhe optimizëm. Keni shpirt iniciative dhe një nuhatje të shkëlqyer, të cilat duhet t'i përdorni me kujdes, sidomos në qoftë se doni të rrisni të ardhurat tuaja, ose të zgjeroni aktivitetin tuaj. Hëna të shenja e Ujorit do ta bëjë më dinamike jetën tuaj sociale.

## UJORI (20/I-19/II)



Siç thotë edhe proverbi: dita e mirë duket që në mëngjes. Edhe për ju kështu do të jetë kjo ditë e shkëlqyer. Entuziazëm, qartësi, ide dhe mjaft simpati do të jenë armët tuaja fituese, që ju lejojnë të bëni për vete këdo që ju intereson. Në kohën e lirë dëgjoni muzikë, shikoni një film ose lexoni një libër tërheqës.

## PESHQIT (20/II-19/III)



Këto ditë Hëna në kundërshtim ju sugjeron të mos bëni debate të ashpra në familje. Duhet të mësoni njëherë e mirë të harroni ato që janë thënë kundër jush. Vini në përdorim memorien për të kujtuar ngjarjet pozitive dhe pjekurinë tuaj për të harruar ato negative.

## shumë i lehtë

6					5			2
	4			1			6	
5		1				8		7
7			1	6	2			
	8		5		3		1	
			8	4	9			5
9		6				2		3
	3			5			9	
8			3					1


## PËRKUJTIM



**TEFIK BAFTIU**  
(1942- 1991)

Edhe pas 26 viteve nuk mund të bindemi me faktin se s'të kemi më. Sa kohe që kalon, gjithnjë e më shumë e ndjejmë nevojën për dashurinë tënde, për këshillat tuaja, për fjalët plot urtësi e bujari. Në çdo pikë loti shohim fytyrën tënde e lotët shtohen edhe më shumë.

Do të kujtojnë përjetë bashkëshortja Nexhmija, bijat Shpresa, Lumnija, Lirija, Drita, Gëzimja, Vjollca, djali Jetoni me nusen Burbuqe, dhëndurët Isniu, Vebiu, Bekimi, Aliu dhe Zekiriai, si dhe nipërit, mbesat dhe stërnipi.



NE KETE DATE

Mensur Mamuti	NDËRTESE ME OBORRE TE NGATERRUARA PERANDORI ROMAK NE FOTO	L	PERSONI NE FOTO ISHTE P..... D... ROMAK	ISH PATINAZHISTJA RUSE. RODNINA	
DOKUMENT ZYRTAR I PRONËSISË					
PARAARDHËS I SPANJES					
FËMIJA MASHKULL					
FUTBOLLISTI IZRAELIT, ZAHAVI					
KËNGËTARJA BILURDAGU, (FITUESE E SEZONIT TË PARË TË "VOICE OF ALBANIA")					
LIDHJE QELIZASH TË NËJLLOJTA				INICIATOR	
KRIKETISTI XHAMAËKAN, DOU DOBËSIM, MPIRIJE E ORGANEVE					
KOHA	ISH GRUP MUZIKOR SUEDEZ	UNIONI REPUBLIKAN	BANORËT E PUKËS SUPERHEROI NË DRAGON BALL	P	MBRETERËT E LASHTË E LINDJES SË AFERT DHOMA E LARTË E PARLAMENTIT
PERANDORI I PARË ROMAK, PARAARDHËSI I PERSONIT NË FOTO					ILIRIANA SULKUQI ISH FUTBOLLISTI PREKAZI
NDËRMJETËSUES I BURSAVE FINANCIARE					SHTEG, RRUGË E NGUSHTE NORVEGJIA
AMPERI		GJUAJTJE E PANDËRPRERË ME ARMË			
KOHA	LIBRI I KURANIT AKTINIUMI				GRYKA POSEDON (VETA 2 NJ.)
ALI AHMETI			CILËSI QË I JEPËT DIKJUT PARA AZOTI		
NËSI E GJATESISË					

ZGJIDHJET: L, TAPË, IBER, BIRI, ERAN, RINA, IND, UTON, P, ASIRI, AUGUSTI, IS, BROKER, RIM, A, KANONADË, MUSAF, FYT, AA, ETIKETA, CENTIMETER.





**KALENDARI HISTORIK  
16 NËNTOR**

1384 - Jadviga kurorëzohet Mbret i Polonisë, edhe pse ishte grua  
1677 - Trupat franceze okupojnë Frajburgun  
1700 - Monarku u Branderburgut shpallet mbret i Prusisë  
1875 - Beteja e Gundetit: Perandori etiopian Johannes mund egjiptasit  
1917 - Trupat britanike okupojnë Tel Avivin dhe Xhafan  
1918 - Shpallet Republika Popullore e Hungarisë  
1922 - Kalifi turk/Sulltan Mehmedi VI kërkon ndihmë nga britanikët  
1933 - Ruzvellt vendosë marrëdhënie diplomatike me BRSS  
1936 - Forca ajrore gjermane fillon bombardimin e Madridit  
1945 - Themelohet UNESCO  
1950 - Kryetari amerikan Truman shpall krizë emergjente të shkaktuar nga kërcënimi i komunistëve  
1993 - Kryetari i Rusisë Jellcin mbyllë Muzeun e Leninit.  
2000 - Bill Klinton shpallet kryetar i parë i SHBA që ka vizituar Vietnamin pas Luftës së Vietnamit.

**Veshja e realizuar nga qesja që kushton mbi 900 dollarë**

Moda është në shumë raste e çuditshme! Këtë herë, marka e njohur 'Moschino' ka vendosur të dalë me një koleksion të frymëzuar nga plehrat. Si pjesë e koleksionit të 'Fall Jeremy Scott 2017', ata kanë dërguar modelet në sfilatë të veshura me qese plastike dhe kuti kartoni, transmeton Indeksonline. Dhe ndërkohë, që të gjitha këto mund të jenë pjesë e një shfaqje teatrale, Moschnio është në të vërtetë duke realizuar veshje me çmime të



ndryshme madje ndonjëherë edhe tejet të larta. Një nga fustanet e krijuar me këso materiale shfaq madje ka çmim prej 985 dollarësh.



**A E DINI SE...**



E dinit se ngjyra e flokëve përcakton edhe sasinë e tyre? Biondet kanë sasinë më të lartë të flokëve dhe kryesojnë listën e personave që kanë më shumë flokë në kokë. Nëse një brun ka rreth 100 mijë folikuj flokësh, biondet llogariten të kenë rreth 140 mijë.

Shiu nuk është i përbërë vetëm nga uji. Është normale që në Venus, ose në planete të tjera, shiu të jetë i përbërë nga acidi sulfurik ose metan. Ndërsa 5.000 vite dritë larg Tokës, shiu mund të jetë i përbërë nga metale.



Një person, pa pasur probleme të tjera shëndetësore, prodhon rreth 25 mijë litra djersë gjatë gjithë jetës së tij.

**BARSOLETA**



**SPECIFIKA**

Paske filluar ta rrallosh duhanin kështu? - i thotë njëri shokut të tij.

- E kam lënë fare.
- Po me alkoolin si ja çon?
- Edhe atë e kam rralluar mjaft.
- Është për tu çuditur. Me të tjerët ndodh ndryshe. Kur lënë njëri, zakonisht shtojnë tjetrin.
- Ndoshta, por ato nuk janë martuar me gruan time.

**THËNIA E DITËS**

Frymëzimi është një mysafir, që nuk i viziton asnjëherë dembelët. (Tchaikovsky)



**Historia e pabesueshme e vogëlushit shqiptar, i cili fliste pesë gjuhë të huaja**



Në vitin 1920 një vogëlush shqiptar habiti amerikanët duke folur pesë gjuhë të huaja pa shkuar ende në shkollë. "Ky djalosh, një zbulim gjuhësor. Ky djalë shqiptar, - lloj i klasit më të mirë, - flet pesë gjuhë të ndryshme. Ai është i punësuar nga punonjësit Kryqit të Kuq Amerikan si përkthyes dhe lajmëtar. Djali nuk ka shkuar kurrë në

shkollë, por ka marrë mësim nga babai i tij, prefekti i Tiranës, i cili është diplomuar në Kolegjin Amerikan në Kostandinopojë", thuhet në përshkrimin e fotografisë.

(Burimi i fotos: Library of Congress Prints and Photographs Division Washington, D.C. 20540 USA /Fotografitë që kanë bërë historinë)

**Emirates shpenzoi 15 miliardë dollarë për 40 avionë të rinj Boeing**

Agjencia ajrore "Emirates Airlines" ra dakord të blinte 40 avionë Boeing 787-10, në një marrëveshje me vlerë mbi 15 miliardë dollarë. Blerja u njoftua të dielën në Panairin e Avionëve të Dubait nga linja më e madhe ajrore në Lindjen e Mesme. Dërgimi i avionëve pritet të fillojë në vitin 2022. Faqja e internetit e Boeing-ut thotë se avioni ka kapacitet



330 pasagjerë me një rreze prej 11.900 kilometrash. Kompania thotë gjithashtu se 787-a është 25 për qind më shumë eficient për sa i takon karburantit sesa avioni që do të zëvendësojë. Ndërkohë Linja Ajrore e Azerbajxhanit njoftoi për një marrëveshje prej 1.9 miliardë dollarësh po për modelin 787, pesë për pasagjerë dhe dy për transport.